



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 10 JANAR 2017**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 10. JANUARA 2017. GODINE**

**JANAR - JANUAR  
2017**

## **Rendi i ditës**

1. Debat parlamentar në lidhje me mbajtjen në arrest të kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Francë.

## **Dnevni red**

1. Parlamentarna rasprava u vezi mere zadržavanja predsednika Alijanse za budućnost Kosova, g-dina Ramush Haradinaj, u Francuskoj.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,  
I nderuar kryeministër,  
Zëvendëskryeministër dhe ministra të Kabinetit qeveritar,  
I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 7 janar 2017.

Fillojmë me pikën e parë dhe të vetme të rendit të ditës:

### **1. Debat parlamentar në lidhje me mbajtjen në arrest të kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, në Francë**

Të nderuar kolegë deputetë,  
Grupi prej 43 deputetëve të Kuvendit, në mbështetje të nenit 69.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 38 të Rregullores së Kuvendit, kanë parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme me këtë pikë të rendit të ditës.

Ftoj zotin Pal Lekaj, kryetar i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, që në emër edhe të 43 deputetëve nënshkruar të kërkesës ta paraqesë kërkesën e parashtruar. Urdhëroni, zoti Lekaj!

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës,  
I nderuar kryeministër,  
Të nderuar ministra,  
Deputetë,  
Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kërkesë me arsyetim:

1. Më 04 janar 2017 kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, është ndaluar në aeroportin ndërkombëtar “Bazel” të Francës, sipas një fletarrestimi të lëshuar nga Serbia në vitin 2004.

2. Ndalimi i kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është i papranueshëm dhe sulm i drejtpërdrejtë në lëvizjen e lirë të autoriteteve të Kosovës. Kosova është shtet i pavarur dhe qytetarët e saj nuk mund të ndalohen me fletarrestime të Serbisë, të cilat si të tilla nuk kanë asnjë bazë ligjore.

3. Vendimi i autoriteteve gjyqësore të Francës që ta mbajnë në paraburgim ish- kryeministrin e Kosovës, zotin Haradinaj, është i papranueshëm në bazën e një fletarrestimi të Serbisë për krimet

e pretenduara, për të cilat zoti Haradinaj është shpallur dy herë i pafajshëm nga Tribunali i Hagës.

4. Mbjajtja në paraburgim e zotit Haradinaj është për t'i dhënë kohë Serbisë për ta plotësuar dosjen e saj kundër zotit Haradinaj.

5. Vendimi për ta mbajtur në paraburgim është i papranueshëm.

Të nderuar deputetë,

Shefa të grupeve,

Ne kemi menduar dhe nuk kemi dalë këtu me rekomandime që të kemi një unifikim, por si iniciues në fund të debatit do të dal me rekomandime, por që ju ftoj që pas një pauze ne t'i koordinojmë të gjitha rekomandimet, nëse dakordohemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Lekaj!

Urdhëro, i nderuar zoti Pajaziti, kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjala për ju.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot ne jemi këtu në një seancë për të ndarë shqetësimin tonë për ndalimin e padrejtë të zotit Haradinaj në Francë.

Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike e kemi pranuar kërkesën e Grupit Parlamentar të Aleancës nëpërmjet zotit Pal Lekaj, që sot këtë shqetësim ta ndajmë në Parlamentin e Kosovës para qytetarëve të Kosovës.

Sot fatkeqësisht ne duhet të flasim për një rast të përsëritur, për raste të cilat kanë ndodhur disa herë me përfaqësues të institucioneve të Kosovës me persona të ndryshëm që kanë qenë të përfshirë në luftë dhe të cilët janë në listat e Serbisë dhe të cilat po abuzohen, me ç' rast po ndalohen personat e tillë, si zoti Haradinaj, ish-kryeministër i Kosovës që u ndalua tani.

Këtë shqetësim dua që sot të kërkoj nga të gjithë ju ta kanalizojmë sa më drejt që është e mundur. Është e vërtetë që nuk kemi biseduar për rekomandime, por meqenëse sot jemi tubuar bashkë në Parlament, është mirë që ky adresim i këtij shqetësimi të përfaqësuesve të popullit dhe i gjithë qytetarëve të adresohet sa më drejt, në mënyrë që zoti Haradinaj sa më shpejt të lirohet dhe të jetë pranë familjes së tij, pranë miqve të tij dhe në vendin e tij.

Ne duhet të përsërisim ato që kemi thënë disa herë: Të kërkojmë nga institucionet tona që sa më shumë që të jetë e mundur të punojmë me institucionet ndërkombëtare, në mënyrë që të mos lejohet Serbia të abuzojë nëpërmjet Interpolit me fletarrestimet për përfaqësuesit e qytetarëve të Kosovës, për njerëzit e Kosovës dhe këtë të vazhdojnë ta bëjnë sa më mirë. Besoj që sot do të kemi një informacion shtesë, meqenëse ne kemi pasur edhe një rezolutë tjetër për një rast të tillë për zotin Haradinaj. Besoj që sot do të mund të dëgjojmë se çka është bërë, në ndërkohë është kërkuar atëherë në mënyrë decisive që t'u drejtohem institucioneve ndërkombëtare me shqetësimet tona për arrestimin e atëhershëm të zotit Haradinaj.

Dua që sot po ashtu të adresoj edhe një përgjegjësi tjetër që mund të keqkuptohet këtu. Ne duhet ta falënderojmë pikë së pari shtetin e Francës për gjithë atë mbështetje që e ka bërë dhe e bën për Kosovën, për shtetin e Kosovës dhe jam i sigurt se do të apelojmë bashkë me institucionet tona dhe duhet të shohim brenda ligjit dhe konventave ndërkombëtare që shteti i Francës ta trajtojë sa më shpejt që është e mundur në favor të lirimt të zotit Haradinaj. Por, adresimi ynë kryesor ose shqetësimi ynë kryesor është jo me Francën, me shtetin e Francës, por pikë së pari me institucionet e Serbisë, me Qeverinë serbe, me krejt atë përpjekje që po e bën vetë Beogradi për ta dëmtuar procesin e normalizimit të marrëdhënieve dhe, pse jo, duke i adresuar këto çështje që vazhdimt kanë tendencë të dëmtojnë institucionet e Kosovës dhe njerëzit që kanë kontribuar më së shumti me këto.

Pra, shpresoj që shteti i Francës do ta marrë seriozisht, besoj që ata tashmë janë të koordinuar.

Kërkoj nga institucionet tona që gjithçka që është e mundur të bëjnë brenda asaj që është politike, në mënyrë që të ndikojnë aq sa është e mundur, bashkë me institucionet e Francës dhe institucionet e tjera të BE-së, në mënyrë që zoti Haradinaj të jetë sa më shpejt në vendin tonë.

Edhe një herë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike mbështet kërkesën, jemi bashkë me shqetësimin për lirin e zotit Haradinaj. Kërkoj që të gjithë sot së bashku, ashtu siç kemi kalë edhe në raste të tjera të unifikuar për raste që na shqetësojnë të gjithëve, t'i adresojmë sa më shpejt, sa më drejt këto shqetësime, në mënyrë që institucionet e Kosovës të jenë të koordinuara me institucionet e tjera ndërkombëtare që zoti Haradinaj të jetë në mesin tonë sa më shpejt. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti Pajaziti! Fjalën e ka zoti Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

**ISMET BEQIRI:** Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër Mustafa,  
Anëtarë të Kabinetit qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës shpreh shqetësimin e tij me rastin e ndalimit të padrejtë të zotit Ramush Haradinaj nga autoritetet franceze.

Ne jemi të vetëdijshtëm se Franca ka obligime të caktuara ndërkombëtare, por mendojmë që ndalimi i zotit Haradinaj në bazë të fletarrestimit, për ne politik, të lëshuar nga Serbia, gjegjësisht Interpoli, është një veprim që i ka shqetësuar sigurisht institucionet tona shtetërore dhe qytetarët e Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne besojmë që zoti Haradinaj do të kthehet shpejt në Kosovë, ai tashmë dy herë ka dëshmuar pafajësinë e tij para organeve të drejtësisë.

Kemi bindjen dhe me këtë rast do të dëshmohet se kemi të bëjmë me një fletarrestim të motivuar politikisht, të pabazuar dhe të paargumentuar.

Shteti serb, fatkeqësisht, po vazhdon të sillet me mentalitetin e regjimit të kaluar të Milosheviqit, me mentalitetin e viteve të '90-ta, por ata duhet ta kenë të qartë se Kosova nuk është ajo e viteve të '90-ta, të paraluftës. Ne jemi shtet, kemi miq të shumtë, duke përfshirë edhe shtetin edhe popullin francez, miq të cilët na kanë përkrahur në momentet më të vështira.

Ne jemi të vetëdijshtëm, siç thoshte edhe vetë presidenti Rugova, se pa miq nuk mbahet as shteti. Ata duhet t'i ruajmë. Sigurisht që kjo miqësi jona vlerësohet dhe duhet të vlerësohet nga të tjerët jo si dobësi, por si nevojë dhe vlerë.

Të nderuar kolegë,

Kjo seancë e sotme duhet të jetë seancë e solidaritetit, e përkrahjes dhe e mbështetjes institucionale për zotin Haradinaj, për luftën tonë të drejtë. Vetëm kështu sadopak mund t'i ndihmohet zotit Ramush Haradinaj. Kjo seancë sigurisht nuk duhet shfrytëzuar për fyerje e sharje dhe etiketime, sepse kështu nuk i ndihmojmë në asnjë mënyrë zotit Haradinaj.

I vetmi qëllim yni i kësaj seance, i angazhimeve tona shtetërore të këtyre ditëve duhet të jetë kthimi sa më i shpejtë i kryetarit të Aleancës në Kosovë. Të tregojmë kulturë dhe pjekuri politike, të mos merremi me vetveten. Ne nuk e kemi armik as Francën, as popullin francez, as BE-në. Ne kemi raporte jo të mira, jo ashtu siç dëshirojmë vetëm me shtetin serb, shkaku i sjelljeve dhe veprimeve të tyre irracionale, sjellje kundër fqinjësisë së mirë, sjellje antieuropiane dhe antidemokratike. Ne nuk duhet të biem në grackën e tyre, pra të Serbisë. Ta ruajmë gjakftohtësinë, t'i ruajmë miqtë tanë, sepse është edhe interes yni. Kurse, në raport me Serbinë të mbajmë qëndrimin, sjelljen tonë të qartë, veprimin tonë të vendosur se jemi shtet sovran, se institucionet tona do të punojnë dhe koordinohen edhe me miqtë tanë. Ta ruajmë shtetin tonë, sovranitetin tonë.

Këtë vendosmëri tonën në asnjë rrethanë nuk duhet ta vëmë në dyshim dhe Serbia nuk duhet të ketë iluzion se kur është në pyetje mbrojtja e interesave të vendit tonë mund të luajë në letrën e përçarjes sonë.

Të nderuar kolegë deputetë,

E inkurajojmë Qeverinë e Republikës së Kosovës, ministrinë përkatëse, që të vazhdojnë me angazhimin e tyre, që të bëjnë çdo gjë të është në dorën dhe mundësinë e tyre, që rasti i zotit Haradinaj të mbyllet sa më shpejt me lirim dhe kthimin e tij në Kosovë. Po ashtu, kërkojmë nga organet tona kompetente që të angazhohen me tërë potencialin e tyre politik e diplomatik që të anulohen fletarrestet politike nga Serbia.

Jemi të vetëdijshëm se mosqenia jonë anëtar i Interpolit dhe Europolit e vështirëson në një masë punën tonë, por kjo nuk duhet kuptuar si gjendje që nuk mund dhe nuk duhet t'i kryejmë punët tona, angazhimet tona, që i kemi si obligim, angazhimet tona institucionale.

Të nderuar kolegë deputetë,

Besojmë shumë që organet e drejtësisë franceze, një shtet demokratik dhe përkrahës i Kosovës, shpejt do ta marrin vendimin e drejtë, e ai vendim i drejtë për ne është që zoti Haradinaj të lihet i lirë dhe të kthehet në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti Beqiri! Tani në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputeti Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

**ISMAJL KURTESHI:** Faleminderit!

Po filloj me konstatimin se arrestimi i Haradinajt është rezultat i negociatave joparimore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që po zhvillohen tash e gjashtë vjet në Bruksel.

Kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar të Kosovës,

Edhe 18 vjet pas shkëputjes së Kosovës nga kthetrat e Serbisë koloniale, Serbia nuk po heq dorë, jo vetëm nga shtypja e shqiptarëve brenda kufijve të saj, por po i keqtrajton e po u sjell probleme shqiptarëve kudo që po mundet, siç ka ndodhur këto ditë edhe me arrestimin e zotit Ramush Haradinaj në Francë, bazuar në një urdhër arrest të pabazë të Serbisë.

Gjashtë vjet pas fillimit të dialogut të Brukselit me Serbinë, që pati filluar si dialog teknik me arsyetimin se ky dialog do t'ua lehtësojë jetën qytetarëve të dy shteteve, mbase po pranohet nga pala kosovare dhe po kuptohet nga Bashkimi Evropian si i dështuar. Kjo nuk do të thotë se me Serbinë nuk duhet të negociohet, por kjo do të thotë që me Serbinë, si dhe me çdokënd tjetër, para se të hyhet në negociata duhet të përcaktohen parimet e qarta nga palët dialoguese, të cilat duhet të respektohen nga palët dhe të garantohen nga ndërmjetësuesi i negociatave.

Negociatat pa parime, në vend të marrëveshjeve parimore, sjellin fituesin dhe humbësin në tavolinë, siç po ndodh edhe me këto bisedime. Pranimi i statusit të padefinuar nga përfaqësuesit e Kosovës së pavarur, para se të fillojnë negociatat, e ka përcaktuar rrjedhën e bisedimeve. Me këtë akt antikushtetues ka ndodhur legjitimimi i ndërhyrjes së Serbisë në punët e brendshme të shtetit të Kosovës.

Me vetë faktin që përfaqësuesit e Kosovës kanë pranuar të heqin dorë nga vendimi historik i 17 shkurtit 2008 të Kuvendit të Kosovës, me ç'rast Kosova është shpallur shtet i pavarur dhe sovran, këtë vendim që shpreh vullnetin e shumicës absolute të qytetarëve të Kosovës, e në kohën kur filluan këto negociata e patën pranuar edhe rreth 100 shtete, rezultatet kanë qenë të pritshme.

Të pranosh të negociosh si vend pa status të përcaktuar pas përcaktimit dhe njohjes së statusit nga shumica e shteteve të botës, ta zëvendësosh republikën me fusnotë, të pranosh të negociosh me palët që të cilësojnë si institucion i përkohshëm i krahinës jugore të Serbisë, të pranosh të negociosh për rregullimin e brendshëm të shtetit të pavarur me një shtet që nuk e njeh pavarësinë e këtij shteti, është shkelje e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është shkelje mbi sakrificën e të gjitha gjeneratave që kanë kontribuar për pavarësinë e Kosovës.

Është dështim i pajustificuar, është dëm shumë i madh për Kosovën. Ndryshe, si mund të kuptohen bisedimet për urën e Ibrit, që gjendet në mes të Kosovës, për Asociacionin e Komunave Serbe në Kosovë, për kishat ortodokse të Kosovës, për kodin telefonik të Kosovës, e për shumëçka tjetër që është e Kosovës, e që nuk do të duhej të bisedohej me fqinjët, e aq më pak me Serbinë, e cila çdo ditë hapur po deklarohet dhe po punon për shkatërrimin e shtetit të Kosovës.

Rezultat i këtyre negociatave joparimore janë: futja pa pengesë herë nëpërmjet rrugëve legale, e herë ilegale të mallrave të cilësisë së dyshimtë në tregun e Kosovës, për të cilën paguajmë rreth 400 milionë euro në vit. Ndërhyrja e Serbisë në punët e brendshme të Kosovës deri në ultimatumin e fundit në lidhje me “Zajednicën”, ndërhyrja në emërimin e ministrave serbë në Qeverinë e Kosovës, legalizimi i strukturave paralele, investimet e Serbisë në rikolonizimin e Kosovës, siç është rasti i “Luginës së Diellit”, ndërtimi herë i kopshtit ndarës mbi urën e Ibrit, herë murit përtej urës, pengimi i ndërtimit të shtëpive të shqiptarëve në pjesën veriore, përdorimi i planprogrameve antikushtetuese shkollore në shkollat në gjuhën serbe në Kosovë, arrestimi i shqiptarëve jo vetëm në Serbi, por edhe në shtetet e tjera, si rasti i fundit i Ramush Haradinajt në Francë. Këto bisedime edhe ia kanë hapur Serbisë rrugën e integritit në BE, ndërsa Kosova ka mbetur e izoluar edhe për shkak të pengesave të Serbisë.

Nga këto negociata joparimore, jotransparente dhe pa vizion, në vend të rezultateve konkrete, shqiptarët kanë dëgjuar përralla të bukura të negociatorëve tanë që po i përsëritin pa fije turpi me



qindra herë, se si Serbia e ka njohur pavarësinë e Kosovës, si po ndodh integrimi i komunitetit serb në Kosovë, si po funksionojnë institucionet e Kosovës në veri, si po ndodh integrimi i Kosovës në institucionet euroatlantike dhe shumë tregime tjera të bukura që nuk e kanë asnjë të vërtetë në to.

Është kohë e fundit që palët negociuese, ndërmjetësuesit dhe qytetarët e Kosovës ta kuptojnë se e lëshuara pe në këtë masë nga përfaqësuesit e Kosovës nuk është e mirë, madje as për Serbinë, e lëre më për Kosovën, e për ndërmjetësuesit evropianë që janë të interesuar për stabilitet në këtë rajon, sepse stabilitet nuk mund të ketë kur një shtet ndërhyt në këtë masë, siç Serbia po ndërhyt në Kosovë. Prandaj, Qeveria e Kosovës duhet menjëherë ta ndalojë importin e mallrave të Serbisë në Kosovë dhe t'i ndërpresë negociatat deri në momentin kur Serbia ta njohë pavarësinë e Kosovës. Pas njohjes së pavarësisë së negociatave, mund të fillojnë dhe të zhvillohen bisedimet vetëm ndërmjet dy shteteve sovraane dhe të pavarura mbi parimin e reciprocitetit.

Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta vendosë embargon ndaj shtetit të Republikës së Serbisë, pra t'i ndërmarrë të gjitha masat e reciprocitetit të plotë, politik, ekonomik dhe tregtar ndaj Serbisë. Kur kjo të ndodhë, Serbia do të detyrohet të heqë dorë nga politika e hegjemoniste karshi Kosovës. Pas njohjes, ajo nuk do të mund të ndërhyjë kështu hapur në punët tona të brendshme. Përveç tjerash, ajo më kurrë nuk do të arrestojë shqiptarë të pafajshëm në Serbi, e as nuk do të ngrejë urdhërarreste për veprimtarët shqiptarë dhe luftëtarët e lirisë, siç është rasti i Ramush Haradinajt.

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” kërkon angazhimin e Qeverisë së Kosovës për lirin e zotit Ramush Haradinaj deri në momentin kur ai të lirohet dhe po ashtu kërkojmë masa që i propozuam ndaj Serbisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kurteshi! Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: E nderuar familje e sakrificës, Haradinaj!

Qytetarë të Kosovës,

Kolegë deputetë,

Për të satën herë po takohemi në seanca të jashtëzakonshme, për të satën herë po takohemi për ish-kryeministrin Ramush Haradinaj dhe prapë ja ku jemi në situatën e njëjtë. Pse?! Sepse, shteti ynë nuk është në krye të detyrës së tij që t'ua bëjë të qartë të gjithëve se çka do që vjen nga Serbia është mashtrim, është gënjeshtëri, është vazhdim i luftës ndaj shqiptarëve dhe asgjë tjetër.

Sot, ne ende duhet të shikojmë e të flasim se si shumë shtete po na i arrestojnë çlirimtarët tanë, vetëm se nuk e duruan represionin e regjimit të Serbisë. Se si Serbia prej inatit që e shporrëm prej këtu po lëshon fletarreste pa asnjë bazë ligjore, por vetëm të dedikuara kundër shqiptarëve

çlirimtarë të vendit të vet. Këtë e dëshmoi edhe deklarata e kryeprokurores serbe, e cila tha se “do ta ndjekim zotin Haradinaj sa të jetë gjallë”. A për këtë keni biseduar deri tani me këtë shtet të prishur në shpirt në Bruksel? Që të na ndjekë për sa të jemi gjallë, vetëm se e kemi luftuar, se nuk deshi të lërë asnjë shqiptar në Kosovë të gjallë në vendin tonë.

A i kemi ndihmuar ne Serbisë në këtë drejtim? Me bindje them se po. Deklaratat e kryeministrit dhe të presidentit veç sa i japin zemër këtij shteti fashist që të vazhdojë me logjikën e nënshtimit të Kosovës. Nuk po flas, s’di çka të them më tepër se kryenegociatoren e Kosovës, e cila na ka “kënaqur” me marrëveshjet e saj të arritura me Serbinë në Bruksel. Por, kjo zonjë kurrë nuk arriti t’ia bëjë të qartë Bashkimit Evropian se Serbia ka disa fletarreste të shpifura, demagogjike e urryese kundër shqiptarëve, që janë të regjistruara në Interpol.

Ose të bëjë presion nëpërmjet instancave të Bashkimit Evropian, që janë të instaluar në Kosovë, që të njëjtat të hiqen e të shpallen të pavlefshme. Nuk po arrij të kuptoj se si edhe të fundit reaguat, edhe atë reagim e kishit të plogësht, ju që jeni të thirrur edhe në bazë të Kushtetutës së Kosovës t’i mbronin qytetarët e këtij vendi, pa marrë parasysh që ata përfaqësojnë diçka e dikë, apo janë thjesht qytetarë të këtij vendi që ju paguajnë t’u qëndroni afër dhe t’u dilni në ndihmë kur kanë nevojë.

Uroj që ky rast të jetë i fundit, ka treguar se vetëm populli nuk ka harruar nga kemi rënë e çfarë kemi vuajtur deri te liria e po ashtu, nuk harron se kush janë çlirimtarët e tij, përkundër disa qeveritarëve, që gati pothuajse pas një jave, u bie ndër mend se një ish-zyrtar i lartë i shtetit, një luftëtar i zoti, një lider politik i vendit të vet, qenka ndaluar padrejtësisht në një shtet tjetër.

Ne ende po presim dhe dëshirojmë të besojmë, që ish-kryeministri Haradinaj pikërisht për hir të shpërfaqjes së luftës së drejtë të UÇK-së kishte lënë pozitën që sot mban një njeri krejtësisht i padevotshëm, të lirohet e t’i mundësohet vazhdimi i agjendës së tij si lider politik i Kosovës, të cilën për asnjë çast nuk u nda nga vetja. Luftëtarët e luftës çlirimtare të Kosovës, çka është edhe Ramush Haradinaj janë të shenjtë, sepse këta kanë qenë të gatshëm të japin jetën për të qenë ne sot të lirë.

E ne të lirët çfarë bëmë dje e çfarë po bëjmë sot për ta? Ua nxijmë jetën duke mos u dhënë asgjë e hiç asgjë, në kuptimin e të qenit të sigurt se nuk i prekë askush, nuk guxon t’i prekë askush për sa i takon luftës që kanë bërë për liri.

Në fakt, se gati harrova krejt, ju në vend të sigurisë se nuk do t’i prekë askush, ua keni sjellë një gjykatë shumë më speciale, si dhuratë për çfarë kanë hequr e vuajtur çlirimtarët, që të kemi shtet të fortë e drejtësi tonën për lakmi nga të tjerët.

Qeveria e Kosovës, jo vetëm kjo sot, por edhe ajo dje, ose më mirë thënë që nga shpallja e Pavarësisë keni punuar aq dobët për vendin tonë e tuajin, sa sot po shihet që gati sa nuk po i nxjerrim bluf shtetet që kanë përkrahur Kosovën, siç është edhe ky rasti i fundit, kur tani Franca duhet të përcaktohet nëse ka pasur të drejtë kur ka marrë pjesë në bombardimet që NATO i ka bërë Serbisë për të ndaluar gjenocidin e saj ndaj popullit shqiptar, apo sot që po i zbaton disa fletarreste kryekëput etnike, politike, të lëshuara nga Serbia ndaj ish-komandantëve dhe ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ju, Qeveria e Kosovës, duhet ta pranoni njëherë e mirë atë që po u vjen mërzi pse po ua përmendim shpesh, por nuk po keni tjetër rrugëdalje, sepse ashtu jeni. Jeni të pafuqishëm për t'i dalë zot sovranitetit të Kosovës. Nuk është hera e parë që arrestohet Kosova, na u arrestua zyrtarë qeveritarë e politikë me pasaporta diplomatike. Pasaportë diplomatike nënkupton eksterritorialitet, paprekshmëri nga një shtet tjetër, por falë jush, pak kush po na e respekton këtë paprekshmëri përmes pasaportës.

Dorëhiquni dhe lejoni Kosovën të bëhet me dinjitet, e fortë, e pastër, pa njolla, ashtu siç e deshën edhe bashkëluftëtarët e zotit Haradinaj, që janë dëshmorë, po të njëjtë siç e dëshiron e për çfarë angazhohet edhe zoti Haradinaj. Ky nënshtrim i Kosovës përballë presionit serb, përmes disa lobingjeve në shtetet tjera duhet të marrë fund njëherë e përgjithmonë.

Ramush Haradinaj duhet të kthehet në Kosovë. Ramush Haradinaj duhet të kthehet në Kosovë. Ramushin sa më shpejt duhet ta kthejmë këtu, të lirë, në vendin e vet sikur që jemi secili nga ne. Duhet bërë me dije të gjithëve, miqve e armiqve, se Ramushi sot është Kosova. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Lekaj! Fjala është për zonjën Valdete Bajrami, kryetare e Grupit Parlamentar "Nisma".

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fatkeqësisht, sot ndodhemi sërish në një situatë të njëjtë sikur më 18 qershor të vitit 2015, ditë kur ky Parlament mbajti një seancë të jashtëzakonshme për arrestimin e zotit Haradinaj nga policia sllovene.

Por, sot jemi mbledhur sërish për arrestimin e zotit Haradinaj, mirëpo tash ndalimi i tij është nga një vend tjetër, nga një shtet tjetër, një shtet mik, pra Franca.

Në Republikën tonë po harrohen obligimet që kjo qeveri i ka. E unë sot, po ia kujtoj zotit Mustafa dhe zotit Thaçi obligimet që ka nxjerrë ky Kuvend në bazë të rezolutës së 18 qershorit 2015 dhe dua ta citoj vetëm pikën e dytë të asaj rezolute, ku kërkohet nga Qeveria e Kosovës,

urgjentisht nga Brukseli të kërkojë pastrimin e menjëhershëm të listave, respektivisht të fletarrestimeve të lëshuara nga Serbia për ish-ushtarët e UÇK-së.

Unë po ashtu, dua t'ju pyes juve që ishit të përfshirë dhe të cilët jeni, për momentin, të përfshirë në dialog. A e keni kërkuar në Bruksel që pika e dytë e kësaj Rezolute të respektohet nga Serbia, pra që ky shtet duhet të bënte pastrimin e menjëhershëm të listave, të fletarrestimeve të lëshuara nga Serbia për ish-ushtarët e UÇK-së? Po, apo jo? Sepse, po të kërkohej, qysh pas asaj seance nuk do të ndodheshim sot ne këtu.

A ka më hipokrizi, kur një vit më parë u krijua nga ju një gjykatë speciale, që do t'i gjykojë vetëm ushtarët e UÇK-së e ditë më parë u thanë edhe arsyet nga ju, se përse e krijuat këtë gjykatë. E në anën tjetër vini dhe luani rolin e dyfishtë, ashtu siç jemi mësuar tash e sa kohë, sepse po të ishit ashtu siç duhet dhe po të ishit zëri i popullit, ju tashmë do ta kishit kryer punën ashtu siç ju obligon edhe Kushtetuta dhe ashtu siç duhet vepruar një qeveri, do të kërkonit që këto lista një herë e përgjithmonë të pastroheshin nga shteti Serb. Por, jo. Juve nuk ju intereson askush pos vetes suaj dhe atyre që ju rrethojnë, kjo tashmë po dëshmohet çdo ditë e më shumë. Tash është momenti të kemi një qeveri përgjegjëse, që të mos bëjë asnjë hap tutje në drejtim me dialogun që e kemi me Serbinë, derisa ajo nuk pranon të bëjë pastrimin e listave.

Unë nuk do ta zgjas, do ta adresoj kërkesën e “Nismës” në këtë rast. “Nisma për Kosovën” kërkon, që sa më parë të lirohet zoti Haradinaj dhe t'i bashkohet familjes. Po ashtu, kërkojmë nga ju që t'i bëni detyrat ashtu siç u obligon Kushtetuta e vendit, ose të shkoni në shtëpi, se përfundimisht kështu nuk po duroheni më. Nuk po mbetet ditë dhe muaj pa protesta, nuk po ka asnjë ditë kur mund të krenohemi me ndonjë rezultat nga kjo qeveri, pos dështimeve të njëpasnjëshme, dështime për vendin dhe për qytetarët, kuptohet, sepse për vete jeni kujdesur shumë mirë që t'i krijoni kushtet sa më të mira.

Prandaj “Nisma”, edhe një herë po e përsëris, “Nisma për Kosovën” kërkon që sa më parë të bëhen hapat adekuat, që zoti Haradinaj t'i bashkohet familjes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Bajrami nga “6+”-i, Qerim Bajrami, fjala për ju.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući!

Gospodo poslanici,

Uvaženi premijeru,

Uvaženi ministri,

Mi iz Parlamentarne grupe “6+”, predstavnici Bošnjaka, Turaka, Roma i Aškalija, osuđujemo hapšenje i privođenje gospodina Ramuša Haradinaja u Francuskoj i zahtevamo da on što prije bude pušten na slobodu i vraća na Kosovo.

Smatramo da političke igre vlade republike Srbije i veliko nacionalističke i prema Kosovu a svaki dan vidimo i prema Bosni se nastavljaju i zahtevamo od jedno od vodećih zemalja, kao što je Republika Francuska da shvati ove igre, da je također i Evropska Unija da što prije oduzme određene mere, da se zaustavi ova dvolična politika republike Srbije i da konačno se stane na put izazivanju nemira na Balkanu.

Podržavamo današnju deklaraciju, koju ćemo doneti verovatno zajednički ovde u Parlamentu i daćemo svoj doprinos u radnoj grupi. Također podržavamo napore Vlade Kosova, odnosno tražimo puni angažman na preduzimanju svih mera za što prije oslobađanje gospodina Ramuša Haradinaja i kao što sam rekao, njegov povratak na Kosovu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Bajrami! Fjalën e ka kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Zoti Veseli,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar qytetarë,

Fillimisht, më lejoni të shpreh shqetësimin dhe papajtueshmërinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndalimin dhe për procedurat që po zhvillohen ndaj kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe ish-kryeministrit të Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, i cili është ndaluar nga autoritetet franceze në bazë të një fletarrestimi të motivuar tërësisht mbi baza politike nga Serbia.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka konsideruar dhe konsideron se fletarrestimet serbe për qytetarët e Republikës së Kosovës janë plotësisht të paligjshme, janë të padrejta dhe me tendenca të qarta për të krijuar tensione politike, konflikte dhe për të dëmtuar proceset në Rajon dhe proceset më gjerë.

Po ashtu, dëshiroj të ju informoj, se me të kuptuar lajmin për ndalimin e zotit Haradinaj, të gjitha dikasteret kompetente të Qeverisë së Kosovës janë vënë në veprim dhe janë angazhuar me përkushtim të plotë për të kontribuar në çdo formë për lirimin sa më të shpejtë të zotit Haradinaj, në mënyrë që ai sa më shpejt të kthehet në Kosovë dhe të zhvillojë aktivitetet e tij si kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe si lider i rëndësishëm politik i vendit.

Përfaqësuesit e Republikës së Kosovës kanë transmetuar tek autoritetet e shtetit francez, se fletarrestimet e Serbisë janë të paligjshme për qytetarët e Republikës së Kosovës, se juridiksioni i Serbisë mbi qytetarët e Republikës së Kosovës ka pushuar zyrtarisht në qershor të vitit '99, se Republika e Kosovës i ka institucionet e pavarura të drejtësisë me juridiksion të plotë për të

trajtuar çdo pretendim për shkelje të ligjit, se institucionet e Republikës së Kosovës edhe sot e kësaj dite bashkëpunojnë edhe me Misionin e EULEX-it për çështje të tilla, pjesë e të cilit është edhe shteti i Francës dhe se nuk shohim asnjë arsye, që zoti Haradinaj të mbahet edhe më tutje në Francë me fletarrestim të paligjshëm dhe të motivuar kryesisht mbi baza politike nga Serbia.

Qeveria e Republikës së Kosovës po punon intensivisht, që akuzat e paligjshme, të padrejta dhe tendencioze të Serbisë ndaj personaliteteve kosovare, sepse nuk flitet kështu këtu dhe nuk është vetëm rasti i zotit Haradinaj, të refuzohen si të tilla nga institucionet ndërkombëtare të sigurisë, sepse nuk kanë asnjë bazë juridike që ato të trajtohen më tutje.

Ne tash e dy vjet kemi bërë përpjekje maksimale, që Kosova të anëtarësohet në Interpol dhe të avancojmë bashkëpunimin me Europolin dhe jemi duke punuar intensivisht që ta realizojmë këtë kërkesë tonën. Në fund të vitit të kaluar është vendosur që në këtë vit të trajtohet e drejta e Kosovës për anëtarësim në Interpol dhe ne shpresojmë, që me anëtarësimin tonë do të kontribuojmë që rrënjësisht këto fletarrestime të motivuara politikisht të hiqen nga rendi i ditës.

Qeveria në konsultim me autoritetet brenda dhe jashtë vendit është duke shqyrtuar masat adekuate të veprimit të saj, në rast se Serbia duke keqpërdorur mekanizmat ndërkombëtarë që merren me rend dhe ligj, do të vazhdojë me aplikimin e këtyre akteve të paligjshme dhe të pamoralshme politike. Prandaj, për arsye që shpalosa më lartë, unë shpreh bindjen e plotë se institucionet e Francës së shpejti do të marrin vendim, që zoti Haradinaj të kthehet në Kosovë dhe që raste të tilla të mos aplikohen në të ardhmen as ndaj qytetarëve të tjerë të Republikës së Kosovës.

Zoti Haradinaj ka qenë kryeministër i Republikës së Kosovës në një periudhë, zoti Haradinaj është kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, një force të rëndësishme politike të vendit, e cila i jep peshë të rëndësishme zhvillimit të demokracisë në vend. Zoti Haradinaj, po ashtu është shquar për aktivitetin e tij në përparimin e të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës, sidomos të komuniteteve jo shumicë në Kosovë dhe për orientimin e tij pro evropian dhe euro-atlantik dhe nuk shohim asnjë arsye që ai të mbahet në Francë më tutje, por shohim arsye që ai të kthehet dhe të kontribuojë zhvillimit të demokracisë së vendit.

Prandaj, ju siguroj se Kosova dhe qytetarët e saj do të jenë të unifikuar lidhur me çështjen e zotit Haradinaj dhe se vazhdimisht edhe në këto ditë do të punojmë, që shteti francez sa më parë ta lirojë zotin Haradinaj dhe të kthehet në Kosovë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti kryeministër! Tani fjalën do ta marrin edhe dy ministra, para se të futemi në debat, kolegë deputetë, për t'i qartësuar edhe hapat që janë ndërmarrë nga autoritetet e Kosovës, ministri i Jashtëm, zoti Enver Hoxhaj, e ka fjalën, në ndërkohë të bëhet gati ministrja e Drejtësisë për ta marrë fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Kolegë ministra,

Shumë të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Shumë e respektuar familje Haradinaj,

Qytetarë të Kosovës,

Zonja e zotërinj,

Të mërkurën e kaluar, diku 10 - 15 minuta pas orës 15 kam biseduar me telefon me zotin Haradinaj, pas një informate që kam marrë nga Ambasada jonë në Francë dhe nga Konsullata jonë e përgjithshme në Strasburg për ndalimin e zotit Haradinaj.

Që nga ajo ditë ndalimi i zotit Haradinaj në Francë ka qenë goditje për Kosovën, me që zoti Haradinaj është hero lufte dhe, natyrisht se është edhe një ish-kryeministër dhe lider i një partie të rëndësishme parlamentare në Republikën e Kosovës.

Prandaj, fillimisht më lejoni të shpreh solidarizimin tim me familjen e zotit Haradinaj, me bashkëpunëtorët, me miqtë e tij, të cilët gjatë këtyre ditëve natyrisht se kanë qenë të shqetësuar, të prekur dhe të goditur nga ndalimi i tij në Francë.

Po ashtu, dua t'ju them se nga e mërkura e javës së kaluar e deri në këtë seancë që po e mbajmë sot, angazhimi im ka qenë maksimal që zoti Haradinaj të lirohet sa më shpejt. Kemi ofruar përkrahje dhe garanci shtetërore që zoti Haradinaj të kthehet në Kosovë.

Që nga momenti i ndalimit, në çdo orë kemi pasur informata të plota se çfarë po ndodh me zotin Haradinaj. Kemi komunikuar me autoritetet franceze, qoftë me ambasadorin e Francës në Prishtinë, qoftë me Ministrinë e Punëve të Jashtme në Paris dhe, natyrisht se kemi sqaruar dhe vazhdojmë të sqarojmë se fletarrestimet e Serbisë janë të papranueshme, janë të motivuara politikisht dhe janë kundër paqes e stabilitetit në Kosovë dhe në rajon.

Që ditën e parë kemi ngritur një ekip në Ministrinë e Punëve të Jashtme, kemi pasur një koordinim jashtëzakonisht të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë, me Ministrinë e Brendshme, dhe i falënderoj të dy ministrat për mbështetjen e përkrahjen, sikurse kemi pasur edhe një koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe me persona pranë Policisë së Kosovës, të cilët janë në kontakt me Interpolin.

Ambasadori ynë në Francë, konsulli ynë në Strasburg, kanë qenë, janë dhe vazhdojnë të jenë pranë zotit Haradinaj.

Të mërkurën, kur ka ndodhur arrestimi apo ndalimi i tij, nga ora 3 pasdite deri në orën 19 unë kam telefonuar disa herë personalisht me zotin Haradinaj. Po ashtu kam biseduar edhe me zyrtarë të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, qoftë me zotin Ardian Gjini, me Blerim Kuçin, me Besnik Tahirin e me shumë të tjerë dhe qëllimi ka qenë që të koordinohemi sa më mirë se si t'i përfaqësojmë interesat e zotit Haradinaj.

Në koordinim me zotin Haradinaj, që besoj se edhe ministrja e Drejtësisë do t'ju informojë në detaje, më 4, 6 dhe 9 janar kemi bërë disa kërkesa për lirim dhe kthimin e tij sa më të shpejtë.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zonja e zotërinj,

Nga dita e mërkurë kemi punuar në dy nivele: në nivelin politik dhe diplomatik, të cilin proces e kam udhëhequr vetë dhe në nivelin e drejtësisë, të cilin proces e ka udhëhequr ministrja e Drejtësisë, që hyn në kuadër të Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Po ashtu, kam pasur një telefonatë të gjatë me ministrin e Jashtëm të Francës, ku ia kam përcjellë qëndrimin e prerë të Qeverisë së Kosovës, i kam shpjeguar në detaje rrethanat ligjore si dhe motivet serbe në raport me një ndalim të tillë të zotit Haradinaj dhe se si fletarrestimet e tilla janë jovalide, të papranueshme dhe kundër çdo konvente ndërkombëtare.

Mund të them se ministri i Jashtëm i Francës ka pasur një pamje të plotë dhe një informim të plotë e të detajshëm se kush është zoti Haradinaj, se sa partner i Francës dhe i Perëndimit është, dhe se si një rast i tillë për politikën franceze është i papranueshëm.

Një aspekt që dua të përmend, edhe për shkak të përshkrimit tim të punës, është raporti ynë me Francën dhe se si duhet ta kuptojmë raportin tonë me Francën, meqë kam parë edhe reagimin e mediave gjatë këtyre ditëve të fundit.

Franca është një shtet mik i Kosovës, e ka njohur Kosovën, ka qenë dhe është e vendosur ta mbështesë Kosovën për t'u anëtarësuar në Interpol dhe, sikur që dihet, Interpoli është keqpërdorur dhe po keqpërdoret nga Serbia në raport me Kosovën.

Besoj se komunikata e djeshme, e cila është nxjerrë nga Ministria e Punëve të Jashtme të Francës, e konfirmon një gjë të tillë.

Prandaj, krahas përpjekjes sonë, të vendosur, që me çdo kusht ta mbrojmë interesin e çdo qytetari të Kosovës dhe mbrojtja e interesit të qytetarit të Kosovës është prioritet mbi prioritete për politikën tonë të jashtme.



Dhe, krahas mbrojtjes së interesit të qytetarit dhe shtetit, ne duhet të bëjmë përpjekje maksimale që t'i ruajmë edhe raportet me vendet mike, e unë jam i detyruar, për shkak të pozitës edhe politike, edhe kushtetuese, që ta them një gjë të tillë.

Nuk ka asgjë tjetër që do të shkonte në interes të Serbisë se sa të krijohet një hendek ndërmjet Kosovës dhe Francës.

Një aspekt tjetër, për të cilin duhet të debatojmë, për të cilin duhet të mendojmë është raporti i Kosovës me Serbinë.

Serbia ka ndjekur një politikë armiqësore dhe po ndjek një politikë armiqësore në raport me shtetin e Kosovës. Dëshiron ta minojë shtetësinë tonë brendapërbrenda, sovranitetin dhe integritetin territorial, bën përpjekje që çdo ditë ta izolojë vendin tonë ndërkombëtarisht, sikur se ndjek edhe një politikë armiqësore individuale ndaj lidershit dhe ndaj qytetarëve të Kosovës. Dhe, kësaj gjëje dhe në raport me këtë gjë, ne si shtet, ne si Qeveri dhe ju si Kuvend duhet të mendojmë se si të sillemi në të ardhmen.

Në Beograd nuk ka rikthim nga logjika e Milosheviqit. Në Beograd ka rikthim të pasardhësve të Milosheviqit.

Për këtë arsye, në koordinim me kryeministrin Mustafa ne kemi marrë edhe veprime konkrete reciproke, sikurse që kemi parandaluar edhe vizitën e Nikoliqit në Kosovë, sikur që edhe në të ardhmen do të marrim veprime reciproke në raport me Serbinë.

Të nderuar zonja e zotërinj,

Burim i ndalimit të zotit Haradinaj është Serbia. Dhe, vetëm këto dy ditë të fundit, nëse ju i keni parë deklaratat e ministrit të Jashtëm serb, ata bëjnë përpjekje sa ta godasin Kosovën, po aq ta godasin edhe diasporën tonë.

Në këtë drejtim ne e kemi një koordinim të brendshëm jashtëzakonisht të mirë, me të gjitha institucionet, se si të parandalojmë ndonjë keqpërdorim të politikës serbe në raport me vendin tonë. Dhe, me gjithë këto veprime, Serbia realisht po e rrezikon dialogun me Kosovën.

Më lejoni të përfundoj. Zoti Haradinaj jam shumë i sigurt se do të kthehet në Kosovë dhe ne do të punojmë 15 orë në ditë që ai të kthehet sa më shpejt në Kosovë. Unë kam bërë kërkesë urgjente për një vizitë zyrtare në Francë dhe temë e vetme është kthimi sa më i shpejtë i zotit Haradinaj, sikurse që ne, edhe gjatë ditëve të ardhshme do të ndërtojmë një qasje të plotë se si t'i qasemi Interpolit dhe si fletarrestimet e tilla të jenë këto të fundit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Hoxhaj! Fjalën e ka ministrja e Drejtësisë, zonja Dhurata Hoxhaj. Në ndërkohë, të bëhet gati të marrë fjalën ministri i Brendshëm, dhe pastaj i kemi diskutimet nga kolegët deputetë.

DHURATA HOXHAI: I nderuar kryetar,

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Familje Haradinaj,

Të nderuar qytetarë,

Ndalimi i dytë i kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, pas atij në qershor të vitit 2015 në Slloveni dhe pas lirimit nga Gjykata Ndërkombëtare, paraqet një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut, shkelje e të drejtës ndërkombëtare nga Serbia, shtet i cili kreu krimet më monstruoze ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Menjëherë pas marrjes së informacionit nga Policia e Kosovës, më datë 4 janar 2017, rreth orës 15, Ministria e Drejtësisë ka kontaktuar me Ministrinë e Punëve të Jashtme, me Policinë e Kosovës dhe me ambasadorin e Republikës së Kosovës në Francë për të vërtetuar gjendjen faktike rreth ndaljes së zotit Ramush Haradinaj.

Dhe, në bashkërendim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ambasadorin e Republikës së Kosovës në Francë dhe Policinë e Kosovës, Ministria e Drejtësisë, në po të njëjtën ditë, nëpërmjet kanaleve diplomatike i ka dërguar protestën e parë Ministrisë së Drejtësisë së Francës, ku ka kërkuar lirinë e zotit Ramush Haradinaj.

Më datë 5 janar 2017, ministrja e Drejtësisë ka kontaktuar me Ambasadorin e Francës në Kosovë, prej të cilit ka kërkuar lirinë e zotit Ramush Haradinaj. Njëkohësisht kanë filluar konsultimet dhe bashkërendimi me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ambasadën e Kosovës në Francë dhe Policinë e Kosovës për përgatitjen e shkresës së dytë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Francës, e cila u dërgua më datë 6 janar 2017.

Në këtë shkresë janë cekur hollësisht argumentet juridike dhe politike për kundërligjshmërinë e ndalimit të zotit Ramush Haradinaj dhe u kërkuar prapë liri i tij i pakushtëzuar.

Po ashtu, Ministria e Drejtësisë u bashkërendua me ambasadorin dhe konsullin e përgjithshëm të Kosovës në Francë, të cilët janë duke ndjekur nga afër procesin gjyqësor lidhur me ndalimin e zotit Ramush Haradinaj, dhe mbetet në gatishmëri për veprime juridike e politike sipas kërkesës së Ambasadës së Kosovës në Francë dhe ekipit mbrojtës të zotit Ramush Haradinaj.

Më 6 janar 2017, Ministria e Drejtësisë po ashtu u bashkërendua me Ministrinë e Drejtësisë së Shqipërisë për veprime juridike e politike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Francës për rastin e zotit Ramush Haradinaj. Njëkohësisht Ministria e Drejtësisë është në proces të organizimit të një takimi të drejtpërdrejtë me ministrin e Drejtësisë së Francës për këtë rast.

Më datë 9 janar 2017 Ministria e Drejtësisë, pas bashkërendimit me Ambasadorin e Kosovës në Francë, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Policinë e Kosovës, e ka dërguar edhe shkresën e tretë, me të cilën ka kërkuar lirimin e Ramush Haradinajt dhe refuzimin e çdo kërkesë që mund të paraqitet nga Serbia për ekstradimin e tij.

Po ashtu, Ministria e Drejtësisë ka ofruar prova në bazë të rasteve të mëhershme dhe në mbështetje të kërkesës për lirimin e zotit Ramush Haradinaj si dhe ka argumentuar që ndalimi i tij është kryekëput politikisht i motivuar dhe pa bazë juridike.

Gjithashtu dua të theksoj se në nëntor të vitit 2016 Ministria e Drejtësisë dhe Policia e Kosovës kanë kërkuar nga Interpoli heqjen e zotit Ramush Haradinaj dhe shtetasve të tjerë, pa dallim, të Republikës së Kosovës nga lista e personave të kërkuar.

Kërkesa është bërë nga Policia e Kosovës nëpërmjet UNMIK-ut, i cili e ka dorëzuar kërkesën tonë në Interpol më 16 dhjetor 2016, si dhe vetë ka protestuar kundër përfshirjes së zotit Ramush Haradinaj dhe të gjithë shtetasve të tjerë të Republikës së Kosovës në listën e Interpolit.

Pritet vetëm përfundimi i procedurave të brendshme në Interpol që zoti Ramush Haradinaj dhe shtetasit e tjerë të Republikës së Kosovës, që ndiqen për krime lufte kinse të kryera në territorin e Republikës së Kosovës, të hiqen nga kjo listë.

Duhet theksuar se Ministria e Drejtësisë, në bashkërendim me Prokurorin e Shtetit dhe me Policinë e Kosovës, vazhdimisht ka kundërshtuar kërkesat për ndjekjen e shtetasve të Republikës së Kosovës për vepra penale kundër të drejtës ndërkombëtare, kinse të kryera në territorin e Kosovës dhe veçanërisht në raport me Serbinë ka refuzuar çdo bashkëpunim me palën serbe në këtë drejtim.

Po ashtu, duhet të theksohet se Ministria e Drejtësisë i ka mbajtur të informuar përfaqësuesit e Aleancës së Ardhmërisë së Kosovës për të gjitha veprimet që i ka ndërmarrë me rastin e zotit Haradinaj dhe ua ka dhënë në dispozicion të gjitha shkresat dhe komunikimet.

Ministria e Drejtësisë është për një qasje plotësisht transparente dhe bashkëpunim dhe do të vazhdojë me këtë qasje në interesin e të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës.

Ministria e Drejtësisë së Kosovës e ka ftuar Ministrinë e Drejtësisë dhe autoritetet e tjera kompetente të Republikës së Francës për lirimin e zotit Haradinaj, të hedhë poshtë dhe të shpërfillë të gjitha kërkesat e bëra ose që do të bëhen në të ardhmen nga Serbia në lidhje me zotin Haradinaj dhe të ngjashme, në bazë të vendimeve të marra nga gjykatat jokompetente serbe.

Po ashtu kam theksuar se njoftimet apo vendimet pranë Interpolit nuk duhet të shqyrtohen pa pëlqimin e Republikës së Kosovës.

Ministria e Drejtësisë është e gatshme dhe ka afruar garanci për autoritetet franceze nëse shihet e nevojshme, në mënyrë që zoti Haradinaj të lirohet menjëherë.

Pra, ju siguroj se Ministria e Drejtësisë, në kuadër të mandatit të saj, ka ndërmarrë dhe do të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura dhe të nevojshme për lirimin sa më të shpejtë të zotit Haradinaj. Faleminderit!

KRYETARI: Ndërkohë e falënderojmë dhe e përshëndesim për prezencën e tij sot së bashku me ne ambasadorin William Walker që e kemi në seancë.

Vazhdojmë me punimet e seancës. Zoti ministër i Brendshëm, Skender Hyseni, fjala për ju. Ndërkohë bëhet gati zonja Melihate Tërmerkollli.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,  
Zëvendëskryeministra,  
Të nderuar deputetë,  
Shumë e nderuar familje Haradinaj,  
I nderuar ambasador Walker,  
Zonja dhe zotërinj,

Kryeministri Mustafa e theksoi në start që të gjitha dikasteret përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës kanë qenë të angazhuara gjatë gjithë kohës që nga momenti i ndalimit të ish-kryeministrit Haradinaj që të koordinohen plotësisht, në mënyrë që të përfaqësohet çështja në linja institucionale, përkatësisht nëpërmjet Ministrisë së Jashtme dhe asaj të Drejtësisë, që janë dikastere që në këso rastesh rregullojnë marrëdhëniet mes vendeve.

Absurditeti i ndalimit të zotit Haradinaj nuk mund të përshkruhet me fjalë, sepse është zoti Haradinaj ai që e ka dëshmuar pafajësinë e vet në dy raste në Gjykatën Ndërkombëtare për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi.

Unë jam i sigurt që me të njëjtin fuqi dhe kurajë Ramush Haradinaj beson sot edhe në drejtësi franceze. Kur ka shkuar Ramush Haradinaj në paraburgim në Hagë në vitin 2010, një ditë pas vendimit madhor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Jam entuziazmuar me besimin se Ramush Haradinaj e kishte në drejtësinë ndërkombëtare dhe është pikërisht ai besim i madh që Ramush Haradinajn e ka kthye nga Haga faqebardhë.

E përmenda këtë moment me një qëllim të vetëm, pa hyrë në detaje çfarë kam bërë unë si ministër i Brendshëm këto ditë, çfarë ka bërë qeveria e Kosovës, sepse ato u thanë.

E përmenda që ta theksoj nevojën e besimit në drejtësinë ndërkombëtare dhe drejtësia franceze është pjesë e drejtësisë ndërkombëtare.

Unë kam besim njësoj siç jam i sigurt ka besim Ramush Haradinaj që ai do të lirohet shpejt, sepse nuk mund të bindem që drejtësia franceze do të manipulohet nga absurditeti i një fletarrestimi të lëshuar nga Republika e Serbisë.

E kam vizituar Ramush Haradinajn atëherë për të demonstruar qartë, si ministër i Jashtëm, që shteti qëndron pas një luftëtari të lirisë të shtetit të vet. Shteti edhe sot qëndron fuqishëm pas Ramush Haradinajt si luftëtar i lirisë, një ish-kryeministër i Republikës së Kosovës, i cili me besim të madh në drejtësinë ndërkombëtare, në argumentin e vet në fuqinë argumentuese të vetvetes dy herë radhazi vullnetarisht i është dorëzuar drejtësisë ndërkombëtare.

Prandaj, unë edhe një herë shpreh besimin tim të paluhatshtëm që drejtësia ndërkombëtare, që është drejtësia franceze, në këtë rast, do të dominojë mbi dimensionin e paskrupullit dhe absurditetin e fletarrestimeve serbe. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti ministër! Zonja Tërmkolli e ka fjalën. Ndërkohë zonja Hadërgjonaj, në qoftë se vjen, e ka kërkuar fjalën.

**MELIHATE TËRMKOLLI:** Faleminderit!

Vazhdimisht nëpër seanca po na përsëritet nga pak patriotizëm, nuk e di, ndoshta nganjëherë edhe ka nevojë, por nuk është fort i mirë patriotizmi të mbulojë punën e Kuvendit të Kosovës.

Në fakt, ne sot po flasim për një çështje shumë të rëndësishme, sepse arrestimi i Ramush Haradinajt nuk është thjesht goditje ndaj një personaliteti, është goditje ndaj shtetit, është lojë e rrezikshme me shtetin e Kosovës.

Fjalët për gjoja çështje të drejtësisë janë thjesht përralla. Të gjithë e dimë, edhe Kosova e di, edhe Serbia, edhe Franca, edhe Bashkimi Evropian, të gjithë e dinë që ky rast është kryekëput politik, nuk ka të bëjë absolutisht me drejtësinë.

Dhe, duke qenë i tillë, unë nuk dua të besoj që Franca, djep i lirisë edhe të drejtave të njeriut, të bëhet bashkëpunëtorë dhe bashkëfajtorë e politikës agresive dhe destabilizuese të Serbisë ndaj Kosovës.

Natyrisht, ne duhet t'i ruajmë marrëdhëniet e mira gjithsesi me Francën, edhe me të gjitha shtetet e tjera mike, por atë që e tha ministri i Jashtëm këtu se edhe Franca e di që është çështje politike le shumë për të dëshiruar, sepse nëse vërtet e di që është çështje politike, Ramush Haradinaj, sot do të duhej të ishte në Kosovë.

Ne mund të kontestohemi mes veti, siç po kontestohemi shumë herë, por diçka kurrë nuk mund të kontestojmë për Ramush Haradinajn, nuk mund të kontestohet lufta dhe kontributi i tij prej heroit për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës si luftëtar, si kryeministër, si kryetar partie dhe, në fund të fundit, qytetar i Republikës së Kosovës.

Në fakt, e keqja që po na ndodh neve vazhdimisht është se disi Serbia po bën çfarë po do me Kosovën dhe në Kosovë. Madje, në njëfarë mënyre, sikur po na imponon edhe agjendën e Kuvendit. Ne po merremi çdo ditë me nga një rast e një rast, si pasoja të veprimeve të Serbisë. Për çdo ditë po mbajmë seanca pas çdo pasoje si veprim i Serbisë. Unë mendoj që këtë praktikë ne duhet ta ndryshojmë.

Kemi mbajtur seancë për arrestimin e eprorit të Policisë, për murin, për Parkun e Paqes, qe pesë vjet, herë park i luftës, herë i paqes, herë i drejt, herë i të birit, nuk e di më çfarë tjetër po ndodh këtu.

Dhe, diqysh po presim sikur ligji t'i marrë vetë këmbët dhe t'i zgjidhë krejt këto probleme. Nuk e di ai i merr ligji këmbët vetë të shkojë t'i zgjidhë problemet.

Në fakt, neve na duhet veç një seancë, ne duhet të zgjidhim vetëm një problem dhe çështja kyçe janë bisedimet me Serbinë. Çelësi i problemit janë bisedimet me Serbinë dhe në vend të bisedimeve për rregullim të brendshëm të Kosovës, që fatkeqësisht në shumicën e rasteve ka ndodhur deri tani, duhet t'i kthejmë në bisedime për, ashtu siç po quhen, normalizim të marrëdhënieve me Serbinë.

Duke biseduar për rregullim të brendshëm të Kosovës, ne po ia njohim një pjesë të sovranitetit të Serbisë në Kosovë, fatkeqësisht.

Prandaj, kjo duhet ndryshuar urgjentisht dhe unë propozoj që është i domosdoshëm dhe me urgjencë ridimensionimi, koncept substancë dhe format tjetër në bisedimet me Serbinë.

Kjo mendoj është çështja kyçe dhe do ta propozoja, nëse pajtohen, natyrisht, kur ta bëjnë rezolutë a çfarëdo qoftë, mendoj që kjo duhet të jetë çështja kyçe esenciale e vendimit të sotëm të Kuvendit të Kosovës edhe për çështjen Haradinaj, edhe për të gjitha çështjet e tjera, sepse ne përditë edhe më tutje do të merremi me këto probleme.

Ju lutem, ridimensionim, koncept i ri, substancë dhe format tjetër i bisedimeve. Bisedime për normalizim të marrëdhënieve vërtet me Serbinë. Natyrisht, institucionet e Kosovës, jam e bindur, që kanë fuqi dhe duhet të kenë fuqi ta kthejnë njeriun në shtëpi. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Vlera e lirisë së Kosovës është kontribut dhe vlerë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është vlerë e luftëtarëve të rënë, është vlerë e Ramush Haradinajt dhe e mijëra luftëtarëve të tjerë, sot heronj të gjallë, që punojnë dhe veprojnë për forcimin e shtetit tonë, shtetit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Pastërtia e luftës të ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e bëri botën demokratike të radhitet në anën tonë, e solli NATO-n në Kosovë.

Pastërtia e luftës e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u dëshmuar edhe në dy procese ndërkombëtare në Hagë, pjesë e së cilës ishte edhe zoti Ramush Haradinaj dhe dolën fitimtarë.

Nuk ka si të mos ndjehesh e indinjuar me faktin që me akuzat politike të pabaza të një shteti që bëri masakra e gjenocid në vendin tonë ndalen luftëtarët tanë nëpër vende të ndryshme të Evropës.

Arrestimi i Ramush Haradinajt sipas fletarrestimeve të një shteti që ka ushtruar dhunë, gjenocid në vendin tonë është veprim që tejkalon vlerat e demokracisë.

Të futet në listat e Interpolit sakrificat për liri, pavarësi dhe demokraci e njerëzve që mbrojtën vendin nga një regjim kriminal, pikërisht nga Serbia, që bëri gjenocid të paparë në vendin tonë,

është veprim që nuk i kontribuon paqes dhe sigurisë në rajon, është veprim që nuk ka të bëjë as me ligjin, as me drejtësinë.

Si i tillë është i dënueshëm dhe kërkoj nga Qeveria që të marrë të gjitha veprimet e nevojshme si dhe nga vendet demokratike të Evropës që të mos lejojnë veprime të tilla dhe të mos bien pre e vendimeve politike e propagandës denigruese të Serbisë që vazhdon ta bëjë ndaj vendit tonë.

Arrestimi i Ramush Haradinajt ka ngrehur tensione në vendin tonë, veprimi i tillë nuk i kontribuon normalizimit të marrëdhënieve në mes të dy vendeve, për të cilat shteti ynë ka bërë shumë nisur nga fakti se kemi pësuar shumë nga veprimet gjenocidiale të shtetit serb.

Nuk është mirë të denigrohet lufta mbrojtëse dhe për lirinë e vendit tonë, sepse kështu nxiten ndjenjat hakmarrëse që është vështirë të menaxhohen.

Nuk ka qenë e lehtë të bësh përpjekje për paqe, për miqësi, kur ke humbur me mijëra jetë të njerëzve dhe kur ke pësuar një shkatërrim të paparë nga dhuna dhe terrori që u bë me vite të tëra në vendin tonë.

Fletarrestimet e Serbisë për qytetarët e Kosovës, shtet të pavarur, nuk i kontribuojnë paqes në Ballkan, por tensionojnë situata, të cilat nuk di se ku mund të ndalen.

Përfshirja e një numrit të luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në listat e Interpolit me akuza të pabaza nga Serbia është abuzim me qytetarët e një shteti tjetër.

Ky veprim i Serbisë që po bën nëpërmjet Interpolit duhet të ndalohet nga shtetet demokratike që e respektojnë drejtësinë, ligjin dhe rendin.

Misioni Evropian, i cili ende ka kompetenca në sundimin e ligjit në Kosovë, duhet të jetë më i zëshëm në zgjidhjen e problematikës së fletarrestimeve serbe ndaj qytetarëve të Kosovës, duhet të na japë përkrahjen më të fuqishme që Kosova të jetë pjesë e Interpolit, në mënyrë që të mos rrezikohet stabiliteti rajonal dhe më gjerë.

Është e pakuptueshme pse nuk është bërë pjesë e bisedimeve me Serbinë lista e Serbisë për qytetarët e Kosovës dërguar në Interpol?

Ne mund të ngremë edhe shumë shqetësime të tjera lidhur me bisedimet, por duhet t'i koordinojmë politikat tona, lufta politike nuk guxon të na largojë nga ideali i popullit tonë që të punojë e të sakrifikojë shumë për formimin e ndërtimin e shtetit tonë.



Ne mund të bëjmë kritika ndaj institucioneve që të punojnë më shumë, të jenë azhure e të përkushtuara, të luftojnë fuqishëm korrupsionin dhe dukuritë negative të cilat janë prezentë në vendin tonë, për të punuar më shumë e më mirë për të lëvizur këtë vend në drejtim të forcimit të shtetit dhe forcimit të demokracisë në vend.

Po është naivitet i llojit të vet të thuash që e ka dërguar në burg institucioni apo individët që i udhëheqin këto institucione, këtë apo atë person, po i izolon ky apo ai person luftëtarët e lirisë.

Ne nuk guxojmë të rrëshqasim në propagandën e Serbisë e të fyejmë, të shajmë e të përçahemi me njëri-tjetrin.

Nuk guxojmë të lejojmë që të bëhet politika serbe në Kosovë për interesa të caktuara politike nëpërmjet ndonjë portali të pakontrolluar apo edhe nëpërmjet ndonjë emisioni apo mediumi televiziv që nuk na konvenon në këto momente të caktuara, kur ne po përballemi me politikën tepër jodemokratike të një shteti ndaj shtetit të Kosovës.

Kjo nuk guxon të na ndodhë neve, kur të gjithë e dimë se Serbia është ajo që ka hartuar lista dhe që bën luftë të vazhdueshme me atdhetarët tanë. Ajo nuk mund të pajtohet kurrë që njerëzit që e bënë luftën në Kosovë të jenë pjesë e ndërtimit dhe forcimit të shtetit të Kosovës. Sot më shumë se kurrë na duhet uniteti mes veti, na duhet puna e përbashkët, sakrificë e përbashkët, unitet i qëndrimeve dhe i veprimeve kur është çështja e mbrojtjes së interesave të shtetit tonë, sepse vetëm kështu do të jemi më të fortë, do të arrijmë të realizojmë idealet tona dhe vetëm kështu do të kemi përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare, për të cilën kemi nevojë shumë.

Të nderuar deputetë,

Kërkoj nga Qeveria që të vazhdojë të angazhohet edhe më tutje, qoftë në aspektin politik, por edhe në aspektin e drejtësisë që zoti Ramush Haradinaj sa më shpejt t'i bashkohet familjes dhe t'i bashkohet aktivitetit politik në subjektin e tij politik në të mirë të shtetit të Kosovës dhe demokracisë në vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Demaku.

PUHIE DEMAKU: Faleminderit, kryesues!

Është e pamundur të flasësh për rastin Haradinaj e të mos ndalesh qoftë edhe për pak te premtimet e kësaj Qeverie.

Kur them kësaj Qeverie, nënkuptoj edhe Qeverinë Thaçi Një dhe Dy, ngase kjo e Isës është veçse vazhdimësi e mendësisë, metodave e strategjisë për fundosjen e shtetit nëpërmjet abuzimit me pushtet dhe paaftësisë për të ndërtuar shtet, e premtimet i kanë saktësisht të njëjta, fjalë boshe.

Sikur asnjëherë më parë, Serbia gjatë vitit që lamë pas ka sfiduar ekzistencën e Kosovës dhe përkundër dëshirës të shumë neve këtu që ajo të dështonte, për shkak të kësaj qeverisje ajo ka korrur sukses në dëm tonin, natyrisht.

Secilën herë që është dëmtuar Kosova, me faj të Serbisë dhe të Qeverisë, Qeveria e ka drejtuar gishtin kah opozita, bile kohët e fundit edhe kah shoqëria civile, thua se spektri i gjerë i fajtorëve ua lehtëson disi ndërgjegjen për krejt bëmat e dëmshme.

Arrestimi si ky i Ramush Haradinajt është rezultat konkret i mospunës së Qeverisë, apo më saktë, punës së mbrapshtë të kësaj Qeverie.

Asnjë nga kryeministrat e pavarësisë nuk u ndalën te substanca e dialogut aty në Bruksel, ku keni pasur mundësi të kërkonte atë që ky vend e meriton, dinjitet, ju e bëtë të kundërtën, u nënshtruat, për të shpëtuar veten tuaj, zgjodhët të fundosni shtetin.

Ju pra e keni sjellë edhe Listën serbe në Kuvend e në Qeveri, duke pranuar dhe legjitimuar ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të Serbisë dhe të Vuçiqit në Kosovë.

Ju e sollët murin në veri duke pranuar dhe legjitimuar copëtimin e territorit, e keni lejuar edhe arrestimin e ish-kryeministrit tuaj, e më herët edhe të drejtorit të Policisë të rajonit të Mitrovicës, Nehat Thaçi, do të thotë nëpërmjet veprimeve tuaja.

Ndërkohë që me shkrim, po ja u kujtoj, para këtij Kuvendi e keni premtuar edhe të kundërtën, sepse më lejoni të citoj, e keni prezantuar një plan qeverisës, ku keni thënë: “Qeveria e Kosovës do të insistojë të mbajë lart në agjendën e procesit të normalizimit çështje të reja me rëndësi, përfshirë ndërprerjen e ndërhyrjeve të Serbisë në Kosovë në fushat e tjera që nuk janë të trajtuara me marrëveshje të Brukselit. Satisfaksioni, pranimi i përgjegjësive për luftën dhe dëmet, drejtësia dhe dënimi i aktorëve të luftës për gjenocid, krimet ndaj popullatës së Kosovës, përfshirë dhunimin e grave si mjet i luftës, kërkim fajla publike për krimet e bëra në Kosovë” dhe këto janë vetëm dy nga tetë pikat që ju i keni premtuar në planin tuaj qeverisës se do t’i adresoni në dialog dhe, përkundër paralajmërimeve, përkundër realitetit në terren, përkundër luftës speciale që Serbia e ushtron ndaj Kosovës, çdo ditë, ama bash çdo ditë, ju ende nuk u këndellët, ju ende nuk u bindët që qasja ndaj Serbisë duhet të jetë ndryshe.

Këto besoj që janë argumente të mjaftueshme që ju e keni vendin në shtëpi, qe besa, edhe në burg.

Reagimi juaj i vonuar dhe i vobektë, jo vetëm për këtë ngjarje, por sa herë që Serbia godet, e bën edhe më të qartë se ju jeni bashkëfajtorë për bëmat e Serbisë. Përgjegjësinë e bartni ju, pasojat po i bart shteti dhe populli, por llogaritë barazohet dikur, le të shpresojmë sa më shpejt.

Ministri i Jashtëm në fjalimin e tij këtu na tha se edhe konstatoj shumë mirë që besa se çfarë qasje armiqësore ka Serbia ndaj Kosovës dhe tha se duhet ta mendojmë se si Qeveria e si Kuvendi si t'i qasemi Serbisë.

Atëherë po ia propozoj edhe një herë ministrit dhe këtij Kuvendi dhe Qeverisë atë që Lëvizja “Vetëvendosje” e ka propozuar disa herë, e më herët edhe kolegu Kurteshi e përmendi: Qeveria e Kosovës menjëherë duhet të ndalojë importin e mallrave të Serbisë në Kosovë dhe t'i ndërpresë negociatat deri në momentin kur Serbia ta njohë pavarësinë e Kosovës. Pas njohjes së pavarësisë negociatat mund të fillojnë, të zhvillohen vetëm mes dy shteteve sovrane dhe të pavarura, mbi parimin e reciprocitetit.

Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të vendosë embargon ndaj shtetit të Republikës së Serbisë, pra t'i marrë të gjitha masat e reciprocitetit të plotë politik, ekonomik dhe tregtar ndaj Serbisë dhe derisa këto të mos ndodhin, atëherë natyrisht që do të kemi edhe arrestime të tjera dhe do të kemi një Serbi, e cila do të intervenojë çdo ditë, sepse e kemi sjellë ju në këtë Kuvend dhe në këtë Qeveri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Familje e nderuar Haradinaj, simbol i lirisë së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Po filloj me një deklaratë të shefit të Prokurorisë serbe se Haradinajn do ta luftojmë sa të jetë gjallë, sepse kjo është shumë domethënëse.

Me këtë Serbia faktikisht deklaroi se për ta Ramushi e simbolizon Kosovën dhe shtetin e saj, sepse Ramush Haradinaj është hero dhe i tillë do të mbetet, sepse gjatë luftës kjo po i pengon Serbisë, sepse gjatë luftës mbrojti shtetin e vet e sot në liri po mbron sovranitetin dhe integritetin e shtetit tonë.

Çdo shqiptar e di se sa të jetojë Kosova Serbia është armike e saj dhe gjithmonë e tillë do të mbetet, sepse edhe sot kështu po sillet.

Kjo nuk është hera e parë që zoti Haradinaj ndalohet në bazë të një fletarrestimi serb.

Në qershor të vitit 2015 ai u ndalua në aeroportin e Lubjanës, në Slloveni, derisa po kthehej nga një vizitë zyrtare në Berlin.

Ai dha dorëheqje nga posti i kryeministrit të vendit më 8 mars të vitit 2005, për t'u dorëzuar vullnetarisht në Gjykatën e Hagës, Prokuroria e së cilës i akuzonte atë e dy bashkëluftëtarët e tij për krime lufte.

Procesi kundër zotit Haradinaj filloi më 5 mars të vitit 2007 dhe përfundoi në prill të vitit 2008 me pafajësinë e tij.

Zoti Haradinaj u rikthye në rigjykim të pjesshëm në korrik të vitit 2010, që është rasti i parë i atij lloji në veprimtarinë e Gjykatës Ndërkombëtare për Krime Lufte në hapësirat e ish-Jugosllavisë. Më 29 nëntor të vitit 2012 ai sërish u shpall i pafajshëm.

Serbia është fajtores për katër luftëra në Ballkan: kundër Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjës dhe Kosovës.

Forcat militare dhe paramilitare serbe gjatë luftës bënë spastrim etnik në Kosovë, nga janari 1998 deri në qershor të vitit 1999 kanë vrarë në mënyrë krejt arbitrare mbi 10 mijë civilë shqiptarë, përfshirë këtu 1 882 persona mbi 65 vjeç, 1 741 gra, 1 400 fëmijë dhe 1 450 persona akoma të pagjetur, trupat e të cilëve gjenden në varrezat masive të hapura në Serbi. Kanë dhunuar mbi 20 mijë gra e vajza shqiptare, kanë djegur dhe shkatërruar gjithçka dhe kanë çuar në zhvendosjen e mbi 1 milion civilëve shqiptarë, duke ikur nga lufta e spastrimi etnik, kryesisht në drejtim të vendeve fqinja.

Tmerri i shkaktuar në opinionin publik botëror nga ky gjenocid i forcave militare e paramilitare serbe ka çuar në bombardimet e NATO-s nga 24 marsi deri më 10 qershor 1999. Ishte UÇK-ja, e drejtuar veçanërisht nga zoti Haradinaj që i ka ndihmuar forcat e NATO-s në terren dhe që ka evituar përmasat më të mëdha kundër gjenocidit të popullit shqiptar të Kosovës. Kosova e ka shpallur në mënyrë të njëanshme pavarësinë e saj, më 17 shkurt 2008, e njohur të nesërmen nga Franca, e deri tani edhe nga 118 shtete në botë.

Tribunali special do të duhej ta kishte vënë para përgjegjësisë Serbinë si agresore, e jo Kosovën, që është viktimë e regjimit barbar të Milosheviqit. Gjykata Speciale, që u detyruam ta formojmë në Kosovë, është dashur të krijohet në Serbi. Si ka mundësi që urdhërarrestet e vendit agresor të një lufte që e përfshiu vetë NATO-n kundër atij vendi të mund ende sot të vlejné si mandate legjitime të policëve, të një sërë vendeve evropiane, për të burgosur luftëtarët që iu kundërvunë atij agresori. Pse pafajësia që Ramush Haradinaj mori nga Gjykata e Hagës nuk i mjaftoi këtij vendi mik për të mos e arrestuar? Shteti dhe institucionet e Kosovës po sfidohen vazhdimisht, nisur kryesisht edhe nga veprimet krye më vete, të cilat vijnë nga komnatat serbe, veriu, e po ashtu edhe nga deputetët serbë në Kuvendin e Kosovës, të cilët vazhdojnë t'i bllokojnë ligjet e rëndësishme për Kosovën.

Kosova, jo vetëm që po sfidohet, por po i cenohet integriteti dhe sovraniteti i saj territorial. Është e dhimbshme të thuhet, mirëpo Serbia bashkëqeveris me Kosovën nëpërmjet Listës serbe. Ne e dimë që Lista Serbe në vazhdimësi e ka bllokuar, e ka shantazhuar në përgjithësi shtetin e Kosovës, duke mos e pranuar, duke e bojkotuar punën e institucioneve, e kështu me radhë.

Dhe, ata që na thonë se në veri të Kosovës është shtrirë sovraniteti dhe integriteti territorial, ata që thonë që strukturat paralele nuk funksionojnë, ata thjesht po na gënjejnë për shkak se strukturat paralele funksionojnë gjithandej, jo vetëm në veri, por funksionojnë edhe në pjesët tjera ku ka serbë në Kosovë. Mosangazhimi i gjyqësisë së Kosovës, përfshirë këtu edhe UNMIK-un edhe EULEX-in, me krimet e luftës që Serbia i ka bërë në Kosovë, e kanë sjellë vendin tonë në këtë ditë, duke ia dhënë Beogradit luksin e abuzimit dhe manipulimit me sistemin e Interpolit.

Këto ditë reagues shumë. Reagues qytetarët e Kosovës, të cilët i falënderojmë, Diaspora, eurodeputetët, reagues edhe senatorë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Qeveria e Shqipërisë, e cila dha maksimumin për të mundur që zoti Haradinaj të kthehet sa më parë në vend. Andaj, në fund, është momenti i fundit që Kosova të sillet si shtet, sepse çka është boll - është boll.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Fatmir Limaj.

FATMIR LIMAJ: I nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Besoj se si pikënisje në këtë seancë duhet t'i japim një trajtim kësaj çështjeje, ashtu siç është. Rasti e seanca e thirrur për këtë rast, rasti i zotit Haradinaj duhet të trajtohet ashtu siç është. Pikënisja është: Zoti Haradinaj është ndaluar në Francë, arsyet janë politike. Çështja është politike dhe jo e drejtësisë. Çështja është politike dhe jo e drejtësisë, sepse zoti Haradinaj i ka përfunduar çështjet me drejtësinë dhe këtu është pikënisja besoj unë e diskutimit të mëtutjeshëm dhe e trajtimit të kësaj çështjeje.

Po të ishte çështje e drejtësisë do të ishim në një situatë krejt tjetër. Akti, veprimi dhe ndalimi i zotit Haradinaj është ndalim politik, dhe jo i drejtësisë. Prandaj, nga kjo, duke u nisur nga kjo, na dalin së paku tri çështje për të cilat besoj që ne duhet të diskutojmë. Ndalimi i zotit Haradinaj ngre së paku tri çështje, të cilat besoj unë duhet të trajtohen këtu e në të ardhmen, dhe ato janë:

1. Integriteti dhe dinjiteti i shtetit të Kosovës, një.
2. Mbrojtja dhe trajtimi i qytetarëve të Republikës së Kosovës, dhe
3. Raporti ynë me shtetin tonë.

Çështja e zotit Haradinaj nuk duhet të trajtohet si çështje personale, një ndalim personal i tij, por duhet të shihet dhe duhet të trajtohet si një atak në integritetin territorial shtetëror dhe sovranitetin e këtij vendi.

Në qoftë se pajtohemi të gjithë që është akt politik, e kjo nuk na lë shumë vend dhe hapësirë neve, as kurrkujt tjetër, sepse kjo në fakt është çështje politike, se kur ishte çështje drejtësie, atë veç e ka dëshmuar Gjykata e Hagës, atëherë çka në fakt po ndodh me ne dhe nga kush po preket ky integritet shtetëror, ose atak në integritetin shtetëror të vendit tonë? Vazhdon të preket nga ata, të cilët, e përkufizoi më herët njëri nga parafolësit, nga një politikë shoviniste e Serbisë.

Cilat janë masat dhe angazhimet tona në mbrojtje të këtij integriteti tonë shtetëror? Cilat janë angazhimet tona në mbrojtjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët janë në atak, ose ndëshkohen për qëllime politike? Ndalohen, abuzohen, keqtrajtohen, me të vetmin qëllim, sepse janë qytetarë të këtij vendi të Kosovës, dhe se e kanë dhënë kontributin e tyre maksimal në lirinë e Kosovës, në shtetësinë e Kosovës. Pse çështja e zotit Haradinaj nuk do të shihet si çështje individuale dhe individi Haradinaj? Sepse zoti Haradinaj e personifikon shtetësinë e Kosovës. Jeta, vepra, angazhimi i tij njerëzor, familjar personifikon themelet e ndërtimit të këtij shteti që sot ne e gëzojmë dhe jorastësisht ai atje atakon. Nuk është atak në personin fizik të zotit Haradinaj sulmi serb, gjuetia serbe. Jo! Kjo do të ishte e keqja më e vogël e mundshme.

Ataku në figurën e zotit Haradinaj është atak në themelet e shtetësisë së Kosovës, nga një shtet i cili kurrë s'është pajtuar, s'do të pajtohet, punon, nuk do të ndalet që çdo gjë të rrënohet, të minohet ky shtet, të cilin e kemi krijuar.

Prandaj, kërkoj nga ju, kolegë deputetë, që ta trajtojmë në këtë mënyrë dhe kështu unë e shoh këtë seancë parlamentare sot. Ku është vendi ynë? Çka duhet të bëjmë ne që ta mbrojmë integritetin e shtetit tonë? Cilat janë masat dhe angazhimet tona për t'i mbrojtur qytetarët e vendit tonë nga një shtet i cili nuk pranon, punon, nuk ndalet në rrënimin e lirisë dhe shtetit të Kosovës. Dhe, kjo e sjell menjëherë çështjen e raportit tonë me shtetin tonë.

Dëgjuam nga ministrat për angazhimet që ata kanë bërë këto ditët e fundit dhe krejt këtë çështje e lidhin me çështjen individuale të zotit Haradinaj, 3 ditë, 4 ditë, 5 ditë, çka u bë, çfarë ka ndodhur.

Por, nuk e dëgjuam asnjë fjalë për të na treguar çfarë kanë bërë që pesë vjet për mos ardhur deri te kjo. Jo nga dita kur është ndaluar zoti Haradinaj, por çka kanë bërë përpara që të mos vijë deri te kjo, për ta ruajtur integritetin e shtetit tonë. Deri kur politika kosovare do të merret me reagime ditore? Deri kur ne do ta kemi një politikë e cila reagon, kundërpërgjigjet, shpreh hidhërimin? Dhe, ajo fashitet sikur flaka e kashtës pas dy ditësh.

Ne edhe një herë jemi takuar këtu dhe kemi bërë një rezolutë me rastin e ndalimit të zotit Haradinaj në Slloveni. Unë do ta kuptoja shumë që po të ishte një rast e do të na zinte në befasi, i panjohur, natyrisht në raste të tilla edhe angazhimet janë pak stihike derisa të konsolidohet.

Unë e kuptoj të mos kishte angazhim, po të ndodhte diçka për herë të parë dhe e papritur. Kjo çështje nuk është e panjohur për ne. Nuk ka qenë e panjohur për Qeverinë tonë. Unë do të doja sot që Qeveria e Kosovës të na tregonte çfarë ka bërë për vitet në vazhdim deri sot për ta parandaluar që të mos vijë një situatë që na ka ardhur. Së paku nga rezoluta e herës së kaluar, që është miratuar në Parlamentin e Kosovës. Unë do të doja sot të dija raste, së paku pesë nja pesë raste që këta të na tregojnë që gjatë bisedimeve me Serbinë kemi folur me këtë datë, me këtë muaj, për këtë çështje, ka qenë temë kjo, ka qenë temë çështja e të pagjeturve, ka qenë temë çështja e pastrimit të listave, e me radhë.

Unë do të doja që sot Qeveria jonë të dilte me dhjetëra letra para nesh për të na treguar, ja letra një, dy, tre, dhjetë, pesëmbëdhjetë, letra të dërguara ose të bashkëbiseduara, qoftë në Bruksel, e nëpërmjet Brukselit edhe me Serbinë. Unë do të doja që sot ministri ynë i Jashtëm të dilte dhe të thoshte për takimet bilaterale për secilin shtet që e ka njohur Kosovën, e që ka pasur angazhim, të mos ndodhin këto gjëra që kanë ndodhur sot. Komunikim nëpërmjet letrave, se Qeveria e Kosovës e ka marrë seriozisht rezolutën e Parlamentit të kaluar për të parandaluar situata të tilla.

Ne nuk i dëgjuam asnjë nga këto. Ato që i dëgjuam sot janë zakonisht ato llafet që ne i bëjmë, si në kafe, shtëpia, në oda, fola në telefon, i thashë, më tha, e pashë, i bëra selam, më ka thënë fjalë të mira, e kjo është për shqetësim. Shikoni, historia e Kosovës, e kaluara na ka treguar që disa njerëz, disa janë edhe këtu, me qëndrimin e tyre në burg më shumë i kanë ndihmuar Kosovës, se sa ata që kanë qenë duke e drejtuar Kosovën. Jo ajo histori e largët, e viteve të '60-ta-'70-ta. Edhe sot zoti Haradinaj është një dhunti, sikur vazhdimisht, edhe sot me qëndrimin e tij më shumë është duke e ndihmuar ai Kosovën, pavarësisht vuajtjeve familjare, personale të prindërve të tij, të fëmijëve të tij dhe të tij personalisht. Del që sot zoti Haradinaj përsëri me ndalimin e tij është duke i ndihmuar më shumë Kosovës se sa janë duke i ndihmuar drejtuesit e saj.

Është ky paradoks, por kjo historia jonë e kaluar ka shumë paradokse, sikur që, më lejoni të kthehem në histori, sa krejt të gjallët vepra e Skënderbeut i ka shërbyer kombit shqiptar. Thashë, vepra e Skënderbeut tregon më së miri që i ka shërbyer kombit shqiptar më shumë se krejt të gjallët këtu, sa kanë bërë për pesë shekuj, vepra e Ismajl Qemajlit më shumë se krejt të gjallët. Vepra e Adem Jasharit më shumë se krejt të gjallët i ka shërbyer kombit shqiptar. E ndërlidha të kaluarën për të ardhur te burgosurit të viteve të '70-ta, që në fund ta mbyll për të treguar që edhe seanca sot nuk është kush të bëjë gara, kush e do më shumë Ramushin. Gara sot është dhe jam i bindur që ai pret nga ne, sepse është angazhim i përditshëm i tij - çka po duam të bëjmë me këtë shtet tonin? A e kemi ndërmend ta kthejmë mbarë, a e kemi ndërmend që të vazhdojmë kështu, qysh jemi sot?

A ka mundësi që ky Parlament, shyqyr shpejt e ka fundin, të kthehet e të mos bëjë garë, e t'i fërkojë duart qysh e mundëm njëri-tjetrin. A ka mundësi në këtë Parlament që njëherë të bisedohet, të trajtohet, që t'i renditim gjërat në interes të vendit dhe që të dalim të themi 'bëmë diçka të mirë për vendin tonë', 'filluam diçka të bëjmë mbarë e mirë'. Besoj që kjo është ajo që neve na duhet. Përkufizimi, imagjinoni, tha ministri i Jashtëm i Kosovës, 'është politika zyrtare e Qeverisë së Kosovës, është politika zyrtare e Kosovës'. E dha një përkufizim të Serbisë. Çka është duke bërë Serbia në raport me Kosovën? Serbia është armiqësore, ka politikë armiqësore, po këqyr ta rrënojë Kosovën.

Në fund, kur u kthye, çka të bëjë Kosova, tha "duhet të na tregoni ju si Parlament çka të bëjmë ne". Kështu ishte përfundimi i tij. Pesë vjet bisedohet me Serbinë, e sot po thonë që s'dinë çka të bëjnë, na tregoni çka duhet të bëjmë ne me Serbinë, si t'i kundërvihemi kësaj politike armiqësore. Një gjë duhet ta kemi të qartë: Kur Serbia e ka marrë një politik offensive, ajo e di saktë ku do të dalë. Ajo po shpik, po improvizon, po ndërton raste të paqena, për ta rrënuar këtë vend. Ne e kemi gjithë argumentin në dorën tonë, të gjitha mundësitë dhe nuk bëjmë asgjë për ta ndryshuar qasjen tonë ndaj shtetit tonë dhe në raport me të tjerët, në këtë rast në raport edhe me Serbinë.

Unë ju ftoj që sot të jetë temë "Si do t'i qasemi ne Serbisë". U tha këtu është ndaluar ardhja e Nikoliqit. Lërimi këto se ma merr mendja që mund të shërbejnë për produkt ditor, por nuk i shërbejnë asaj për çka ne po flasim. Duhet të jemi pak më seriozë me veten tonë. Nëse vërtet dëshirojmë që edhe ne të kalojmë në një ofensivë politike diplomatike dhe që na takon, e që jemi vonuar, është reciprociteti, që nënkupton të fillohet të trajtohet ashtu siç duhet shteti serb në raport me Kosovën, të ndalohet, të ndërpritet kjo formë e dialogut, të kërkohet falje për një sjellje të tillë në raport me dialogun që u bë për 4-5 vjet, të kemi një qasje krejt tjetër në mbrojtje të dinjitetit dhe integritetit të shtetit tonë dhe dalëngadalë të kalojmë në një politikë aktive dhe joreaguese në mbrojtje të interesave të vendit tonë.

Nikoliqi, edhe Vuçiqi e Daçiqi u cilësuan me të drejtë këtu si politikë pasardhëse e Milosheviqit, por nuk u tha që ata kanë qenë kreatorë të asaj politike shfarosëse të pastrimit etnik që kanë zhvilluar në Kosovë. Organet tona të drejtësisë janë të vonuara në trajtimin e këtyre rasteve. Kosova duhet t'i përgjigjet dhe përfundimisht t'i marrë gjërat në duart e veta dhe ta trajtojë rast për rast gjithë atë që ka ndodhur në Kosovë.

Unë po e mbyll dhe po ju falënderoj për mundësinë që më dhatë që ta zgjas fjalimin, zoti kryesues, duke e përmbyllur kështu: Zoti Haradinaj do të vijë në Kosovë, do të kthehet shpejt, ama jo për meritën e juaj. Do të ishte për meritën tuaj po ta kishit parandaluar të mos futej ai brenda. Zoti Haradinaj do të kthehet në Kosovë për shkak se s'ka asgjë, asnjë llogari të pambyllur me drejtësinë. Dhe, ai do të kthehet në Kosovë falë angazhimit të tij, sakrificës së tij,



luftës së tij të drejtë, të pastër dhe betejës së tij që ka bërë në Hagë. Jo falë angazhimit tuaj! Po të ishte për angazhimin e Qeverisë, ai nuk do të ndalohej.

Prandaj, duhet të fillojmë me masa preventive dhe jo pastaj të na ndodhin gjëra dhe të vazhdojmë tërë jetën me reagime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Besim Beqaj.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Si duket, viti 2016 ishte vit i shumë sfidave në vendin tonë, një vit me shumë paqartësi në nivel vendi dhe në nivel ndërkombëtar dhe të gjitha gjasat janë si duket që kështu do të vazhdojë edhe viti 2017, me plot sfida dhe me plot gjëra, të cilat do të jenë mjaft problematike.

Qytetarët e Kosovës me të drejtë presin trajtim të barabartë me qytetarët në rajon lidhur me perspektivën e vetë evropiane, megjithëse shumë herë deri më tani populli i Kosovës dhe klasa politike kanë treguar përkushtim për bashkëpunim ndërkombëtar, klasa politike e Serbisë, edhe pse në dukje nganjëherë më e moderuar, asnjëherë as nuk e ka ndërruar qasjen, e as nuk do ta ndërrojë qasjen ndaj Kosovës dhe të gjithë ata këtë e dinë, të cilët kanë pasur bashkëpunim me Kosovën, edhe me Serbinë, gjithmonë duke pasur parasysh se gjuha e politikës serbe ndryshon, por jo edhe veprimet e tyre.

Rasti i fundit i ndalimit të zotit Ramush Haradinaj nga Policia franceze me fletarrest të Serbisë është dëshmia më e freskët për ta përkujtuar gjithë botën demokratike se kemi të bëjmë me një shtet, i cili nuk i respekton ligjet dhe të drejtën ndërkombëtare. Zoti Haradinaj në mënyrë më dinjitoze e la detyrën e kryeministrit dhe iu përgjigj drejtësisë ndërkombëtare me qëllim të dëshmisë për pafajësinë e tij dhe për pastërtinë e luftës çlirimtare të Kosovës. Dhe, kjo gatishmëri e Ramushit nuk u dëshmua vetëm një herë. Ai kaloi shumë kohë padrejtësisht në burgjet dhe proceset e padrejta për të dhe për Kosovën. Familja Haradinaj e ka dëshmuar veten në luftë dhe në paqe, duke e mbrojtur vendin në çdo kohë dhe me çdo çmim.

Lëshimi i fletarrestit nga Serbia tregon qartë se ata edhe më tutje dhe përkundër dialogut për normalizimin e marrëdhënieve vazhdojnë ta keqpërdorin Interpolin, t'i shpërfillin vendimet e drejtësisë ndërkombëtare. Kjo tregon qartë tendencën për destabilizimin e Kosovës, për tendencën për të treguar Kosovën si vend të dështuar, për ta njoftuar UÇK-në dhe personalitetet e saj dhe për nxitur veprime radikale të serbëve të Kosovës.

Përgjigjja jonë për politikën serbe do të duhej të ishte shumë e qartë. T'i bëhet e qartë se Kosova është shtet i pavarur demokratik me destinim të qartë për integrim në Evropë, në institucionet euroatlantike, sepse Kosova shikon në të ardhmen, sepse Kosova e luftoi agresorin i cili bërë gjenocid ndaj popullit shqiptar, sepse djemtë dhe vajzat më të devotshëm ishin të gatshëm të sakrifikojnë gjithçka për lirinë dhe për pavarësinë e vendit.

Ramush Haradinaj ishte një ndër luftëtarët e lirisë. Është një ndër politikanët e Kosovës i cili ushqen vendin e vet me përkushtim për shtet, për demokraci, për zhvillim dhe për vlera evropiane. Ramushi dhe gjithë klasa politike pa dallim besojnë për të ardhmen e ndritur të shtetit tonë, prandaj Ramushi e ka vendin në Kosovë, e jo në burgjet evropiane me fletarreste të Serbisë.

Unë sot i bëj thirrje Qeverisë së Kosovës ta rishqyrtojë seriozisht dialogun me Serbinë. Serbia po i burgos zyrtarët e Kosovës, po i keqpërdor në mënyrë klandestine institucionet ndërkombëtare. Serbia edhe përkundër Marrëveshjes së Brukselit po e pengon anëtarësimin e Kosovës nëpër organizata ndërkombëtare, po e pengon lëvizjen e lirë të qytetarëve, po e pengon lëshimin në funksion të linjës 400-kilovoltëshe edhe për vendin tuaj, të nderuar deputetë, kjo linjë është mundësuar me përkrahjen e rezervave financiare të Gjermanisë dhe përderisa tërë bota demokratike tenton të ndërtojë ura, ata po ndërtojnë mure.

Atëherë, kur serbët e Kosovës filluan të mendojnë vetë për të ardhmen e tyre në Kosovë, kur u kuptua se ata po përdoren si një monedhë kusurritjeje dhe mbijetese e aktorëve të caktuar politik në Serbi, atëherë kur rezultatet e dialogut filluan të tregojnë ca shenja se Serbia e ka humbur jo vetëm luftën, por edhe betejën politike për Kosovën, ata po i përdorin metodat e veta të specializuara për destabilizim të rajonit.

Integrimi i plotë i territorit të Kosovës është proces i padiskutueshëm. Besoj që këtu është treguar mjaft me IBM-in, me vendosjen e doganave në pikat kufitare, me mbledhjen e tatimeve, me buxhetin i cili i mbulon edhe komunat veriore, me futjen e zyrtarëve në sistemin administrativ dhe besoj që Qeveria e Kosovës ka mjaft dëshmi t'u tregojë që është e përkushtuar për ta integruar popullin, qytetarët serbë që jetojnë në Kosovë. Dhe, besoj se ky është shqetësimi kryesor që po ndërron kurs në politikën e Serbisë. Unë pres gjithashtu, që Bashkimi Evropian të jetë i qartë dhe duhet të jetë i angazhuar seriozisht në normalizimin e vërtetë të dy shteteve të pavarura, atë të Republikës së Kosovës me Republikën e Serbisë.

Ajo duhet të jetë e angazhuar për t'i zbatuar marrëveshjet e arritura e jo të synojë vetëm në nënshkrimet e dokumenteve, të cilat bëhen të pavlerë në rast se nuk implementohen. Qëndrimi i tyre indiferent lidhur me rastin e Ramushit, qëndrimi i pashpjegueshëm dhe i paqartë lidhur me murin e Mitrovicës, kushtet e veçanta për liberalizim të vizave, sikurse zbehin seriozisht kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë Bashkimi Evropian në çlirimin, ndërtimin dhe zhvillimin e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Unë konsideroj se Parlamenti i Kosovës sot duhet të jetë i qartë, së pari me politikën e vetë, me Qeverinë e Kosovës dhe duhet të kërkojë angazhim institucional, jo vetëm për lirimin e Ramushit, por për parandalimin e rasteve të njëjta, të ristrukturojë thellësisht dialogun, duke respektuar Serbinë si fqinj dhe duke përdorur serbët lokalë si pjesë drejt integritetit të tyre në institucionet e shteti dhe, pse jo, edhe ta ndalë dialogun deri në qartësimin e plotë dhe afatizimin e tij.

T'i kërkojë Bashkimit Evropian dhe anëtarëve të saj, institucioneve ndërkombëtare, që të mos zbatohen fletarrestime politike. Ne e kemi një rezolutë, por kjo dhe rezoluta të tilla të Kuvendit të bëhen detyrim për Qeverinë, jo vetëm të mbeten debat në Kuvend.

Të kërkojë nga BE-ja që të garantojë të gjitha marrëveshjet e nënshkruara dhe, normalisht, unë i bëj thirrje Qeverisë dhe institucioneve tona, që të mos merremi gjithmonë vetëm me pasojat, por të marrim veprime dhe vendime për të parandaluar rastet e tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shpejtim Bulliqi e ka fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, kryesues!

Të respektuar ministra,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të respektuar,

Në rrethana normale, kjo çështje as që do të duhej të vinte në rend dite për diskutim, për një arsye të thjeshtë. Ky ndalim, përkatësisht arrestim me kërkesë të Serbisë nuk do të duhej të ndodhë fare. Jemi në vitin 2017, kemi mbi një dekadë që po negociojmë me Serbinë, gjithnjë me ndërmjetësimin ndërkombëtar dhe gjatë kësaj periudhe të gjatë pothuajse i tërë spektri politik i Kosovës ka qenë i përfshirë në negociata, ndërsa unë po çuditem se si nuk është rregulluar kjo çështje më herët.

Ne si Kosovë, duke qenë nën protektoratin e Kombeve të Bashkuara gjatë kohës së UNMIK-ut, kemi pranuar mandatin e Tribunalit të Hagës dhe në atë tribunal kanë kaluar edhe qytetarë të Kosovës në disa raste. Vetë zoti Haradinaj ka kaluar dy herë nëpër procese gjyqësore në atë gjykatë. E njëjta, në të dyja rastet, e ka shpallur të pafajshëm. Atëherë, shtrohet pyetja, pse nuk është larguar që nga ajo kohë kjo çështje prej rendit të ditës?

Ne jemi të indinjuar me këtë rast, jo për faktin e një emri të përveçëm, por thjesht për faktin se zoti Haradinaj është qytetar i Kosovës. Të njëjtin fat e kanë pasur dhe të tjerë dhe druaj, se në të ardhmen do të pësojnë duke u ndaluar e arrestuar në pika të ndryshme kufitare anembanë Evropës, sidomos në disa shtete të Bashkimit Evropian, të cilat edhe përkundër kontributit të

madh që kanë dhënë për Kosovën dhe njohjen e shtetësisë së saj, megjithatë ende po vazhdojnë të respektojnë kërkesat jolegjitime të Serbisë kundruall qytetarëve të Kosovës.

Ndër prioritetet shteti duhet të jetë që kjo çështje të zgjidhet menjëherë e përgjithmonë. Jam i vetëdijshëm, se Serbia është duke abuzuar me tolerancën që e kanë vendet e Bashkimit Evropian ndaj saj. Dikush mund të thotë, se ne kemi... s'kemi "takat" ta disiplinojmë. Është e vërtetë kjo, por kemi mundësi që këtë ta bëjmë për shkak se jemi futur në disa procese, në të cilat bartëse është bashkësia ndërkombëtare. Në rastin konkret, ky Kuvend e ka votuar Ligjin për gjykatën speciale, para saj edhe shumë ligje e kërkesa të tjera që vijnë nga ndërkombëtarët. Ne është dashur, që t'i kushtëzojmë disa nga këto gjëra, me kërkesa specifike të shumta, siç është rasti me lirinë e lëvizjes, shpalljen joalide të urdhërarrestimeve që burojnë nga Serbia, si dhe kërkesat e ndryshme që janë në favor të Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Neve na është imponuar e, fatkeqësisht, ne kemi pranuar, siç thotë populli "qorrazi", çdo gjë që na kanë kërkuar ndërkombëtarët, ndërsa që pak ose fare nuk i kemi materializuar ato në dobi të Kosovës. Çfarë drejtësie është kjo, që një shtet mik i Kosovës, që edhe e ka njohur Kosovën, i njëjti shtet ende respekton urdhërarrestet për periudhën e kohës së luftës? Atë mandat e ka humbur Serbia atë ditë kur është larguar nga Kosova, nga forcat e NATO-s dhe lufta çlirimtare e popullit të Kosovës.

I përmenda më lartë disa raste që na kanë ikur pa i materializuar në dobi të Kosovës dhe qytetarëve të saj, raste që datojnë që nga vitet e takimeve me delegacionet e Serbisë në Vjenë e Bruksel. Gjatë kësaj periudhe Kosova ka prodhuar me qindra mijëra negociatorë nga të gjitha subjektet politike, negociatorë që si duket prioritet e kanë pasur dhe ende e kanë mëditjet, shoppingjet dhe hotelet luksoze në kurriz të Buxhetit të varfër të Kosovës. Dikush mund të më akuzojë, se kjo çfarë po them është e pavërtetë. Unë do të përgjigjesha me kundërpërgjigje, cilat janë rezultatet e krejt këtyre negociatave që janë zhvilluar deri sot? të njëjtit këta negociatorë kanë nënshkruar çfarëdo që u është servuar e sot në shumë raste shtiren se po befasohen gjatë implementimit të marrëveshjeve që i kanë nënshkruar. Ka të tillë, në pothuajse të gjitha partitë. Mjerimi është se askush nuk kërkon llogaridhënie nga ata për dëmet e shkaktuara me dije ose pa vetëdije.

Është e vërtetë, që pala kosovare ka qenë e detyruar të bëjë disa koncesione gjatë procesit të Vjenës, ky ishte çmimi i Pavarësisë, por ne tash kemi hyrë në një proces, ku pakos së Ahtisarit i është shtuar një aneks, i cili tenton t'ia ndërrojë plotësisht kuptimin dhe përmbajtjen. Negociatat e Brukselit po rrezikojnë funksionalitetin e shtetit të Kosovës, po bëhen koncesione të dëmshme për shtetin.

Sa herë po kthehen po na bombardojnë duke trumbetuar, se kanë bërë "mrekulli", ndërkohë që pasojat po i ndiejmë sapo po fillon implementimi i atyre marrëveshjeve. Nuk e di çfarë kanë bërë

gjatë tërë këtyre viteve, sidomos këta të post-pavarësisë, të cilët po negociojnë përtej planit të Ahtisarit, po bëjnë koncesione e herë po fitojnë pak, herë asgjë. Liria e lëvizjes, anulimi i fletarrestimeve ndërkombëtare do të duhej të ishin harruar kaherë, sepse vetë fakti që ulen në tavolinën e negociatave, kjo nënkupton që palët e kanë arritur një mirëbesim.

Unë vetëm po shoh e po dëgjoj, që në Kosovë po vijnë kujt po i teket nga Serbia, herë kinse për motive religjioze e herë për motive puro-politike e ne po i tolerojmë, s'po lënë cep të Kosovës pa e shkelur. Krejt kjo do të duhej të ishte në rregull, pa asnjë kundërshtim, por kur analizojmë se çfarë po na bën neve si Kosovë vetë Serbia, duke arrestuar qytetarët e të gjitha profileve, duke na bërë shantazhe dhe bllokada në të gjitha fushat. Kjo, mendoj se e ka arritur kufirin, kur ne duhet t'i themi boll më!

Dhe, kur të themi këto fjalë, duhet t'ua adresojmë edhe disa nga miqve ndërkombëtarë, sepse disa po luajnë lojëra të dyfishta. Pse e bëjnë këtë nuk e di, por e di se në disa raste po dalin kundër politikës zyrtare të tyre ndaj Kosovës.

Serbia do të duhej që si fajtorë që është, të detyrohej të sillej më mirë e jo sikur nuk i ka shkaktuar qindra mijëra viktima në luftërat ballkanike, pikërisht pjesë e makinerisë vrastare të Milosheviqit ishin edhe kryeministri i saj dhe ministri i Jashtëm Vuçiq e Daçiq bashkë me Nikoliqin, ata e kishin rolin sikurse ai i Gebelsit në Luftën e Dytë Botërore, por që këta politikanë shovinistë serbë gjatë luftërave të viteve të '90-ta dhe në vend se të ishin në burg ose gjykime, duke dhënë llogari para drejtësisë ndërkombëtare, ata janë shndërruar në "engjëj" të Evropës dhe po u tolerohet që të bëjnë presione përditë në raport me Kosovën.

Bashkësisë ndërkombëtare duhet t'ia bëjmë me dije, se as të ulemi nuk pranojmë pa i pastruar listat, ose pa ndërhyrje nëpër Interpol e Europol, pa largimin ose jo validitetin e urdhërresteve ndërkombëtare për qytetarët e Kosovës, sidomos atyre që kanë të bëjnë me ish-pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe veprimtarë të ndryshëm të Kosovës.

Vetëm atëherë kur të ndodhin veprimet konkrete të vazhdohet me dialogun, por jo duke bërë koncesione shtesë, por duke u angazhuar që të korrigjohen lëshimet e gabimet e bëra më herët nga këta "turistët" tanë, të cilët po lëvizin për çdo ditë në drejtim të Brukselit.

Këto janë temat me interes nacional dhe do të duhej që çekiçi të na rrahë të gjithëve në të njëjtin vend, pa marrë parasysh se nga cili subjekt jemi. Edhe ndaj ndërkombëtarëve duhet ndryshuar qasjen, deri më tash fatkeqësisht ka dominuar qasja e nënshtrimit. Për një periudhë të caktuar, është e vërtetë se kemi pasur zgjidhje tjetër, por tash në këto vite të post-pavarësisë është mëkat se si janë sjellë disa nga përfaqësuesit tanë në këto bisedime, të cilat janë zhvilluar në Vjenë dhe në Bruksel.

Dhe, për fund, e di që interesi i shtetit është më i madh se i një individi, kushdo qoftë ai, por besoj se nga tash e tutje duhet të ndërpresim çdo proces deri në lirim të zotit Haradinaj, por jo të ndalemi me kaq, por të vazhdojmë me aplikimin e një politike aktive në të gjitha proceset që na presin. Kjo nuk është betejë për individin, është për Kosovën, por që pikënisjen e ka individi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në ndërkohë, kur po flasim ne edhe kësaj radhe, sikur në seancën e kaluar për rastin “Dehari”, po na bie që të flasim ne pasi ka folur Parlamenti Evropian.

Sido që të jetë, sot ky Kuvend mund të bëjë një gjë të mirë, jo ndoshta në kohën kur është dashur ta bëjë, por së paku tani mund ta bëjë. Por, ky Kuvend mund të marrë vendime të rëndësishme, që pastaj jo të lutemi dhe të shpresojmë që rasti Haradinaj të jetë i fundit, por ta bëjmë vërtet që rasti Haradinaj të jetë i fundit.

Pra, ky Kuvend mund ta marrë këtë vendim sot. Por, njëkohësisht ka pasur raste ky Kuvend ta bëjë edhe më herët, sikur të realizoheshin rezolutat, ose të implementoheshin rezolutat dhe sikur ato të ishin detyruese për Qeverinë e Kosovës, kjo çështje sot nuk do të ishte këtu në Kuvendin e Kosovës duke u diskutuar dhe, po ashtu Haradinaj do të ishte në Kosovë, në vendin e tij të punës. Por, duke mbajtur seanca sa për të thënë, ne kemi ardhur deri te kjo seancë, që në pamje të parë po duket se edhe kjo seancë, nëse nuk marrim vendim, mund të jetë e tillë. Mund të jetë një seancë e radhës, që ne folëm, shprehëm mendimet tona, pakënaqësitë tona dhe kaloi.

Të njëjtën kohë, nuk besoj se Qeverisë dhe pushtetit duhet, si të thuash, tu mbetet hatri në Francën. Pse Franca e ka implementuar një urdhërarrest të Interpolit të Serbisë. Ne opozitës mund të na mbesë hatri në Francën, por juve duhet t’u mbetet hatri në Serbinë, për shkak se me Serbinë jeni takuar shumë më shpesh se sa me Francën dhe me Serbinë keni mundur ta zgjidhni këtë problem. Pra, e keni pasur edhe në atë rrafsh mundësinë që ta ndihmoni Kosovën dhe të ndihmoni të gjithë ata, që sot padrejtësisht, e në mesin e tyre edhe zoti Haradinaj, për fat të keq jo i vetmi, sot po paguajnë një çmim që s’u takon.

Nëse kemi ardhur këtu ta vajtojmë faktin që zoti Haradinaj është në arrest, po mbahet në Francë, kjo nuk i ndihmon zotit Haradinaj, sepse, tek e fundit, ai nuk ka nevojë fare ta vajtojmë faktin pse ai është atje. Nëse duam ta ndihmojmë rastin Haradinaj, atëherë ndihma më e madhe edhe për Haradinajn, besoj po flas edhe në emër të tij, do të ishte sikur ne ta ndihmojmë Kosovën, që Kosova më mos të ketë këso problemesh, aq më tepër me shtetet e Bashkimit Evropian, shtetet tona mike. Është thjeshtë, pra t’i themi jo Serbisë edhe në këtë rrafsh.

Sikur shumë të tjerë edhe unë jam një ndër të kërkuarit e Serbisë, ka edhe shumë të tjerë këtu në këtë Kuvend, që Serbia i kërkon për atë çfarë kanë bërë në luftën çlirimtare të Kosovës. Dhe, kur ne kërkojmë nga ju që të bëni presion ndaj Serbisë, ne nuk kërkojmë që Serbia të na amnistojë. Për shembull, unë kurrë nuk do të doja të amnistohesha nga një Serbi siç është sot, po ashtu edhe nga asnjë lloj Serbie, sepse tek e fundit nuk kam nevojë për amnistinë e Serbisë, madje unë do të doja të jem gjithmonë armik i Serbisë, përderisa Serbia të jetë armike e shqiptarëve.

Pra, nëse ne reagojmë ndaj kësaj, mos na e merrni që ne po kërkojmë thjesht që Serbia të na amnistojë, ne nuk duam amnisti nga Serbia, por duam mbrojtje nga shteti ynë.

Qeveria në adresimin e saj këtu u shpreh se ka papajtueshmëri me Francën, pra me sa e dëgjova kryeministrin, ai tha: “shprehim papajtueshmërinë me shtetin e Francës”, e në ndërkohë ka gjithë ato “pajtueshmëri” me shtetin e Serbisë, për çështje po ashtu të rëndësishme e nganjëherë edhe më të rëndësishme, sesa fati i një individi në këtë rast.

Dhe po ashtu, Serbia paska kërkuar nga Franca, respektivisht nga Parisi, mendoj që ka kërkuar në këtë rast ndoshta mund të thirren në Paris, por ka kërkuar në adresë të gabuar, sepse nuk mund të kërkojë të bëjë diçka Parisi, para se Qeveria e Kosovës ta bëjë vetë, e Qeveria e Kosovës mund ta bëjë një gjë të tillë dhe mund të kërkojë, të krijojë rrethana të tjera të favorshme për Kosovën dhe qytetarët e saj.

Nuk do të duhej të thirrshim ne në anëtarësimin ose jo të Kosovës në Interpol. Ne e dimë që është shumë i rëndësishëm anëtarësimi i Kosovës në Interpol, por anëtarësimi i Kosovës në Interpol nuk e bën, që Serbia me automatizëm t’i heqë këta emra prej atje, as bashkëpunimi me Interpolin nuk e bën një gjë të tillë. Po ashtu, nuk do të duhej të quhej, thjesht, atë çfarë po bën Serbia siç thotë këtu përfaqësuesi i Qeverisë “fletarrestimet e motivuara politikisht”. Pra, ne nuk do të duhej thjesht, të reagonim pse Serbia ka fletarrestime të motivuara politikisht për qytetarët e Kosovës, por ne duhet të reagojmë dhe të mos pranojmë asnjë lloj fletarrestimi ta bëjë Serbia për qytetarët e Kosovës e as ato të motivuara politikisht, për shkak se Serbia nuk ka të drejtë të nxjerrë fletarrestime për qytetarët e Kosovës, për asnjë lloj veprë, aq më pak për ato që në këtë rast po quhen “të motivuara politikisht”.

Por, një pyetje vetvetiu vjen në shprehje: A thua pse po i ndodh kjo zotit Haradinaj në vazhdimësi?

Nuk është hera e parë, që zotit Haradinaj i ka ndodhur një gjë e tillë. U ka ndodhur dhe të tjerëve, por duket se fokusi është te zoti Haradinaj e aq më tepër, jo sikurse më herët që është ndalur dhe është lëshuar, por kësaj radhe i është caktuar edhe masa e paraburgimit. Nuk dua të them pse s’po u ndodh edhe të tjerëve, sepse nuk duhet t’i ndodh kurrkujt, asnjë qytetari të Kosovës, me

çfarëdo lloj pozite, që të arrestohen me fletarrestime të Serbisë, por pse vetëm zotit Haradinaj e pikërisht pse tani?

Unë ngre një pyetje, që nuk do shumë dilemë, a do të ndalej edhe nga Franca zoti Haradinaj sikur të ishte pjesë e delegacionit të Kosovës në bisedime me Serbinë? Unë mendoj, që në këtë rast nuk do të ndalohej zoti Haradinaj. Kështu që, këto pyetje ndoshta përgjigjen e tyre do ta gjejmë në ditët në vijim.

Edhe nga ministri i Punëve të Jashtme, zoti Haradinaj u quajt “hero i luftës”, ka të drejtë ministri i Punëve të Jashtme për zotin Haradinaj hero i luftës, por këtë epitet ia kanë dhënë më shumë bashkëqytetarët e tij, qytetarët të cilët kanë qenë të mbrojtur nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe nga zoti Haradinaj në këtë rast. Dhe, u thirr se paska kontaktuar, paska bërë telefonata të ndryshme, qoftë me zotin Haradinaj atje, qoftë me familjarët e tij këtu, ose bashkëpunëtorët e tij këtu. E paska bërë namin!

Pse a edhe telefonatat kanë mundur të mos ndodhin?! Kështu që, nuk është ndonjë vlerë e madhe nëse e paska thirrur dikë në telefon. Dhe, vjen këtu në foltore të Kuvendit e na thotë, që ka bërë gjithë ato telefonata, qenka këputur duke folur në telefon. Jo, jo, nuk është ky roli i një ministri të jashtëm. T’i thërrasë dhe t’i ngushëllojë, ose eventualisht ta pyesë zotin Haradinaj, se si po të trajtojnë policia e Francës atje. Nuk ka nevojë për këto telefonata, as Kosova, as zoti Haradinaj e as Parlamenti i Kosovës.

Nuk e di a mund të quhet reciprocitet, nëse “nëse” Qeveria e Kosovës e ka ndaluar presidentin e Serbisë që të vijë në Kosovë para ca ditësh. Po flas, nëse, Qeveria e Kosovës e ka ndaluar, sepse ne e dimë se çfarë mund të ndalojë Qeveria e Kosovës, por nuk e di a mund të quhet reciprocitet, sepse nëse ne ia kemi ndaluar presidentit të Serbisë që të vijë në Kosovë, kjo i bie që edhe presidenti ynë paska dashur të shkojë në Preshevë. Nuk është reciproke kjo, sepse nuk është e dyanshme në këtë rast, prandaj nuk do të duhej të quhet “reciprocitet”.

Ministri i Punëve të Brendshme në radhën e përfaqësuesve të Qeverisë, të cilët u lodhën si duket dhe kanë shkuar në drekë, tha që Haradinaj ka besim në Drejtësinë Ndërkombëtare. Po, po, Haradinaj mund të ketë besim në Drejtësinë Ndërkombëtare, por nuk ka besim në ju dhe ky është problemi. Prandaj, nëse Parlamenti i Kosovës do që ta bëjë një punë efektive, pra sot, në këtë seancë, e ka rastin ta tregojë edhe pavarësinë e këtij Parlamenti nga ndikimi i Serbisë. Nëse doni thjesht, që kjo seancë të jetë e fundit në vargun e atyre, sepse edhe parafolës të tjerë pati që thanë, se ka pasur shumë e shumë seanca të tilla, qoftë të jashtëzakonshme, qoftë për të diskutuar si pasojë e veprimeve të Serbisë, që me të drejtë mund të them që nganjëherë Serbia po përcakton agjendën edhe të legjislativit, atëherë le ta bëjmë këtë seancë si seancën e fundit që flasim për këtë çështje.



E Parlamenti mund ta detyrojë këtë Qeveri që të marrë hapa konkretë, dhe ajo është:

- t'i ndërpresë bisedimet me Serbinë menjëherë dhe
- të vërë embargo për Serbinë, saktësisht sanksione ekonomike për Serbinë.

Po qe se doni që të fillojë normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë le të fillojmë nga këto të dyja: ndal bisedimeve me Serbinë dhe ndal kamionëve dhe mallrave serbe në Kosovë. Kaq!

Nëse i bini rrugëve të tjera, besoj se rezultati nuk do të jetë ai i pritshmi për qytetarët e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ali Berisha.

ALI BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Sot po takohemi në këtë seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar për një njeri që i dha shumë Kosovës dhe i cili po përballlet me sfida të shumta.

U shpall dy herë i pafajshëm në Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës me akuza të montuara nga Serbia. Ai sërish ndalet nga Policia franceze bazuar në fletarrestim të lëshuar nga shteti, i cili aktualisht udhëhiqet nga ish-bartësit e Slobodan Millosheviqit. Atëherë, kur drejtësia ndërkombëtare, padrejtësisht i kërkoi Ramushit ta thotë të vërtetën, Ramushi pa asnjë hamendje shkoi dhe pohoi të vërtetën duke dëshmuar botërisht, se Kosova vazhdimisht ka bërë luftë të drejtë çlirimtare. Ramushi e tregoi se Kosova e ka dashur lirinë, luftoi për të dhe u bë shtet falë luftës së pastër çlirimtare.

Sot në këtë Kuvend duhet të diskutojmë dhe nuk duhet të hidhërohemi në asnjë shtet mik të Kosovës. Por, duhet të turpërohemi se ku e ka sjellë Qeveria Kosovën, ku i kemi sjellë vlerat mbi të cilat është ndërtuar shteti i Kosovës dhe se udhëheqja e këtij vendi ngadalë po i cenon dhe seriozisht po i dëmton vlerat, mbi të cilat janë ndërtuar themelet e këtij vendi.

Sot këtu nuk e kam asnjë fjalë për ta mbrojtur Ramushin, pasi ai me sjelljen e vet njerëzore, politike, institucionale e morale, gjatë gjithë veprimtarisë së vet e ka dëshmuar. Mos të harrojmë se edhe ky rast do të kalojë. Ramushi do të kthehet në shtëpi. Kosova nuk do të burgoset, pavarësisht se dikush e dëshiron. Kosova do të dijë t'i ruajë vlerat e veta, por të kemi kujdes! Lidërshipi, që aktualisht po udhëheq Kosovën drejtimin e ka të gabuar.

Familja Haradinaj dhe Ramushi dhanë shumë për këtë vend, sakrifkuan shumë për Kosovën dhe është fakt, se është një ndër njerëzit që më së shumti e ka dëmtuar Serbinë dhe shtetin serb. Serbia këtë herë dhe asnjëherë tjetër, nuk do të mund t'ia falë dhe kurrë nuk do të mund të

pajtohet me këtë realitet dhe si të tilla duhet të kuptohen edhe aktakuzat e ngritura nga Serbia, si ndaj nesh, ndaj popullit të Kosovës po edhe nga shtetet mike të Kosovës.

Për hir të fëmijëve tanë dhe gjeneratave që po vijnë, Qeveria e Kosovës duhet të ndalë çdo veprim nënshtues ndaj Serbisë. Nuk punuan dhe sakrifikuan shumë gjenerata, nuk luftuan shumë luftëtarë, nuk luftoi Adem Jashari me familjen e tij, nuk luftoi Ramushi, për një shtet që gjunjëzohet para Serbisë, për një shtet që nuk është i aftë t'ia pasqyrojë realitetin historik dhe historinë e vet të pastër Botës demokratike.

Çështja e Ramushit kërkon sqarimin e munguar, që të na tregojë dikush se deri kur duhet të vazhdojë, ose kur duhet të ndërpritet persekutimi politik i një lideri politik i dëshmuar për pjekuri dhe përgjegjshmëri të lartë institucionale, i gatshëm të japë për shtetin dhe të sakrifikojë për mbrojtjen, avancimin dhe funksionalitetin normal të këtij shteti.

Andaj sot ne kërkojmë me ngulm që shteti mik i Francës të na kuptojë drejt, se lufta jonë në Kosovë ishte e drejtë, se Ramushi bëri luftë të pastër, që veprimet e tij ishin për çlirimin e popullit të Kosovës dhe akuzat e ngritura prej Serbisë janë jo të drejta dhe të montuara, kështu që kërkojmë nga shteti francez që të gjitha ato procedura të kryhen sa më shpejt dhe Ramushi të kthehet pranë popullit të tij, aty ku e ka vendin.

Gjendja e tanishme e Kosovës nuk pret më. Kjo gjendje nuk mund të vazhdojë si e tillë. Është koha e fundit të veprohet seriozisht, andaj e ftojme Qeverinë që në mënyrë urgjente të veprojë në përputhje me përgjegjësinë shtetërore që e ka, sa nuk është bërë vonë.

Çdo vonesë në përballje me pengesat dhe ndalesat që po i bëhen Kosovës e Ramushit do të kenë pasoja të paparashikueshme.

Shteti i Kosovës ka obligim ndaj njerëzve të vet, e sidomos ndaj atyre që mundësuan të krijohet ky shtet. Duhet të ketë detyrë shtetërore - kthimin sa më të shpejtë të Ramushit në Kosovë.

Dhe, në fund, është koha e fundit që Qeveria e Kosovës t'u japë fund bisedimeve që janë vetëm për llogarinë e Serbisë, të shtetit dhe aparatit shtetërore të Serbisë në Kosovë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Berisha e ka fjalën.

**ZAFIR BERISHA:** Faleminderit, kryesues!

Se Serbia bën edhe agjendën e Kuvendit, tashmë nuk do koment, për vetë faktin se jemi takuar sot në një takim të jashtëzakonshëm për shkak të agresionit serb mbi Kosovën dhe qytetarët e saj, se e ka bërë dhe e bën agjendën e Qeverisë së Kosovës nuk është ndonjë zbulim epokal, sepse Qeveria e Kosovës është filial i Qeverisë së Serbisë në vendin tonë.

Mendoj se rasti i Ramushit do të jetë arsye e fuqishme që qasja e institucioneve të Kosovës, duke përfshirë edhe Parlamentit, të ndryshojë në raport me shtetin armik të Serbisë, përndryshe nëse vazhdojmë kështu, mendoj se historia nuk do të na falë.

Kjo seancë është në mesin e shumë seancave që janë mbajtur për arsye të njëjta dhe seriozisht kam menduar a ia vlen të marr pjesë në një seancë koti sikur kjo, ku do të derdhen lot krokodili, siç u derdh deri tash dhe, në fund nuk do të ketë asnjë efekt.

Se sa është serioze kjo seancë dhe sa do të ketë efekt po shihet, sepse kryeministri përpos 'muhalifeve' që na i tregoi me ministrat e tij, u largua dhe kjo i bie se ne mund të flasim çka të duam, por ekzekutivi i këtij vendi do të vazhdojë nënshtrimin dhe servilitetin ndaj shtetit armik të Serbisë.

Unë mendoj se është dashur të kërkohet një seancë dhe ajo do të duhej të ishte një interpelancë me kryeministrin dhe të japë llogari se çka ka bërë deri tash në këtë drejtim, për këtë çështje që jemi duke folur, për arsye se ne kemi edhe rezoluta të cilat disa kolegë i përmendën më herët dhe të cilat kanë mbetur rezoluta koti dhe muhabete pa mbulesë të këtij Kuvendi.

Po ky kryeministër, sa i përket bisedimeve me Serbinë, si vazhdues i bisedimeve të qeverive më herët, shpesh thirret me një rezolutë dhe disa ligje, të cilat janë zgjedhur nën presionin e Qeverisë së kaluar dhe të Hashim Thaçit, të cilët jo që i kanë ngritur duart, por kanë qenë në gjendje edhe këmbët t'i ngritin vetëm e vetëm për t'u bërë servis dhe plotësues i agjendës së Serbisë në Kosovë. Ndërsa, kur është puna për t'u referuar rezolutave, të cilat tregojnë 'un' dhe identitetin shtetëror, do të thotë Isa Mustafa nuk i përfill.

Fjalimi i kryeministrit dhe 3 ministrave vërtet ishte i pasinqertë dhe, thënë të drejtën, të bën të ndihesh keq si deputet e t'i dëgjosh ato fjalime, sepse janë fjalime të cilat i kemi dëgjuar me dhjetëra herë dhe një gjë është duke u harruar sepse të flasësh dhe të bësh janë dy gjëra. Sot Kosova ka nevojë të bëjë diçka për shtetin dhe qytetarët e saj.

Unë, ju dhe qytetarët besoj se i dëgjuan edhe 'muhalifet' e radhës të Enver Hoxhajt, "zbulimin e ri", kur thotë se Serbia është duke bërë politikë armiqësore ndaj Kosovës.

Për herë të parë e dëgjuam. Shumë qesharake. Serbia është armik i Kosovës. Serbia qysh në 1999-ën, e veçanërisht pas shpalljes së pavarësisë asnjëherë nuk ka dhënë simptome se e pranon shtetin e Kosovës dhe në të gjitha rastet është deklaruar dhe ka punuar se do t'i bindë miqtë e Kosovës se Kosova nuk është shtet që mund të funksionojë. Dhe këtë është duke e bërë, natyrisht me ndihmën edhe të Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve të tjera.

Ne nuk bën të befashemi me Serbinë, sepse ajo është duke e bërë punën e vet, përcaktimin e vet kushtetues e ligjor ndaj Kosovës. Prandaj, shtrohet pyetja çfarë jemi duke bërë ne për mbrojtjen e shtetit, i cili është fituar me shumë mund, gjak e sakrificë. Në fakt, nuk jemi duke bërë asgjë.

Unë do ta përsëris vetëm një pyetje për të cilën asnjëherë s'kam marrë përgjigje. Kjo Qeveri dhe qeveritë para kësaj pse është dashur të bisedojnë me Qeverinë për urën në Mitrovicë? Për një urë e cila i lidh dy lagje të qytetit, një urë e cila nuk e lidh Serbinë dhe Kosovën. Dhe, për këtë, mendoj se përgjigjja apriori dihet, sepse Qeveria e butakëve dhe e pakurrizorëve në Kosovë, me bisedimet që i ka zhvilluar pa kurrfarë platforme me Serbinë është duke e bërë Serbinë palë në diskutimet e brendshme të Kosovës dhe, me këtë rast, Serbia dalëngadalë, në një formë apo formë tjetër, është duke u rikthyer në Kosovë falë Isa Mustafës dhe paraardhësit të tij.

Unë besoj se bisedimet janë ataku më i rëndë që i është bërë shtetit të Kosovës dhe sovranitetit të vendit dhe këto bisedime duhet të ndërpriten urgjentisht për të krijuar një platformë nacionale lidhur me qasjen që duhet ta ketë shteti i ri i Kosovës në raport me Serbinë.

Unë mendoj se institucionet e Kosovës, e veçanërisht organet e drejtësisë urgjentisht pasardhësve të politikës së Milosheviqit, Sheshelit, Nikoliqit, Vuçiqit e Daçiqit duhet t'u bëjë padi për gjenocid në Kosovë, bashkë me afro 10 000 forca policore, ushtarake e administrative, të cilët kanë bërë krime të llahtarshme në Kosovë dhe në këtë formë mendoj se ne dalëngadalë duhet t'i rikthehem asaj që është sjellje shtetërore në raport me një shtet, i cili as që ka kërkuar falje për atë që e ka bërë në Kosovë.

Mendoj se agjenda politike e jashtme e Kosovës është tepër gabim dhe nuk është konform zhvillimeve politike që po ndodhin në Kosovë, në rajon dhe në botë. Tashmë ne kemi një situatë krejt të re në Ballkan dhe veçanërisht në Kosovë, sepse kemi miq tanë që kanë halle e probleme, të cilat nuk i kanë pasur në 1998-ën dhe 1999-tën, por as edhe në 2008-tën dhe kemi gjendje të re, ndikim të ri të politikës së shteteve që nuk ia duan të mirën Kosovës dhe që janë aleate të Serbisë, siç është Rusia dhe të dhënat e fundit publike tregojnë fuqizimin e politikës ruse në Ballkan, dobësimin për shkak të problemeve dhe halleve që i kanë politikën perëndimore në rajon dhe qasja e politikës së jashtme të Kosovës duhet të ndryshojë diametralisht nga kjo.

Ka dy vjet kur unë kam folur për realitetin e krijuar nga kjo Qeveri dhe Qeveria e mëhershme për një 'Krime të mundshme' apo për një "Republika Sërpska" në Kosovë. Ditët e fundit dy ministrat e kësaj Qeverie kanë filluar të pajtohen me atë që e them tash e dy vjet.

E kemi një qasje edhe më dramatike për politikën e Kosovës, por edhe për stabilitetin në rajon për shkak se ekonomikisht e ushtarakisht disa nga shtetet e rajonit fuqizohen me armatim dhe me potenciale ekonomike edhe në territorin e Kosovës pa pasur qasje institucionet tona.

Besoj se hapi i parë, pajtohem me shumicën e kolegëve se duhet të ndërpriten bisedimet dhe të krijohet platforma, që po e përsëris, nacionale e shtetit të Kosovës në raport me shtetin armik të Serbisë dhe sigurisht kthjellimi i qeveritarëve, të cilët nuk janë në gjendje as edhe shqetësimet tona si të zgjedhur të qytetarëve t'i dëgjojnë. Prandaj, po e përsëris edhe një herë, se dikur do të bëhet vonë dhe do të na gjykojë historia. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Agim Aliu.

AGIM ALIU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit të Republikës,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës,

Pa dyshim se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte e drejtë, ishte një luftë çlirimtare dhe duke qenë e tillë ajo fitoi përkrahjen e gjerë të botës demokratike, e cila kulmoi me ndërhyrjen e trupave të aleancës më të fuqishme ushtarake në botë, NATO-s.

Si rezultat i kësaj mbështetje, qytetarët e Kosovës fituan lirinë e shumëpritur. U pagua çmim i madh, mijëra viktima, mijëra të zhdukur, masakra të shumta dhe shkatërrime të mëdha dhe për këtë ka një përgjegjës, e ai është shteti serb.

Por, mbi të gjitha, përkundër këtij çmimi të paguar nga ne, vendosmëria ishte e madhe që t'i jepej kuptim lirisë me ndërtimin e institucioneve që do t'u shërbenin të gjithë qytetarëve.

Ne u jemi mirënjohës përjetësisht të gjithë miqve që na ndihmuan në bërjen e lirisë dhe pavarësisë si dhe shtetndërtimin që jemi duke e bërë edhe sot.

Një segment shumë i rëndësishëm i jetës institucionale të Republikës së Kosovës pa dyshim është ai i sundimit të rendit dhe ligjit, respektivisht drejtësia, e ku rolin vendimtar në ndërtimin strukturor e kishin ndërkombëtarët.

Si një popull i vuajtur për drejtësi, që i kishte munguar gjithmonë në të kaluarën, ai me një automatizëm i besoi drejtësisë ndërkombëtare, përkundër faktit që kredibiliteti i saj shënoi një rënie të vazhdueshme për shkak të aferave të ndryshme si dhe një gatishmërie konsistente të këtyre strukturave të drejtësisë që më shumë të merreshin me ish-ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe prijësit e tyre se sa me krimet dhe kriminelët serbë.

Përkundër se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe vlerat e saj mbetën të shenjta dhe të pacenueshme për të gjithë ne, përkundër se çdo çlirimtar për qytetarin e Republikës së Kosovës është hero dhe përkundër që ata u bënë padrejtësisht subjekt i drejtësisë ndërkombëtare brenda

dhe jashtë Kosovës, ne vazhduam t'i besojmë kësaj drejtësie duke u dorëzuar vullnetarisht. Dhe çlirimtarët, heronjtë tanë, i fituan dhe do i fitojnë edhe këto beteja për të dëshmuar pastërtinë e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

I tillë ishte edhe Ramush Haradinaj, i cili e fitoi këtë betejë me drejtësinë dy herë në Tribunalin e Hagës.

Mirëpo, sikur edhe kjo nuk po mjafton, sepse zoti Haradinaj tashmë është i paraburgosur në një shtet mik, i cili na ndihmoi në bërjen e lirisë dhe pavarësisë së Republikës sonë, e që paradoksisht po e respekton një fletarrestim të një regjimi gjenocidial që e luftoi edhe vetë në kuadër të ndërhyrjes ushtarake të NATO-s.

Prandaj, si ka mundësi që këto fletarrestime të një shteti agresor, të një lufte ku u fut edhe vetë NATO-ja kundër atij vendi, edhe sot mund të vlejnë si legjitime për polici të këtyre shteteve evropiane për të arrestuar dhe burgosur luftëtarët që iu kundërvunë atij agresioni.

Prandaj me të drejtë ne dhe qytetarët tanë shprehim pezmin dhe shqetësimin tonë, sepse me akte të tilla po na cenohet dinjiteti ynë, po na cenohen vlerat tona të fituara me shumë mund e sakrifica.

Dhe, pezmi ynë sa vjen e shtohet kur kihet parasysh edhe qasja e dyzuar e Bashkimit Evropian ndaj Kosovës dhe Serbisë. Neve, duke na vënë kushte sui generis për liberalizimin e vizave dhe në integritet të tjera, ndërsa Serbisë, përkundër që ishte shkaktari i të gjitha luftërave në Ballkan, i ofrohet në vazhdimësi përkëdhelja dhe integriteti.

Prandaj, ne me të drejtë, për aq sa jemi falënderues për miqtë tanë, për të gjithë atë që kanë bërë dhe që po vazhdojnë të bëjnë, po aq jemi edhe kritikë dhe kërkues që kjo qasje aktuale ndaj nesh të ndryshojë.

Ne duhet të jemi kritikë edhe ndaj punës tonë dhe institucioneve tona, sepse duhet të jemi më të përgjegjshëm në detyrat, punët dhe angazhimet institucionale dhe shtetërore që i kemi.

Rasti i fundit i zotit Haradinaj, si dhe rastet e tjera të ngjashme, ku preken vlerat, dinjiteti dhe interesat nacionale më shumë duhet të na shërbejnë për t'u bashkuar se sa për t'u ndarë.

Retorika përçarëse, joracionaliteti, reagimet emocionale dhe histeria, po ashtu janë ato që na bëjnë dëme në raste të tilla.

Tashmë ka kohë që ne po bëjnë degradimin e institucioneve tona, duke i bërë ato arenë të moralizimeve me njëri-tjetrin, sharjeve, ofendimeve, dhunës e gjëra të tjera që nuk do të duhej të ishin pjesë e “punës në institucione”.

Tashmë ka kohë që ne me rezoluta e debate joadekuate vetëm sa kemi treguar pafuqinë tonë, prandaj ne duhet të tregojmë se këto institucione dhe vendimet e tyre kanë legjitimitetin dhe fuqinë e duhur.

Tashmë ka kohë që ne nuk kemi agjenda dhe strategji të qarta, por më shumë kemi nënshtrim në agjenda të të tjerëve. Prandaj, është ky moment kur ne duhet të bëjmë një rishikim të këtyre proceseve që janë duke u zhvilluar dhe të atyre që priten të zhvillohen.

Një nga këto procese që duhet rishikuar pa dyshim se është edhe dialogu me Serbinë. Sigurisht se ky dialog ka të arritura, por ka edhe ngecjet e veta.

Ne jemi palë dhe ky është një proces ndërkombëtar që nuk mund dhe nuk duhet të ndalet, por ai mund dhe duhet të ndryshojë, të rishikohet, sepse nuk mund dhe nuk duhet të ketë vetëm një palë që ofron konstruktivitetin.

Ne duhet të kemi një listim më të qartë të interesave dhe çështjeve që kemi për të biseduar në kuadër të një agjende dhe strategjie më të qartë nacionale, duke përcaktuar edhe afatet kohore, ndërsa Bashkimi Evropian duhet të jetë më i zëshëm dhe më i angazhuar për të parandaluar veprimet dhe vendimet që nxisin tension, dhunë e konflikte.

Pa dyshim se këto fletarrestime dhe keqpërdorimi i Interpolit dhe Europolit nga Serbia, ndërtimi i murit dhe veprimet e tjera të shumta e të ngjashme u shërbejnë qëllimeve që të ketë tensione e dhunë, por edhe qëllimeve të tjera.

Prandaj, duke qenë se Kosova nuk është dhe nuk mund të bëhet pjesë e Interpolit për një kohë të afërt, për arsyt që janë të njohura, do të duhej që dialogun dhe Bashkimin Evropian ta shohim si një mundësi të vetme që kjo çështje të zgjidhet njëherë e përgjithmonë, në mënyrë që qytetarët e saj, ani pse me viza të vetmit në Evropë, të lëvizin “dinjitetshëm”.

Ky rast, më shumë se çdo rast tjetër do të duhej të na shërbente neve që të bëjmë një kapërcim nga një nacionalizëm primitiv në patriotë civilë të këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni që fillimisht t'u bashkohem thirrjeve që u bënë në fillim për unifikim të gjithë spektrit politik në adresimin e çështjeve apo sfidave të tilla, me të cilat fatkeqësisht po merremi edhe shumë vjet pas pavarësisë, e të cilat nuk e prekin asnjë parti individualisht, asnjë person po ashtu individualisht, por na prekin si shtet. Rrjedhimisht do të duhej edhe përgjigjja jonë të ishte unifikuese dhe të mos ketë ndarje partiake në përgjigjen që e japim ne apo si Kuvend i Kosovës, apo edhe si institucione në tërësi.

Natyrisht se kjo nuk është hera e parë që nga Kuvendi është kërkuar të japë një përgjigje apo një udhërrëfim për Qeverinë e Kosovës për veprimet që duhet të ndërmerren.

Fatkeqësisht, herën e kaluar, kur zoti Haradinaj u ndalua në Slloveni, ne si Kuvend, përkundër faktit që miratua një rezolutë me kërkesa të qarta, deri sot nuk është ndërmarrë si duket ndonjë hap konkret në mënyrë që në veçanti të zbatohet pika 2 e kësaj rezolute, e cila kërkon që urgjentisht në Bruksel, në dialogun Kosovë - Serbi, të shtrohet çështja e fletarrestimeve të Serbisë, të cilat kanë filluar të lëshohen qysh në vitet e '90-ta, por janë aktivizuar së pari në vitin 2004, pastaj në vitin 2006 dhe prapë së fundi.

Sot unë nuk besoj se na ndihmon cilido prej nesh, por në veçanti nuk i ndihmon Kosovës në qoftë se diskutojmë për marrëdhëniet tona me Francën. Franca është pjesë e konventave ndërkombëtare dhe policët kufitarë e kanë kryer një detyrë ligjore. Mirëpo sot patjetër duhet të diskutojmë për marrëdhëniet tona me Serbinë.

Jo vetëm për shkak të veprimeve gjatë viteve të 90-ta, por edhe për shkak të sjelljeve të Serbisë pas luftës në Kosovë, por edhe pas pavarësisë së Kosovës, është absurde, siç kam thënë edhe më herët, që të pritet sjellje konstruktive nga Serbia, një shtet fqinj që fatkeqësisht po përpiqet ta destabilizojë jo vetëm Kosovën, por tërë rajonin me logjikën mesjetare të të menduarit, apo të ndjelljes së luftës dhe në rrethana të tilla të pritet që ata do të sillen përgjegjshëm, të pritet që ata nuk do të riaktivizojnë fletarrestime të tilla, do të ishte absurde.

Sipas informatave që janë dhënë apo për të cilat diskutohet në institucionet e Kosovës, përkundër faktit se për një kohë të caktuar ishin të pezulluara fletarrestimet, ato janë riaktivizuar pak kohë më parë, më saktësisht pak para arrestimit të zotit Nehat Thaçi.

Pyetja ime për Qeverinë është: Në qoftë se në momentin kur kanë marrë informata se janë riaktivizuar të gjitha këto fletarrestime, a i kanë informuar personat, të cilët potencialisht mund të jenë në këtë listë? Në mënyrë që të merren masa parandaluese dhe në mënyrë që njerëzit, si zoti Haradinaj të jenë të informuar që në qoftë se udhëtojnë ka gjasa që fatkeqësisht të ndodhin raste të tilla.



Në qoftë se Qeveria e Kosovës nuk i ka informuar dhe e ka pasur këtë informatë, pra që janë riaktivizuar fletarrestimet, atëherë duhet të sqarohet pse e ka mbajtur të fshehtë një informatë të tillë?

Së treti, është me rëndësi të kthehemi te marrëveshja e vitit 2013 në mes të Kosovës dhe Serbisë, marrëveshja e parë e parimeve, e ratifikuar nga ky Kuvend. Kjo marrëveshje është ratifikuar së bashku me Planin e zbatimit, i cili në pikën 2 thotë që të dyja palët, pra edhe Kosova dhe Serbia, duhet të miratojnë ligj për amnistinë.

Natyrisht sikur Ligji ynë për amnistinë, po ashtu edhe një ligj potencial nga Serbia nuk do të mund të amnistonte vepra që konsiderohen krime ndërkombëtare. Megjithatë, do të mund të amnistonte të gjithë personat, të cilët gjatë viteve të hershme të 90-tave atyre u është ngritur aktakuzë kinse për shkelje të sovranitetit të Jugosllavisë në atë kohë vetëm se kanë kërkuar Republikë për Kosovën. Në mesin e tyre ka edhe shumë njerëz të LDK-së. Bile-bile, me siguri shumë pak njerëz e dinë që në ditën e shpalljes së pavarësisë, më 17 shkurt 2008, aktakuzë është ngritur për 3 personat kryesorë që kanë qenë të përfshirë në procedura të organizimit të shpalljes së pavarësisë atë ditë. Pra, është ngritur aktakuzë për presidentin Fatmir Sejdiu, për zotin Jakup Krasniqi dhe, në atë kohë, zotin Hashim Thaçi, që ishte kryeministër. Aktakuzë për shkelje të sovranitetit, kinse të Serbisë, në atë kohë.

Pra, nuk kemi të bëjmë këtu vetëm me aktakuza dhe fletarrestime ndaj njerëzve të UÇK-së, por edhe shumë të tjerë të cilëve u janë ngritur aktakuza në vitet e '90-ta vetëm për shkak se kanë kërkuar pavarësi për Kosovën.

Prandaj, është tepër me rëndësi të kërkohej zbatimi i pikës 2 të marrëveshjes Kosovë-Serbi, pra që Ligji për amnisti të miratohet edhe nga Serbia, dhe kjo kërkesë nuk duhet të bëhet urgjentisht nga Qeveria jonë në Bruksel, sepse nuk ka asnjë kuptim që ne të vazhdojmë t'i implementojmë mbi 80% apo mbi 90% të marrëveshjeve, përderisa Serbia nuk zbaton asnjë nga pjesët më themelore të marrëveshjes së vitit 2013, e të mos flasim për ato që kanë pasuar.

Dhe, së fundi, siç e kemi diskutuar me disa kolegë në Kuvend edhe në rastin e ndalimit në Slloveni të zotit Haradinaj, por po ashtu edhe në rastin e arrestimit të zotit Thaçi.

Kroacia, si shtet fqinj, tani anëtar i Bashkimit Evropian, e ka bllokuar hapjen e negociimit të kapitujve XXII dhe XXIV për Serbinë, me arsyetimin se Serbia duhet ta ndryshojë ligjin e saj për juridiksionin universal.

Serbia padrejtësisht vazhdon të mendojë që mund ta arrestojë kë të dojë nga i gjithë territori i ish-Jugosllavisë. Edhe përkundër faktit që Kombet e Bashkuara kurrë nuk e kanë njohur Serbinë si shtet vazhdues të ish-Jugosllavisë. Megjithatë Serbia e ka një ligj të tillë, në bazë të të cilit

arreston njerëz nga Kroacia, njerëz nga Bosnja, njerëz nga Kosova, por edhe nga vende të tjera të rajonit.

Pra, Kroacia ka qenë shumë e zëshme duke refuzuar parimin e juridiksionit universal të Serbisë dhe duke lënë me një anë argumentet e të drejtës ndërkombëtare për këtë çështje, sepse Serbia nuk ka miratuar një ligj të tillë për të qenë në pajtim me disa praktika ndërkombëtare, por për ta destabilizuar rajonin për qëllime të pastra politike.

Kosova duhet të jetë e qartë këtu në këtë Kuvend, duke refuzuar juridiksionin universal të Republikës së Serbisë për tërë territorin e ish-Jugosllavisë dhe duke kërkuar që një qëndrim të tillë të qartë ta mbajë edhe Qeveria e Kosovës ndërkombëtarisht, por në veçanti në dialogun e Brukselit.

Dhe, në fund, këtu dua të themi një gjë të qartë. Pas çdo zgjedhjeve në Serbi Bashkimi Evropian lëshon deklaratat se kanë fituar forca proevropiane, po flas për këto zgjedhjet e fundit.

Qeveria e Serbisë nuk është Qeveri proevropiane, ta themi me zë të lartë se nuk është Qeveri proevropiane, është Qeveri e njerëzve që kanë vepruar në kohën e Milosheviqit dhe vazhdojnë të kenë qëllime të njëjta, por duan t'i arrijnë me mjete të tjera.

Prandaj, sytë duhet t'i kemi të hapur të gjithë në raport me një shtet fqinj të tillë dhe të mos kemi më politika reaktive, pra gjithmonë të reagojmë ndaj mureve, ndaj bllokadave, ndaj arrestimeve 'post festum', pa ndonjë përgatitje paraprake, pa i njoftuar njerëzit për riaktivizim të fletarrestimeve dhe pa ndërmarrë masa që çështja e fletarrestimeve dhe çështje të tjera esenciale për Republikën e Kosovës të ngrihen dhe të sqarohen në dialogun e Brukselit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haskuka e ka fjalën, nuk është. Atëherë zoti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,

Qytetarë të Republikës,

Arrestimet ndërkombëtare të ish-luftëtarëve të çlirimit kombëtar nuk janë më përjashtim, por janë bërë rregull.

Së pari ato i ka mundësuar koncepti i dështuar dhe i gabuar i politikës së jashtme që udhëhiqet nga negociatat me Serbinë, e cila nuk na njeh dhe na lufton kudo, si dhe nga kompromiset ndaj Serbisë, e cila nuk na ka kërkuar falje për krimet dhe rrjedhimisht, nuk ka paguar për dëmet e luftës dhe të okupimit.

Dhe, së dyti, Ushtria Çlirimtare e Kosovës është braktisur në dokumentet themeltare të pavarësisë e të Republikës, përkatësisht në Deklaratën e shpalljes dhe në Kushtetutë dhe, disi natyrshëm tash i nënshtrohet kriminalizimit.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk mund të jetë e harruar, nuk mund të thotë dikush që harrova ta përmend në Deklaratën e shpalljes së pavarësisë ose harrova ta përmend në Kushtetutë, pra nuk bëhet fjalë për harresë, bëhet fjalë për mohim dhe si e mohuar, ajo kriminalizohet.

Ne të gjithë e dimë që ajo është thelbi i historisë sonë të re, por duke qenë e mohuar, kriminalizohet. Me që u la jashtë shtetit, ajo mbyllet brenda burgjeve.

A duhet të mësohemi ne me këtë rregull? Sigurisht që jo. Ky rregull i pranuar nga pushtetarët kosovarë është rregull i padrejtësisë, neve na duhet që vazhdimisht padrejtësinë ta vendosim në pikëpyetje, të jemi kritik ndaj saj dhe aktiv kundër saj deri atëherë kur padrejtësia të rrëzohet e institucionet e Kosovës t'i qeverisë e drejta dhe e mira e përgjithshme.

Këto ditë intensivisht është folur për arrestimin e Ramush Haradinajt dhe sigurisht shumicës së shqiptarëve, përfshirë gjithë Lëvizjen “Vetëvendosje”, jo vetëm që na vjen keq për këtë arrestim, por edhe jemi të revoltuar ndaj kësaj padrejtësie. Ama do të ishte hipokrizi po të thuhej se të gjithë ata që kanë folur me keqardhje, sidomos pushtetarët, e duan vërtet ndaljen e arrestimeve të tilla. Nëse do ta donin ndaljen e arrestimeve me gjithë mend, përse këta qeveritarë nuk e kanë vendosur si kusht në negociatat e tyre me Beogradin që të zhvlerësohen, të anulohen fletarrestimet e Serbisë për çlirimtarë tanë? Pse? Sepse ato negociata kanë qenë dhe janë edhe të turpshme, edhe pa parime.

Gjithnjë është negociuar pa kushte për Serbinë, e sipas kushteve të Serbisë vetëm për çështje të brendshme të Kosovës.

Në dialogun në Bruksel Kosova nuk mund të jetë tamam palë, gjersa është vazhdimisht temë. Pra, thuhet që Kosova është palë aty, por në fakt Kosova është shumë më tepër temë se sa palë. Përderisa je kaq shumë temë, nuk mund të jesh me tamam palë.

Dialogu me Serbinë, pa kushte për Serbinë, e për çështje të brendshme të Kosovës ishte një gjë e panevojshme për neve që na kushtoi shumë shtrenjtë. Normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë nuk ka qenë normalizim drejt njohjes së Kosovës, por normalizim përkundër mosnjohjes së Kosovës.

Me Serbinë e kemi problemin e dyfishtë, edhe krimet e saj, edhe armiqësinë e saj. Sepse mund të ketë dy shtete që kanë problem krimet nga e kaluara, por nuk kanë armiqësi aktuale. Mund të ketë shtete që nuk kanë probleme me krimet nga e kaluara, por kanë armiqësi aktuale. Me

Serbinë i kemi të dyja: edhe armiqësinë aktuale, edhe krimet e pasqaruara dhe të padënuara nga e kaluara.

Pra, dialogu me Serbinë është quajtur “Dialog për normalizim”. Në këtë janë thirrur edhe kryetarët e Odave Ekonomike të Serbisë dhe të Kosovës, Marko Çadezh dhe Safet Gërxhaliu, kur kah mesi i marsit të vitit të kaluar u kanë dërguar letër zyrtareve të lartë të Bashkimit Evropian dhe ambasadorëve të vendeve të Kuintit në Serbi dhe në Kosovë. Ja çfarë thoshin ata aty. “Oda Ekonomike e Serbisë dhe Oda Ekonomike e Kosovës, që janë të përkushtuara drejt normalizimit të marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës, pra nuk thonë Kosovës e Serbisë, thonë Beogradit e të Prishtinës, si dhe rimëkëmbjen sociale dhe ekonomike të Ballkanit perëndimor në rrugën drejt BE-së, dënojnë ashpër përmbysjen e kamionit me mallra serbe më 11 mars”. Pra, e dënojnë ashpër përmbysjen e kamionit me mallra serbe më 11 mars, duke e konsideruar si një përpjekje të shkeljes së lirisë së lëvizjes së njerëzve dhe mallrave, letër kjo drejtuar komisionarit evropian për Zgjerim, Johanes Hann, përfaqësueses së lartë për Politikë të Jashtme të BE-së, Federika Mogerini, si dhe ambasadorëve të Italisë, Gjermanisë, Britanisë së Madhe, Francës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Pra, derisa kemi kesi kryetar të Odës Ekonomike, i cili bashkë me homologun e tij serb i shkruajnë letër Brukselit kundër “Vetëvendosjes” pse është përmbysur një kamion me mallra serbe, mund ta kuptoni se për çfarë shtetndërtimi bëhet fjalë në Kosovë dhe pse kjo marrëdhënie jonë asimetrike rezulton me kaq shumë dëme e vuajtje edhe 17 vjet pas çlirimit, e gati 9 vjet pas shpalljes së pavarësisë.

Deputetë të Kuvendit të Republikës,

Janë dy leva që Kosova mund t’i përdorë kundër Serbisë: ndërprerjen e dialogut dhe shkëputjen e tregut. Po i vërej që shumë prej jush po thoni që duhet të kërcënojmë, duhet ta bëjmë ndërprerjen e dialogut. Në këtë mënyrë edhe ju po pranoni që ky dialog realisht shumë më tepër i konvenon Serbisë, në mos krejtësisht Serbisë, e jo edhe Kosovës.

Pra, ne mund ta kushtëzojmë Serbinë me ndërprerjen e dialogut, sepse asaj i duhet dialogu, jo neve. Ajo po ecën drejt BE-së, ndërkohë që s’po shkëputet prej Ruisë, kurse ne e shihni se si kemi mbetur.

Por edhe çështje tjetër është shkëputja e tregut. Shpallja e pavarësisë së Kosovës ka qenë shpallje e pavarësisë administrative, le të themi, në kuptimin ekonomik, edhe tregtar Serbia shet mallra në Kosovë pak a shumë si në kohë të okupimit. Nuk ka ndodhur pavarësia, shkëputja tregtare dhe ekonomike.

Rreth gjysmë miliardi euro Serbia për çdo vit i merr prej nesh me mallra, të cilat ndoshta edhe cilësinë e kanë të dyshimtë.

Në arenën ndërkombëtare, e sidomos evropiane, Kosova dhe Shqipëria kanë shumë më tepër arsye për ta kushtëzuar Serbinë sa Kroacia. Por, ja që nuk po e bëjnë këtë, sidomos Kosova, dhe kjo është për të ardhur keq, është dëm edhe ndaj brezave të kaluar, por edhe të atyre të ardhshme, jo vetëm kësaj gjeneratës.

Sa i përket reciprocitetit vetëm po e marr një element të thjeshtë. Në 19 poste komanduese në Polici, në Preshevë, Medvegjë e Bujanovc, vetëm katër sosh janë shqiptarë, dhe vetëm në Preshevë kryeshefi është shqiptar, pra prej 19 posteve komanduese.

Ndërkohë që në Kosovë edhe më tutje insistohet për “Zajednicën”. “Zajednica” ka vdekur, por ka forca edhe brenda Kosovës edhe jashtë Kosovës që e duan ringjalljen e saj.

Kuvendi i Kosovës më 8 dhjetor të vitit 2011, me propozim të Visar Ymerit si kryetar i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” aso kohe, e pati miratuar këtë mocion për reciprocitet me Serbinë, po jua lexoj tri pikat e atij mocioni.

1. Qeveri t’i marrë masat e reciprocitetit të plotë politik, ekonomik dhe tregtar ndaj Serbisë.
2. Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë ta nxisë dhe të udhëheqë bashkëpunimin me prodhuesit vendorë dhe ndërmarrjet tregtare për gjetjen e zëvendësimeve për produktet e importuara nga Serbia.
3. Qeveria t’i forcojë të gjithë mekanizmat shtetërorë për ta siguruar zbatimin e përpiktë të masave të reciprocitetit ndaj Serbisë.

Pra, para 5 vjetëve e një muaj e kemi miratuar në Kuvend të Republikës këtë mocion, me këto tri pika.

Për kanë qenë 42 deputetë, kundër kanë qenë 33 dhe 2 kanë abstenuar.

Kemi edhe nga partia kryesore këtu në pushtet që kanë qenë kundër reciprocitetit dhe sot e morën fjalën.

Po i përmend vetëm emrat e disa prej tyre: Shaip Muja, Elmi Reçica, Bekim Haxhiu, Zenun Pajaziti, Adem Grabovci, Fatmir Xhelili, Xhevahire Izmaqi, Ganimete Musliu, Safete Hadergjonaj kanë votuar kundër reciprocitetit më 8 dhjetor të vitit 2011. Tash mund të flasim sa të duam, por gjërat e këqija të mëdha nisin me hapa të vogël të gabueshëm dhe i tillë ka qenë edhe ky votimi atëherë.

Edhe qytetarët e Republikës nuk duhet t'i dëgjojnë vetëm fjalën e deputetëve, por t'i shikojnë edhe votimet e tyre, se shpeshherë këtu po flitet në mënyrë parimore, konstruktive, progresive, e mandej votat janë saktësisht e kundërta e kësaj, ajo që është në thelb më e rëndësishme.

Dialogu i kësaj Qeveria me Serbinë e ka bazën te besimi që konjuktura udhëheqëse në Serbi është cilësisht e ndryshme prej kohës së Milosheviqit.

Ne e dëgjuam këtu ministrin e Punëve të Jashtme teksa thoshte: “Këta janë pasardhësit e Milosheviqit”. Dëshironte ta gjente një distancë minimale të brendshme mes Milosheviqit dhe pushtetit të sotëm. Ani pse thoshte se janë të ngjashëm, po të thuash të ngjashëm, do të thotë se nuk janë të njëjtë.

Pra, i gjithë dialogu me Serbinë bazohet mbi këtë premisë, mbi premisën që këta nuk janë bash si Milosheviqi. Po, po, janë të ngjashëm, por nuk janë bash si Milosheviqi.

Se Vuçiqi megjithatë i mban raportet me Perëndimin, thonë këta. Në fakt, Vuçiqi është ndryshe, sepse rrethanat kanë ndryshuar, e jo qëllimi.

Ndarja e roleve midis Vuçiqit, Nikoliqit, Sheshelit edhe Daçiqit në Serbi është një farëz e vjetër që kollaj mund të shndërrohet në një tragjedi të re në Ballkan.

Në këtë pikë, unë dua të tërheq vërejtjen te një dëm sistematik dhe i dyfishtë që po i ndodh shtetit të Kosovës.

E para, është dobësia jonë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Edhe 2 minuta...

ALBIN KURTI: Po, po nga 16 minuta kanë folur...

KRYESUESI: Po, ne jse, ti e ke marrë edhe nga gjysmë ore nganjëherë. Janë edhe 20 deputetë që duhet të diskutojnë.

ALBIN KURTI: Pra, e para është dobësia e shtetit të Kosovës, se dobësia jonë bëhet magnet për kundërshtarin, në këtë rast Serbinë, për armikun.

Dhe e dyta, është fanatizmi serb. Nuk bën asnjëra të nënçmohet. Dobësia e shtetit të Kosovës në kuptimin që prej se është negociuar me Serbinë e deri te “pronto aferat” Serbia e ka marrë vesh

që Kosova realisht nuk ka përmbajtje shtetërore. E ka parë që ka udhëheqje klanore, ata e kanë parë që te ne nuk ka shtet dhe kjo ua shton apetitet atyre. Pra, dobësia jonë është magnet për apetitet e tyre. Edhe e dyta është fanatizmi serb.

Para disa viteve udhëheqësi çetnik i serbëve të Bosnjës, Milorad Dodiku, e ka thënë aksiomën e politikën serbe, që nuk vlen veç për Bosnjën, me një fjali të thjeshtë dëftore, e cila është kjo: “Ne do të lodhemi të fundit”. Kështu ka thënë ai, “Ne do të lodhemi të fundit”, që i bie edhe kroatët, edhe boshnjakët do të lodhen para neve, por në fakt i bie edhe shqiptarët. Ne i themi “Bac, u kry”, ata po thonë “Ne do të lodhemi të fundit”. Kjo i bie që, në fakt, duhet të bëhemi gati që nuk kryhet kurrë, ose së paku nuk kryhet pa u lodhur ata para nesh. Ne s’po e përsërisim të vërtetën për krimet e Serbisë, ajo po i përsërit gënjeshttrat për krimet tona e mandej po dihet rezultati.

Shtrohet pyetja si ka mundësi që Franca, e cila është ndër shtetet e para që e ka njohur Kosovën, ta aktivizojë pikërisht tani një fletarrestim të vitit 2004 për një luftëtar çlirimtar e komandant lufte, i cili edhe më parë ka vizituar Francën, por nuk i ka ndodhur asgjë.

Këtu pati një mini-seancë brenda seancës sonë, nuk bën të prishim marrëdhëniet me Francën, Franca është shtet që na ka ndihmuar, Franca është ....

KRYESUESI: Albin, t’i krejt politikën e brendshme e të jashtme po e analizon. Merru me çështjen, o burrë, mbylle me çështjen. Vazhdoja, ta përmyllë diskutimin.

ALBIN KURTI: Pra, se Franca është demokratik, se është shtet perëndimor, ne besojmë në drejtësinë franceze, bile kishte njerëz këtu që përbeheshin në Francën më shumë se vetë francezët. Pra, kishte njerëz që besojnë në Francën, edhe më shumë se Franca në vetvete. Franca është e ndarë për shumë çështje, por këtu kishte njerëz që besojnë në Francën në mënyrë absolute, po unë do të thosha naive.

Shtrohet pyetja, pra, përse të na vijë kjo ngjarje e keqe prej Francës, ku siç thuhet nëpër media që Franca është ndër të parat që e ka njohur pavarësinë, është ajo e cila ka ndihmuar intervenimin e NATO-s, e të tjera e të tjera. Këto janë pyetje që kanë nevojë për përgjigje dhe unë përgjigjen e gjej te një filozof i shquar bashkëkohor francez, i cili kur fliste për atdheun e tij thoshte se ka pasur gjithnjë dy Franca.

Në njërën ana Franca e Revolucionit borgjez, në anën tjetër Franca e restaurimit monarkist, në njërën anë Franca e iluminizmit progresiv, në anën tjetër Franca e reaksionit konservativ, në njërën anë Franca e rezistencës antifashiste, në anën tjetër Franca e kolaboracionizmit me Petenin dhe Vishin, në njërën anë Franca e majit të ’68-së, në anën tjetër Franca ksenofobe edhe neoliberalë.

Ne duam të besojmë se Ramush Haradinajn e ka arrestuar Franca e dytë. Franca e kolaboracionizmit me fashizmin, e reaksionit dhe e së djathtës ultrakonservatore.

E po kështu kemi besim se Ramush Haradinajn do ta çlirojë Franca e parë, ajo e Revolucionit republikan demokratik, ajo e luminizmit. Franca që solidarizohet me popujt që kërkojnë me sakrificë çlirimin e vetvetes.

E, për t'u kthyer tek Serbia, fundja e establismentit politik në Serbi nuk ka gjë të përbashkët me parullën e Revolucionit francez: “Liri, barazi, vëllazëri” dhe gjithnjë e më shumë ka shumëçka të përbashkët me parullën e Nikola Pashiqit: “Zoti, populli, Rusia”.

Kryeministri i Kosovës, Mustafa, tha është arrestuar ish-kryeministri Haradinaj, është arrestuar kryetari i AAK-së, Haradinaj, njëri nga liderët në vend, e të tjera e të tjera. Ai fliste për gjërat që e ndajnë kryeministrin me Haradinaj. Nuk e përmendi si qytetar të Republikës. Po ky do të mund ta thotë ndonjë fjalë edhe për Haradinajn si ish-kryeministër, që është pozicion përjashtues në raport me të, edhe si AAK, se ky nuk është i AAK-së, e kështu me radhë, por si qytetar i Republikës ku Haradinaj edhe Mustafa janë bashkë, për atë s'ka se çka bën. Pra, s'e mbron do si qytetar të Republikës, e kur nuk e mbron dot si qytetar të Republikës, kur nuk e mbron dot si luftëtar të UÇK-së, nuk e mbron dot si kryetar të AAK-së. Kot e përmend ti që është kryetar i AAK-së kur nuk arrin ta mbrosh si qytetar i Republikës, cili është kuptimi që të thuash se është arrestuar si...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Zgjatja,...

ALBIN KURTI: Pra, kur nuk arrin ta mbrosh njeriun si qytetar të Republikës, nuk mund ta mbrosh në funksionet e tij partiake.

Mustafa tregonte qysh Haradinaj është ndryshe prej qytetarëve të tjerë, sepse nuk e kishte ndërmend ta mbrojë si qytetar të Republikës. Po, po ashtu as si luftëtar i UÇK-së, e cila siç thash është përjashtuar nga themelet e shtetit dhe shtetndërtimit në Kosovë.

Deputetë të Kuvendit,

Qytetarë të Republikës,

Ne bëjmë thirrje për lirimin e menjëhershëm dhe të pakusht të Ramush Haradinaj si dhe për ndalimin e arrestimit të çlirimtarëve, por jemi të sigurt dhe këto thirrje nuk do të gjejnë dëgjues te Qeveria aktuale. Këto thirrje fatkeqësisht do të mund të gjejnë një përgjigje serioze vetëm nesër, kur pushtetin do ta ketë një Qeveri e ndershme dhe kur diplomacia do të udhëhiqet nga njerëz të mençur e me një doktrinë patriotike. Faleminderit! Tash ndale krejt!



KRYESUESI: Faleminderit! Unë s'e ndala asnjëherë, por ndalej vetë. Zoti Bali Muharremaj e ka fjalën.

Shaip Muja, replikë!

SHAIP MUJA: Zoti Xhavit, se çka ka thënë ai, unë e dëgjova dhe çka po thotë. Ne nuk kemi ardhur t'i dëgjojmë opsionet e "Vetëvendosjes", e cila është e profesionalizuar ta infektojë opinionin publik, e kryesisht atë opinion, i cili nuk ka performancë edhe përgjegjësi politike.

Ne nuk kemi votuar kundër reciprocitetit, por ne kemi votuar kundër propozimeve të "Vetëvendosjes", e cila nuk i njeh institucionet e Republikës së Kosovës dhe kemi thënë dhe vazhdoj të them se është keqpërdoruesja më e madhe e institucioneve të Kosovës, e cila nuk njeh subjektivitetin politik të Kosovës, nuk njeh identitetin diplomatik të Kosovës, nuk njeh angazhimet e identitetin e simboleve të Kosovës.

Prandaj, ne sot nuk kemi ardhur të dëgjojmë opsionet politike të "Vetëvendosjes", sepse nuk i dhemb Albin Kurtit për Ramush Haradinajn, por na mbajti ligjëratë që 20 minuta, duke ia vazhduar që tri herë. Ne mund të shtyhem në një seancë tjetër për t'i analizuar partitë politike, çfarë qëndrimesh kombëtare kanë në sferën politike të shoqërisë kosovare, por jo ta shfrytëzojnë situatën për Ramush Haradinajn kishe po u dhemb, e në tjetrën anë, të na mbajnë leksione që po dimë diçka dhe ju nga parlamenti nuk po dini asgjë.

Prandaj, këto metoda janë të tejkaluara, opinionin publik e di fort mirë këtë mision dhe këtë qëndrim të tyre.

Në çështjet e angazhimeve për luftimin e prezencës së Serbisë në Kosovë le të deklarohet "Vetëvendosja" sa e shfrytëzon Serbia angazhim që e bashkëdyzojnë ilegalisht bashkë në arenën ndërkombëtare dhe politike në Bruksel dhe në Uashington.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti, kundër-replikë.

ALBIN KURTI: Unë u ftova që pikërisht ta sqaroj komplet "Vetëvendosjes", sepse ashtu u bë akuza. Mirëpo, nuk do ta bëj këtë, pra u ftova që të flas gjerë e gjatë për "Vetëvendosjen", pikërisht tash të mbaj ligjëratë, në ndërkohë që çështja ime është shumë e ngushtë, është shumë tematike, aktuale, i korrespondon kësaj seance.

Pra, ka të bëjë me votimin e zotit Muja më 8 dhjetor të vitit 2011 kundër reciprocitetit, sepse pika e parë ishte që Qeveria t'i marrë masat e reciprocitetit të plotë politik, ekonomik dhe tregtar ndaj Serbisë. Unë nuk besoj që votimi duhet të bëhet me inat, e ka propozuar "Vetëvendosja", tash votojmë kundër. Jo, nuk bën ashtu, lexoje çka po thotë "Vetëvendosja, pranoje ose refuzoje, por

jo veç pse e ka propozuar “Vetëvendosja”. Sepse nëse ju duhet të zgjidhni, ta zëmë, kush të jetë në pushtet: “Vetëvendosja” a Serbia? Kë do ta zgjidhni? Kjo është pyetje legjitime.

KRYESUESI: Zoti Muharremaj e ka fjalën.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryetar!

E nderuar familje Haradinaj,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

KRYESUESI: Zoti Muharremaj, prit se nuk di sa vetëve u është përmendur emri. Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën, replikë!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Përmendja e një momenti nga zoti Kurti i disa prej deputetëve këtu, është veç një tentativë që ta zhvendosë vëmendjen edhe të deputetëve, edhe të opinionit nga tema, për t’u marrë me tema të tjera, e jo me temën në të cilën jemi.

Kur do, Albin, të vendosësh reciprocitet ndaj Serbisë, nisja prej partisë. I ke bashkëpartiakët tuaj që tregtojnë me Serbinë. Edhe në kohën kur keni propozuar reciprocitetin me Serbinë, këtu, në këtë foltore, të kam thënë që vëllazëria e deputetëve, axhallarët e deputetëve tuaj tregtojnë me Serbinë. Ndali të partisë tënde, pastaj dil tutje.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Kurti.

ALBIN KURTI: Lëvizja “Vetëvendosje” ka mijëra e mijëra anëtarë, ata kanë dhjetëra-mijëra axhallarë, halla, teze, unë s’di krejt çka bëjnë ata. Por, gjithashtu mund të them se ky është banalizimi i një çështjeje shumë serioze. Unë këtu jam për vendime shtetërore, deputetët e “Vetëvendosjes” kanë dhënë shembullin e vet edhe në protesta e demonstrata, edhe në votime, fjalime e qëndrime, se janë kundër Serbisë dhe janë për reciprocitet me Serbinë.

Pyetja ime është shumë e thjeshtë. Zoti Haxhiu, pse keni votuar kundër reciprocitetit me Serbinë më datën 8 dhjetor të vitit 2011? Kjo është pyetja konkrete. Është dashur të votoni për. “Vetëvendosja” e ka ofruar reciprocitetin me Serbinë, ke pasur shansin ta dëshmosh veten duke votuar “për”, ke votuar kundër reciprocitetit me Serbinë, asnjë fjalë s’ka kuptim më.

KRYESUESI: A ka dikush tjetër replikë prej emrave? S’ka, zoti Muharremaj, e keni fjalën.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryesues!

E nderuar familje Haradinaj,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fillimisht më duhet të përsëris se nuk është hera e parë që arrestohet zoti Haradinaj. Vitin 2017 e filluam me probleme të vjetra e të njëjtat që nga paslufta. Jemi në prag të 9-vjetorit të shpalljes së pavarësisë, në këtë rrugë të gjatë të shtetndërtimit nuk po arrijmë të tregojmë forcën tonë, sovranitetin tonë si shtet. Sot si kurrë më parë, si përfaqësues i popullit ndjehem i lënduar. Sot si kurrë më parë ndjehem i ofenduar, e kjo për shkak se Republikës së Kosovës i është cenuar sovraniteti.

Shteti ka dështuar, Qeveria ka dështuar, zoti Haradinaj burgoset me fletarrestim të lëshuar nga shteti i Milosheviqit, nga bijtë politikë e ideologjikë të Serbisë. Ata dinë, prandaj kështu tentojnë të ndalin zërin më të fuqishëm në mbrojtje të sovranitetit të Republikës së Kosovës. Nuk duhet harruar nga askush, sepse Serbia kurrë nuk harron, prandaj e ndjek kështu, se Ramushi ishte prijës i sukseseve, i luftës për liri, i luftës të cilën e mbrojti me dinjitet paqësisht edhe para Hagës.

Po ashtu, nuk duhet harruar, e ndoshta edhe kjo e pengon dikë, zoti Haradinaj si kryeministër i këtij vendi dje, por edhe si lider politik zhvilloi e i shtyu përpara shumë procese demokratike edhe bashkë me ish-presidentin historik, Ibrahim Rugova.

Të nderuar deputetë,

Nuk dua të flas për atë a është çështje politike apo juridike. Rreth ndalimit të zotit Haradinaj nuk duhet të flas as histori, nuk dua të flas as raportet tona me shtetin e Francës, ajo që dua të them sot është një fakt: lufta e popullit shqiptar për liri dhe pavarësi, sakrificë sublime për të realizuar vullnetin për lirinë e shtetit, po nëpërkëmben pikërisht për shkak të politikës së mëparshme të disa njerëzve brenda koalicionit qeverisës.

Sot, kur ne flasim këtu, lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, është në ndalim. Dikush e quan “ndalim”, dikush “arrestim”, dikush “burg”, por unë do ta quaj “peng”, peng i politikës të kësaj Qeverie, e cila nuk është treguar e aftë të zbatojë vullnetin politik të popullit. Nuk ka arritur të ndalojë ndërhyrjen e Serbisë në punë të brendshme të Republikës së Kosovës, duke i nxjerrë në pazare çështjet e brendshme në dialog me Serbinë, duke lejuar që dialogu të rrëshqasë nga dialogu për çështje reciproke ndërshtetërore, në një pazar politik ndërmjet disa negociatorëve të Qeverisë.

Sot kur flasim këtu zoti Haradinaj rrezikon ekstradimin në Serbi, e Qeveria jonë, e pazonja ta mbrojë sovranitetin e Republikës, nuk ka as zë unik, as qëndrim të qartë politik nën hijen e Vuçiqit dhe Daçiqit nuk kanë as fuqi, as zë. Qeveria është treguar e papërgatitur politikisht, e pafuqishme dhe e paaftë të ndërtojë strategjitë, të forcojë shtetin, sovranitetin, karshi fqinjëve dhe faktorëve ndërkombëtarë. Prandaj, ky Parlament të dalë me qëndrim të qartë politik karshi

Qeverisë së Kosovës, Qeverisë së Serbisë dhe faktorit ndërkombëtar në mbështetje dhe të nxjerrë një rezolutë që t'u jepte fund njëherë e përgjithmonë kompromiseve politike në dëm të sovranitetit të shtetit tonë.

E, po ashtu ku do të insistonte që zoti Haradinaj të kthehet sa më parë në Kosovë, e të bëhet e qartë që nuk do të tolerojmë që këto akte të përsëriten. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bytyqi e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar familje Haradinaj,

Bisedimet pa kushte kanë bërë që çlirimtarët tanë të bien pre nëpër shumë shtete të ndryshme. Kur "Nisma për Kosovën" bënte thirrje që të ndërpriten bisedimet pa kushte me Serbinë, shumë aktorë të kësaj Qeverie dhe shumë deputetë të këtij Kuvendi sikur e kishin drejtuar gishtin nga ne, duke na thënë se ne e pengojmë proceset, se ne nuk i respektojmë ndërkombëtarët dhe se ne nuk po dëshirojmë fqinjësinë e mirë.

Por, asnjëherë këtyre aktorëve të lartpërmendur nuk iu kishte shkuar mendja se pikërisht bisedimet me kushte dhe reciprocitet do të jenë vazhdim i proceseve, respektim i miqve ndërkombëtarë dhe themel i fqinjësisë së mirë. Pra, këta protagonistë sikur e maskuan krejt paaftësinë e vetë me sulme ndaj opozitës, e që këto sulme shkuan në dëm të Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj. Bisedimet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë nuk kanë filluar për të kënaqur Serbinë, por për t'i normalizuar marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve që ky normalizim nuk ndodhi asnjëherë dhe tani pas 6 vjetëve dialog, ka ardhur koha që këto bisedime të ndërpriten.

U dëgjua edhe nga shumica e deputetëve të tjerë që këto bisedime vetëm se i kanë shkaktuar dëm Republikës së Kosovës dhe asnjë dobi. Prandaj, kërkojmë edhe nga BE-ja që të angazhohet për të parandaluar qëndrimet dhe veprimet që minojnë procesin e normalizimit, BE-ja, po ashtu, të angazhohet jo vetëm në arritjen e marrëveshjeve, por edhe në sigurimin e zbatimit të këtyre marrëveshjeve, sepse këto marrëveshje mbesin në sirtarët e atyre që i nënshkruan.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ndalimi apo arrestimi i liderit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, është një akt i padrejtë, i dënuar, është dështim i radhës i kësaj Qeverie, është dëshmi që politika e jashtme e Republikës së Kosovës ishte dhe vazhdon të jetë jofunksionale. Kjo Qeveri nuk është në gjendje t'i ndalë kriminelët serbë që provokojnë e nxisin ide nacionaliste, ekstremiste në Gjakovë e në tërë Kosovën, që ndërtojnë mure, që ndërtojnë shtëpi dhe s'lenë gjë pa bërë dhe

paaftësia e saj shihet jo vetëm në rrafshin ndërkombëtar, por edhe në atë brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Dhe, tani ky fletarrestim po del për çlirimtarin e Republikës së Kosovës, për komandantin, pra ky arrestim i Milosheviqit po del që të jetë më i fortë se gjithë diplomacia e Kosovës, po del të jetë më e fortë se shtetësia e Kosovës dhe normal që qytetarët e Republikës së Kosovës ndihen të pasigurt me këtë paaftësi të kësaj Qeverie dhe kjo është një dëshmi e fortë se Serbia kurrë nuk e ka ndalë dhe nuk e ndal luftën kundër Kosovës dhe çlirimtarëve të saj.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në Francë nuk u arrestua vetëm Ramush Haradinaj, në Francë u arrestua Kosova dhe historia e saj, u arrestua qytetari i Kosovës, u arrestua e ardhmja e saj. Arrestimi i zotit Ramush Haradinaj na shqetëson edhe për shkak se gjykata në fjalë është në shtetin e Francës, e cila së bashku me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës morën pjesë në çlirimin e Republikës sonë. Arrestimi i zotit Haradinaj na shton pezmin e madh ndaj kësaj Qeverie, e cila me politikën e saj të paaftë, servile e nepotiste formoi Gjykatën Speciale dhe që, deshëm apo s'deshëm, kjo i kontribuoi edhe këtij arrestimi.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Zoti Ramush Haradinaj dhe familja e tij po e paguajnë shumë shtrenjtë përkushtimin ndaj Kosovës, ndaj lirisë dhe ndaj pavarësisë së saj, me dy gjykime në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës dhe me dy arrestime pas lirisë. Këto janë sakrificat të shtrenjta, andaj kërkojmë lirimin sa më të shpejtë të zotit Haradinaj, ai t'i kthehet familjes dhe angazhimit të tij politik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Burgosja e Ramush Haradinajta është mesazh, a është taktikë apo kërcënim për sigurinë e Kosovës? Para më se një viti e gjysmë, saktësisht diku më 18 qershor 2015, kishim seancë të njëjtë, për arsye të njëjtë: burgosjen e Ramush Haradinajt, liderit të AAK-së, nga institucionet e sigurisë së Sllovenisë nën pretekstin e kërkimit ndërkombëtar të lëshuar nga Serbia për krimet e luftës. E njëjta situatë u përsërit së fundmi në Francë për të njëjtën temë, për të njëjtin motiv, edhe pse ishte liruar nga Gjykata sllovene zoti Ramush, ajo u përsërit prapë në të njëjtën aktakuzë, në të njëjtin institucion nga shtetet e BE-së, në të njëjtin juridiksion të Interpolit.

Çka mund të nxjerrim nga ky mesazh? Mesazhi mendoj se është i qartë, Interpoli në mosfiltrim të informacioneve po humb besueshmërinë e tij si institucioni më i lartë ndërkombëtar që është

ratifikuese dhe BE-ja, në këtë rast edhe Sllovenia dhe Franca, si shtete anëtare të saja. Bashkimi Evropian po humb seriozitetin e saj para një dominimi ruso-serb çdo ditë edhe në këmbim të informacioneve të klasifikuara, të cilat çdo ditë po bëhen mjete të forta në duart e atyre që nuk duan qetësinë evropiane dhe atë ballkanike. Bashkimi Evropian po tregohet infantil dhe i shpërfillur, duke menduar se individët nuk kanë rëndësi për sigurinë e Kosovës dhe qasjen e Serbisë.

Është më shumë individuale se kolektive e perspektivës së Kosovës, a është qesharake dhe tragjike e komike kur Ulrike Lunaçek deklaroi se është e befshuar se si Interpoli ende merret me aktakuzat e shtetit të Serbisë e Malit të Zi, e të cilat kanë humbur autoritetin e juridiksionit. Për të njëjtat aktakuza Ramush Haradinaj ishte përgjigjur në Hagë dhe kishte qëndruar 10 vjet nëpër grilat e saj për të kërkuar drejtësi. Kjo nuk është qesharake, por BE-ja s'ka asnjë qasje serioze për rrezikshmërinë e sigurisë së Kosovës, s'ka qasje pragmatiste dhe të ekuilibruar, prandaj japin deklarata të tilla që i bashkon koret e vajtimin në qarqet shqiptare politike e shtetërore.

Bashkimi Evropian që në njëfarë mënyre është i dorëzuar karshi influencës ruse në Ballkan dhe Evropë që nëpërmjet instrumentit të saj, shtetit të Serbisë, çdo ditë është duke bërë shtrirje dhe dominim ushtarak okupues dhe shkatërrues për të ardhmen e Bashkimit Evropian. Ky është mesazhi për mua i qartë, ndoshta jam gabim, por le të ma thotë dikush ndryshe. Burgosja e Ramush Haradinaj është taktikë e Serbisë dhe e Rusisë. Unë them po, sepse me burgosje për të dytën herë në shtetet e Shëngënit Serbia po taktizon që të tërhiqet vëmendja e saj për krimet që ka bërë në Ballkan. Gjatë këtij 20-vjeçari që lamë mbrapa dhe po shtirret si shtet i cili do drejtësinë, si shtet i cili po ndjek krimet e luftës, e në anën tjetër është vetë bartësja kryesore e krimeve të luftës.

Por, qëllimi i saj nuk është aty. Qëllimi është më i lartë dhe në mes të këtyre taktizimeve ajo po tregon disa veprime, të cilat sot duan shpjegim:

1. Ajo po do të klasifikojë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si organizatë terroriste, ku pjesë domethënëse e kësaj lufte ishte dhe Ramush Haradinaj.
2. Nëpërmjet kësaj ajo po godet integritetin e Kosovës, duke e paraqitur si fragjile dhe duke krijuar idenë se Kosova nuk është e denjë për të qenë anëtare e Bashkimit Evropian. Këtë karrem Evropa e ka kapërdirë mbi 1 dekadë.
3. Ajo po tregon se EULEX-i në Kosovë, si komponent i Bashkimit Evropian për drejtësi, është i dështuar e që segmentet e drejtësisë jo që s'i ka fuqizuar, por i ka shkatërruar dhe ka shkaktuar destabilizim të sigurisë.

4. Që të dëshmojë se forca euroatlantike NATO, me bombardimet e saj është rreshtuar gabimisht kur ka marrë hapin për të bombarduar Serbinë dhe është radhitur në këtë organizatë “terroriste” të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe qëllimi i saj është që të largojë NATO-n në Kosovë dhe ta ketë terren të defilimit Serbinë dhe Rusinë.

A është problem për siguri kjo burgosje? Unë them se po, sepse Serbia po do të përdorë ofensivë diplomatike e diversive e komprometuese për Kosovën. Rasti më i fundit është kur Daçiq thotë se kemi informacione të klasifikuara që aktivistët shqiptarë po mundohen të okupojnë ambasadat nëpër Evropë. Ne nuk i kemi okupuar edhe kur na kanë vrarë mbi 20 mijë vetë, ne nuk bëjmë gabime, të cilat ka bërë Serbia. Ne kemi bërë luftë çlirimtare dhe me atë luftë kemi bindur edhe NATO-n të ndërhyjë.

Por, me këto deklaramet e Daçiqit që janë tejet të rrezikshme, segmentet e sigurisë së Kosovës dhe ato prezentë ndërkombëtare duhet të ngrihen në nivelin më të lartë të alarmit. Serbia është e gatshme të fillojë edhe atakimin në formë terroriste vetveten, vetëm e vetëm t’ia arrijë qëllimit të saj dhe të gjitha këto veprime do t’ia veshë Kosovës në planin mediatik e në planin politik kombëtar serb të brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Serbia mund të atakojë edhe segmentet e NATO-s në veri e në brendësi të Kosovës, duke atribuar që shqiptarët po e bëjnë këtë, ku edhe mund ta bëjë, sepse shqipfolës ka pasur dhe do të ketë vazhdimisht Serbia në Kosovë. Por shqiptarët asnjëherë nuk do ketë që t’i përdorë kundër sigurive vendore dhe ndërkombëtare, praktika e ka treguar këtë. Serbia do të vazhdojë edhe më tutje shumë të stimulojë radikalizmin islam në Kosovë, nëpërmes lidhjeve të saja me dekadaqë i ka në Beograd. E kam thënë dhe vazhdoj ta them, se radikalizmi islam, njërën ndër burimet kryesore të rritjes, nëse ka rritje në Kosovë, e ka nga Serbia.

Shih shtypshkronjat e veçanta që i ka vetëm për këtë çështje, për shpërndarje, për financim të radikalizmit islam në Kosovë dhe në këtë drejtim të përçojë edhe mesazhe se shqiptarët në Kosovë nuk kanë as identitet fetar, e as kombëtar. Të gjitha këto çka i përmenda mendoj se siguria rrezikohet seriozisht në Kosovë, por çka duhet ne të bëjmë, shtrohet pyetja. Shqetësimi ynë kolektiv është pse u burgos Ramushi, a po ekstradohet në Serbi, pse po goditet Ushtria Çlirimtare e Kosovës në këtë mënyrë? Pse Evropa po hesht? Ramushi është sinonim real i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, jo imagjinar. Ai atje është burgosur jo si Ramush, por është burgosur si Ushtri Çlirimtare e Kosovës. Ai po tentohet të dëmtohet si Ushtri Çlirimtare e Kosovës, jo si Ramush, individ e lider partiak. Por unë e di siç e njoh Ramushin nga viti ‘92 e deri më sot dhe tërë familjen e ngushtë, ai atje është dinjitoz, është UÇK, është kombëtar dhe si i tillë do të vijë në Kosovë, por kjo nuk përmbush zgjidhjen e problemeve çka duhet ne të bëjmë.

Në debatin e kaluar kur është burgosur në Slloveni jemi munduar të dërgojmë mesazhe me rezoluta, të cilat as nuk janë përfillur, as nuk jemi angazhuar. Unë kam dorëzuar dhe pasaportën

diplomatike për të çuar mesazh në Bashkimin Evropian që o të jemi të barabartë në mes të barabartëve, o mos na merrni si të tillë. Kam çuar mesazh që të akuzohen Vuçiqi, Daçiçi dhe Nikoliqi si bartës direkt ose indirekt të kriminalitetit të Milosheviqit me viktimat që i ka shkaktuar në Kosovë, të cilëve duhet t'u ngrihet kjo akt padi edhe në institucionet e Republikës së Kosovës, as atë nuk e kemi bërë ne.

Në bisedime ne duhet të shohim e t'i nxjerrim kufijtë e tolerancës, që tutje s'mund të zvarritemi në mënyrë të tillë, pa u sqaruar 1 mijë e 400 persona të zhdukur nga Serbia që nuk po sqarohen, ne nuk vazhdojmë bisedimet. Në këtë vend e kam thënë në mandatin e kaluar, një varrezë masive në Bujanoc, me sistemin GPRS të saktë dhe që kam dëshmitarë, por kanë frikë të deklarohen, sepse jetojnë andej kufirit dhe komisionin tonë e kanë mashtruar, aq sa kam unë informacione duke mos i dërguar në vendin e saktë grupi serb kur kanë filluar hulumtimet.

Këto metoda i tregon edhe rasti i Rashkës, ku i kanë mbyllur kufomat me objekte të ndërtuara pas luftës. Pa u sqaruar e drejta e prezencës së segmenteve të sigurisë serbe në Kosovë dhe atyre politike deri ku mund të përzihet dialogu nuk mundet të bëhet, pa u zhvlerësuar aktakuzat e bëra serbe për vitet '98-'99 me pretendimet që ne i kemi bërë s'ka dialog, sepse për këto vite ne votuam kundër vullnetit tonë edhe për Gjykatën Speciale. Çfarë kuptimi ka atëherë kjo gjykatë ose ne duhet të ulemi të shohim edhe rolin e kësaj gjykate.

Qeveria e Kosovës të dërgojë letër zyrtare direkte ose përmes shteteve mike në Interpol që çdo aktakuzë e bërë të njoftohet shteti ynë dhe nëse vërtet ka fakte të burgosur në Kosovë të secili rast, e jo t'u bëhen skenarë të tillë të cilët janë aq komike dhe aq të pabesura dhe aq palogjike që angazhimin tonë për të bërit shtet e vë në lajthitje.

Pse? Sepse, prezenca e EULEX-it në Kosovë duhet të sqarohet, ajo është komponent i Bashkimit Evropian në Kosovë, apo ne duhet edhe një votim ta bëjmë të qartë duke adresuar se EULEX-i të qartësohet plotësisht, të adresohet në veri të Kosovës së bashku me NATO-n për të vënë dorë në siguri, për të ndjekur kriminelët e vërtetë të Daçiçit, Vuçiqit e Nikoliqit.

I nderuar Pal Lekaj,...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Regjia, le ta përfundojë diskutimin!

SHAIP MUJA: I nderuar Pal Lekaj, si parashtrues i kësaj seance, propozoj që nga këto konkludime të vlerësohen edhe këto propozime për pikat e rezolutës, në të kundërtën ne kemi mbajtur vetëm një seancë, ku kemi luajtur rolin e vajtuesit, konkluduesit, dhe asgjë për të zgjedhur.



Ramush Haradinaj dhe çdo veprimtar që ka luftuar aktivisht direkt dhe indirekt kundër regjimit vrastar serb duhet ta ndiejë veten krenar, ndërsa Evropa duhet t'u bëjë vlerësimin, sepse rrëzuan regjimin e fundit diktatorial e shovinist, kriminal. Në këtë rast në rezolutë duhet të futen dy pika shumë të rëndësishme, të cilat duhet të jenë shumë pozitive për shëndetin e shoqërisë politike në Kosovë për të ardhmen.

Unë ju ftoj të gjithë deputetëve, unë do të filloj një iniciativë për themelimin e Ligjit për lustrimin dhe kërkoj nga ju ta mbështetni të gjithë, sepse lustrimi nuk do ta dëmtojë askënd, por do t'i qartësojë shumë çështje në Republikën e Kosovës. Po ashtu, do të fillojmë iniciativën e kthimit të dy neneve të Ligjit të shpifjeve, sepse me Ligjin e shpifjeve po mbrohet shumëkush duke shpifur dhe duke i bërë fakte ato të cilat nuk janë fakte. Për këto dy iniciativa qysh sot duhet të fillojmë, sepse jemi vonuar dhe ne nuk po dëmtojmë askënd, por po sjellim një praktikë, të cilin e ka sjellë edhe Republika e Gjermanisë edhe të gjitha republikat e tjera.

Sa i përket zotit Kurti që s'ma dhatë fjalën, zoti kryesues, unë kur kundërshtova thashë për problemin e CEFTA-s, i cili nuk është pranuar atëherë, ne jemi nënshkruar të CEFTA-s, ne duhet t'i nënshtrohemi atij ratifikimi dhe ta respektojmë. Nuk kemi qenë kundër reciprocitetit, por nuk jemi për praktikën edhe propozimet e "Vetëvendosjes", e cila me metodat e veta të rezistencës jo që na ka turpëruar neve, por na ka dëmtuar rëndë edhe në perspektivë shtetërore dhe kombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ilir Deda e ka fjalën.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Para rreth një ore Ministria e Drejtësisë e Serbisë ka dorëzuar kërkesën autoriteteve të Francës për ekstradim të zotit Ramush Haradinaj. Ne fatkeqësisht nuk e kemi as ministren e Drejtësisë, as ministrin e Jashtëm që të na informojë tash se çka ka bërë Qeveria e Kosovës brenda 60 minutave të fundit, sepse rasti i arrestimit të padrejtë të Ramushit i nxjerr në pah disa të vërteta. E para, është që pesë muaj ditë Qeveria e Kosovës e di që janë riaktivizuar fletarrestimet e Serbisë, të cilat kanë qenë të suspenduara. Por, ne nuk e dimë çka ka bërë në ato pesë muaj ditë Qeveria e Republikës së Kosovës. E as njerëzit të cilët janë në ato lista a i ka informuar apo jo, domethënë këtë nuk e dimë.

E dyta, nuk e dimë a ka komunikuar kryeministri me shefin e UNMIK-ut dhe shefen e EULEX-it që të përfundojë njëherë e përgjithmonë çështja e ndjekjes të paktën në Bashkimin Evropian e shqiptarëve nga ana e Serbisë.

E treta, e kemi treguar një dobësi të jashtëzakonshme, sepse kur u anulua vizita e Nikoliqit, e cila nuk është dashur as të jetë temë, ministri i Jashtëm thotë ne kemi qenë në presion të jashtëzakonshëm ndërkombëtar. Po më duket këtu te ne ose po përdoren fjalë të mëdha për

situata të cilat nuk janë aq të mëdha, sepse një vizitë e kotë çfarë ka qenë e Nikoliqit dhe e drejta jonë sovraane që ta refuzojmë hyrjen e tij nuk duhet të sjellë presion të jashtëzakonshëm ndërkombëtar. E në qoftë se ka pasur presion të jashtëzakonshëm ndërkombëtar, atëherë kjo vetëm duhet të na tregojë të gjithë neve këtu në Kuvend, se sa shumë kanë ndërruar marrëdhëniet ndërkombëtare dhe sa të pafavorshme për Republikën e Kosovës këto ndryshime të marrëdhënieve ndërkombëtare janë. Ky del të jetë rezultati.

Tash, ne absolutisht s'na takon të vajtojmë, sepse ne jemi mbrojtës të sovranitetit të shtetit tonë, neve na kërkohet që të veprojmë. Në këtë ndryshim të rrethanave ndërkombëtare, të paktën që mund ta bëjmë, është me e definua në mënyrë të përbashkët minimumin e interesave nacionale të shtetit tonë. Çfarë nënkupton minimumi i interesave nacionale të shtetit në këtë ndryshim, që të kemi një qasje të dinjitetshme karshi Republikës së Serbisë dhe karshi Bashkimit Evropian? Domethënë, nuk mund të dalim më me deklarata “jo po na shtyjnë të marrim reciprocitet”, se reciprociteti nënkuptohet... dhe politika jonë nuk mund të jetë politikë e fjalëve të mëdha e veprave të vogla, por duhet së bashku, nëse Qeveria nuk e ka forcën, ne t'ia definojmë dhe ta obligojmë si Kuvend Qeverinë karshi asaj që duhet të bëjë.

E para, ne nuk kemi më nevojë të diskutojmë, as që kemi pasur nevojë të diskutojmë, me shefin e strukturave paralele të Serbisë në Kosovë, zotin Marko Gjuriq. Pse po e legjitimojmë ne atë?

E dyta, s'ka nevojë të shkohet në Bruksel pa u kthyer zoti Haradinaj në Kosovë dhe pa i suspenduar Serbia të gjitha fletarrestimet për qytetarët e Kosovës. Edhe për këtë s'ka nevojë për dialog me Serbinë. Ky le të jetë hap i tyre për përkushtim, të themi kushtimisht, në normalizim.

E treta, neve na nevojitet qasje e re, është momenti të kemi qasje të re të shtetit tonë karshi procesit të dialogut me Serbinë dhe kjo qasje e re, domosdoshmërisht nënkupton konsensusin nacional, patjetër. Ai konsensus arrihet në Kuvend.

Më tutje, ne duhet ta refuzojmë parimin e juridiksionit universal të Serbisë. Këtë e kemi diskutuar edhe në kohën kur arrestuar zoti Thaçi, Kuvendi e bëri një rezolutë, por nuk deshë ta përmend parimin e juridiksionit universal, ai po kundërshtohet nga Parlamenti Evropian. Më duket që është e turpshme për ne, që ne mos ta kundërshtojmë diçka që e kundërshton Parlamenti Evropian. Domethënë, patjetër në këtë rezolutë e cila duhet të bëhet, duhet të jetë “refuzimi i Republikës së Kosovës që ta marrë parasysh parimin e juridiksionit universal”. Edhe mos të na ndodhë edhe ndonjë arrestim në të ardhmen e që ta diskutojmë për së treti herë në Kuvend.

Dhe, më dëgjoni apo të dëgjojmë, ne po e shohim që ekziston një vakum karshi Kosovës prej shteteve perëndimore, dhe që aleancat të cilat një kohë kanë qenë të forta, të fuqishme, nuk janë më aq. Kjo duhet me qenë alarm për çdonjërin prej nesh. Dhe, këtu si në këto rrethana të reja mund ta definojmë ne ruajtjen e Pavarësisë sonë dhe avancimin e kësaj pavarësie. Kot është të

reagohet në çdo provokim të Republikës së Serbisë, jo “muri”, o një arrestim, jo tjetri, jo... paralajmërim për hapa unilateral për krijim të bashkësisë së komunave serbe... A bën ne të mos reagojmë, a mund ata të fillojnë të reagojnë për një agjendë, të cilën ne do ta krijojmë bashkë dhe ta aprovojmë në Kuvendin e Kosovës. Në qoftë se ne sot nuk arrijmë ta bëjmë një rezolutë të përbashkët, e cila e ruan këtë lloj minimumi të interesave tonë, atëherë sinqerisht, edhe sa seanca tjera të jashtëzakonshme për veprime të Serbisë do t’i thërrasim, e me konkluzione të njëjta, të vajtojmë apo ku ta di unë.

Kështu që, ju thërras edhe një herë të gjithëve, sot është momenti i fundit që ne të fillojmë një ridefinim të interesave tonë dhe nëse s’arrihet sot rezoluta e përbashkët, mundemi nesër, pasnesër... por, ne duhet të dalim prej një lloj inercioni, një lloj amullie dhe një lloj të kuptimit të botës ashtu siç e kemi pa ne në vitin 1999. Kurrgjë më nuk është e njëjtë si në vitin 1999. Në 2017-ën tjetër është perëndimi, tjetër është Rusia e tjetër është qasja e tyre e përbashkët ndaj Serbisë dhe tjetër është qasja e tyre ndaj nesh. Atëherë, ne të paktën, ta ruajmë vetën e të mos mbesim nëpër përralla e folklorizma, qysh ne një kohë kemi qenë shumë të afërt me shtetet perëndimore, sepse nëse për ne nuk kanë ndryshuar gjërat që 17 vjet, për botën, më besoni, që ka ndryshuar shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

ABDYL IMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Përderisa ne jemi mbledhur në këtë sallë, diku në qendra të paraburgimit të shtetit tonë mik, Francës, ende mbahet padrejtësisht një qytetar yni i respektuar, mbahet një ndër komandantët më të shquar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, një ish-kryeministër dhe ish-deputet, kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Haradinaj, i cili është arrestuar me porosi të Beogradi, nën akuzën e krimeve të luftës, që Beogradi ka ngritur kundër Haradinajt, vepra për të cilat ai është gjykuar dhe shpallur dy herë i pafajshëm nga Tribunali i Hagës.

Për të gjithë ne është e kuptueshme se Serbia, përkundër bisedimeve që zhvillon me Kosovën, prapëseprapë nuk mund ta pranojë realitetin e krijuar, se tanimë Kosova është shtet i pavarur dhe demokratik, por ajo me veprimet e saj po shfaqë urrejtjen dhe armiqësinë patologjike që ka ndaj shtetit të Kosovës. Dhe për këtë, nga Serbia dhe aleati i saj si kundërshtarët më të vendosur të shtetësisë së Kosovës edhe priten fletarrestime për komandantët dhe çlirimtarët tanë. Por, shtrohet pyetja se si ato shtete të cilat kontribuuan shumë dhe konsiderohen si bashkë çlirimtare me çlirimtarët tanë për lirinë dhe çlirimin e Kosovës, pse i zbatojnë ato vendime të Serbisë, të cilat kryekëput janë politike dhe bëhen me qëllime të caktuara për destabilizimin e vendit.

Rasti Haradinaj duhet të na i hapë sytë të gjithëve, sepse kjo nesër mund të trokasë në derë edhe të dikujt tjetër, por ajo që është shqetësuese dhe e pajustificueshme për mua dhe, besoj, edhe për

shumicën e qytetarëve, është tendenca e krijimit të njëfarë balance në mes të viktimës dhe agresorit e po ashtu, tendenca e eliminimit nga skena politike e atyre që dhanë kontribut të çmuar për lirinë e këtij vendi, që këto tendenca i shohim në gjykimet e mëhershme të grupit të Dukagjinit, grupit të Llapit dhe tani grupit të Drenicës.

Për ata që shohin mirë, Serbia është në ofensivë për t'i bërë sa më shumë obstrukcione dhe keq shtetit të Kosovës. Kudo që i jepet rasti dhe mundësia, ajo vazhdon të bëjë pengesa duke minuar dhe diskredituar autoritetin e Kosovës, vazhdon të kundërshtojë edhe përfshirjen e Kosovës në mekanizma ndërkombëtarë, brenda nate ngritë murin në veri te ura e Ibrit dhe arriti ta bëjë çështje debati dhe polemikash, kurse me problemin e murit e mbulojnë mbylljen e rrugës kryesore, e cila të çon në drejtim të Zveçanit dhe Leposaviqit. Zyrtarët e lartë serbë hyjnë e dalin dhe sillen si kapadainj në Kosovë. Paramendoni, i pari i vendit në Serbi na çon selam dhe na tregon për forcën që ka shteti serb, zyrtarë të lartë të Kosovës, më shumë konsultohen me institucionet e Beogradit se sa me institucionet e Kosovës.

Të gjitha këto bëhen për të ngritur tensione dhe për të provokuar situatën. Po cilat janë veprimet tona, çfarë kemi ndërmarrë ne, pse ne heshtim në situata të tilla? Apo, ne duhet të sillemi sikur asgjë nuk po ndodh këtu?!

Tani e tutje, duhet të ketë reciprocitet në çdo çështje. Pas rastit Haradinaj institucionet e Kosovës duhet ta rishikojnë seriozisht dialogun me palën serbe, duhet bërë një analizë të thellë bisedimeve që janë zhvilluar deri më tani, të dihet saktë se çfarë fitoi Kosova me këto bisedime apo cila është pozita e Kosovës sot pas këtyre bisedimeve.

Nga këto bisedime kemi një varg marrëveshjesh, të cilat në praktikë pothuajse nuk implementohen fare nga pala serbe, kurse nga ne kërkohet implementimi i tyre. Duhet listuar një nga një të gjitha vështirësitë dhe problemet, se përse nuk implementohen këto marrëveshje.

Për veten time, kur kam lexuar Marrëveshjen për Asociacionin, kam pyetur veten si është e mundur që një avion ekspertësh kanë udhëtuar për Bruksel dhe i ofrojnë kryeministrit të vendit një marrëveshje të tillë për nënshkrim dhe shpëtimi ynë ka qenë pika që për këtë marrëveshje të japë mendimin Gjykata Kushtetuese, e cila vërtetoi shkeljen e 23 neneve apo, siç kemi dëshirë të themi ne, 23 pika nuk janë në frymën kushtetuese.

Institucionet e Kosovës pas rastit Haradinaj duhet të rishikojnë formatin e bisedimeve me Serbinë, për shkak të qëndrimeve armiqësore të saj ndaj Kosovës. Bashkimit Evropian duhet bërë e qartë, se është e vështirë të vazhdohet me dialogun, përderisa Serbia synon të pengojë Kosovën në proceset integruese, sepse me marrëveshjen e parë Serbia është zotuar se nuk do ta pengojë Kosovën dhe as Kosova Serbinë në proceset e integritimit evropian. Nëse, patjetër duhet

të vazhdohet dialogu i Kosovë - Serbi, atëherë shfuqizimi i urdhër-arrestimeve të Prokurorisë serbe të vitit 2004 duhet të futet në agjendën e bisedimeve Kosovë - Serbi për vitin 2017.

Nëse, çështje të kësaj natyre nuk zgjidhen nëpërmjet këtij instrumenti të dialogut, atëherë menjëherë duhet të ndërpriten bisedimet, sepse nuk ka kuptim që të shkohet më tutje.

Unë konsideroj se është momenti i fundit, kur i gjithë spektri politik në Kosovë të ulen e të bashkëbisedojnë dhe t'i lënë mënjatë inatet dhe kapriciet e veta dhe të tregojnë leadership të guximshëm për të vepruar, në të njëjtën kohë të jenë unik dhe t'i harmonizojnë qëndrimet e tyre kur janë në pyetje çështjet nacionale, sepse pozita e Kosovës nuk është ajo që dëshirojnë qytetarët e saj, as në pikëpamje politike, as në pikëpamje ekonomike. Përderisa, ne vazhdojmë me atë logjikën primitive të kundërshtimit të luftimit të njëri-tjetrit, me logjikën e bajraktarizmit dhe të të parit të fisit, me ngritje dhe kundërshti të panevojshme në mes klasës sonë politike, për qëllime krejt të ngushta personale e klanore, me marrjen me vetveten, Serbia me politikën e saj destruktive po merret me Kosovën.

Kjo dikujt do t'i duket patetike, folkloriste e populliste, por nëse shikohet e kaluara jonë nëpër periudha të ndryshme historike, realiteti ynë sot pothuajse është i njëjtë me të kaluarën, që shumicën e kohës e shpenzojmë duke u marrë me vetveten. Do ta përfundoj përfundimin tim me thënien e Konicës, "Nëse jemi të bashkuar e pamundura bëhet e mundur, nëse jemi të ndarë e mundura bëhet e pamundur!. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Anton Quni e ka fjalën, le të përgatitet Lahi Brahimaj.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Në fillim do ta ndaj me ju një përvojë, që ka ndodhur menjëherë pas luftës, një muaj apo dy pas luftës, viti '99, kur një njësit i KFOR-it e arrestoi një pjesëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me tendencë që ushtarin ta transferonin nga një qytezë në një qytet tjetër. Bashkëluftëtarët e ushtarit u mobilizuan shpejt, po ashtu edhe një numër i madh i qytetarëve dhe bllokuan me mjete transporti, mjete pune, e të tjera... të gjitha hyrjet dhe daljet e qytetit. Pas disa minutash negociate në mes të një komandanti lokal të një komandanti lokal të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe komandantit të njësitit të KFOR-it, ushtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u lirua.

Pas disa vitesh, po i njëjti ushtar u arrestua në një shtet fqinj dhe u ekstradua në Serbi, ku edhe u dënua me 15 vjet burgim, sipas drejtësisë serbe për akte terroriste. Ai ende atje po e vuan dënimin. Ne në atë kohë nuk kishim shtet dhe instrumentet e saj detyruese. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte më unike, kishte mbështetje më të fuqishme tek qytetarët, por sidoqoftë edhe në

ato rrethana mekanizmat ndërkombëtarë në Kosovë ishin të kujdesshëm, që të mos shkaktojnë situata të pamenaxhueshme.

Sot e kemi një situatë ku Franca mund ta përfillë fletarrestimin e Serbisë, që zotin Ramush Haradinaj ta ekstradojë në Serbi nën akuzën për terrorizëm. Dhe, normalisht që kjo situatë shkakton debate, intervista, prononcime dhe protesta në përkrahje të zotit Haradinaj.

Jam i bindur që Qeveria po i ndërmer hapat e nevojshëm për lirim të zotit Haradinaj. Një interesim i madh rreth kësaj çështjeje është treguar edhe nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë. Jemi dëshmitarë po ashtu të deklarimeve dhe qëndrimeve kritike të euro-deputetëve ndaj organeve të drejtësisë franceze, por deri më tani asgjë konkrete nuk ka lëvizur, asgjë nuk ndikoi tek autoritetet frënge, që ta lirojnë zotin Haradinaj. Kjo sjellje na bën ne, me të drejtë, të pyesim pse? Dhe, përderisa nuk kemi përgjigje, atëherë ne na jepet mundësia të zhvillojmë imagjinatën, të ngremë teori të ndryshme konspiracioni të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar, të sulmojmë ku duhet dhe ku s' duhet, t'i acarojmë edhe më shumë raportet në mes vete, thjesht të humbasim busullën për gjykim të shëndoshë dhe real.

A është ky qëllimi i dikujt? Besoj se po! Besoj fuqishëm se ky është qëllimi i Serbisë. Mungesa e gjykimit të shëndoshë dhe mungesa e veprimeve racionale i krijon mundësi Serbisë për avantazh në diplomacinë dhe politikën ndërkombëtare.

Unë i lus të gjithë deputetët, zyrtarët e Qeverisë dhe të gjithë ata që merren me trajtimin e rastit të zotit Haradinaj, në qoftë se me të vërtetë e duan zotin Haradinaj të lirë në Kosovë, pranë familjes, pjesëmarrës në proceset politike, konkurrues në politikë, që së paku në këtë rast të tregojnë unitet, solidarizim dhe ndërmarrje të veprimeve politike dhe ligjore, por të gjitha këto të bashkërenduara mirë, në mbrojtje jo vetëm të zotit Haradinaj por në mbrojtje të të gjitha personaliteteve, që sulmohen dhe ndiqen nga Beogradi.

Sot ne kemi shtetin tonë, Kosovën, me të gjitha kapacitetet e saj dhe nuk kemi nevojë për ushtrimin e formave alternative, siç e ceka më lartë duke iu referuar rastit të ushtarit të arrestuar pas lufte. Lirimi i zotit Haradinaj duhet të cilësohet si fitore e jona e përbashkët dhe goditje e fortë shtetërore për të gjithë ata që ëndërrojnë me nostalgji regjimin e Serbisë.

Padyshim, se duhet të debatojmë edhe për shumë dilema që u ngritën, pikëpyetje të tjera për të cilat u debatua edhe më herët, edhe për komplete dhe për mashtrime, edhe për përgjegjësinë e çdo qeverie, për shërbimet sekrete, për vrasjet politike, instalimin e krimit dhe korrupsionit e shumë e shumë çështje të tjera. Është mirë që për çdonjërin shqetësim të debatojmë veç e veç, por jo sot, jo sot, jo në këtë rast. Sot, ne kemi mundësinë të tregojmë se karshi sulmeve të Serbisë ne jemi unikë, të guximshëm, mirënjohës që kemi miq dhe se perspektiva jonë është e pandalshme. Mendoj, se sot më shumë se kurrë, ne duhet t'i tregojmë Serbisë me maturi e

pjekuri politike, se ka perënduar një herë e përgjithmonë koha, kur ajo na ndarë e përçarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lahi Brahimaj e ka fjalën.

LAHI BRAHIMAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Ju kolegë deputetë dhe qeveri e dështuar,

Sa po flasim këtu për të njëjtin problem, për arrestimin e njerëzve të Kosovës, po flasim për të njëjtën temë, sepse ju keni dështuar që këto raste të mos përsëriten. Ramushi është arrestuar në Slloveni e ju heshtët, heshtët me vepra dhe pasi u lirua ai heshtët, sepse nuk jeni në gjendje të bëni asgjë për të argumentuar se ato fletarrestime janë kryekëput të drejtuara ndaj shqiptarëve, vetëm pse janë shqiptarë.

Ju si Qeveri dolët dhe me një qëndrim me numra se sa janë në lista të Interpolit, mirëpo shumë... dikush po thotë se janë mbi 100, dikush po thotë se janë më pak se 20. Unë si deputet, por edhe zoti Haradinaj do t'i gëzohet heqjes nga kjo listë e çdo ushtari të UÇK-së. Por, po duket se heqja e këtyre emrave po bëhet në mënyrë selektive dhe qartë po shihet. Fillimisht, më duhet të pyes, edhe pse dorën në zemër s'ke kujt t'ia drejtosh këtë pyetje, e keni ditur se pjesë e këtyre listave me emra është edhe zoti Ramush Haradinaj. Nëse e keni ditur, pse nuk e keni njoftuar apo e keni njoftuar ndonjërin prej këtyre 20 emrave, që vetë po thoni se janë në lista.

Ramushi u ndalua tani edhe në Francë dhe tek pasi që ndodhi kjo, u ngritën dhe po përsëriten të njëjtat argumente. Është vështirë të besohet, se sikur herëve të tjera, edhe kësaj here, disa që derdhin lot krokodili neglizhojnë qëllimisht punën. Kjo ishte edhe kur seanca u ftua për të shtunën dhe e shtyrët për sot, derisa të kalojnë Krishtlindjet apo bozhiqët e serbëve. Ju hidheni përpjetë vetëm atëherë kur ndodhin fyerjet, padrejtësitë, poshtërimet ndaj shtetit tonë dhe na lodhni me justifikime se sa punë po bëni. Nuk ju beson askush më këtyre deklaratave të thata dhe pa shije, se janë e po bëhet krejt çfarë është e mundshme, bile ministri na tha se po punojmë edhe nga 12-13 orë në ditë, për të na treguar se sa shumë po u dhimbset Ramushi për konsum të brendshëm dhe sa po punojnë për ta liruar atë.

Ta themi hapur, se ndaj Ramushit janë çuar në këmbë e tërë Serbia, e tha edhe kryeministri, e tha edhe kryeprokurori, se përderisa të jetë gjallë Serbia dhe institucionet e sigurisë së saj, Ramush Haradinajn nuk do ta lënë të lirë. E kuptueshme dhe e pritshme kjo, por është shumë e papritshme, se si edhe në Kosovë dikujt po i pengon bukur shumë përkushtimi, qëndrimi dhe kontributi i zotit Haradinaj për Kosovën, për shtetin dhe vlerat e këtij shteti. Nëse ju kërkoni që t'i shtimë minat shtetit tonë e të ndërtojmë një të ardhme paqësore mbi themelet e një asociacioni antikushetues, demarkacionit që ia zvogëlon territorin shtetit tonë, rrjedhimisht duke lejuar

murin që legalizon ndarjen dhe dezintegron Kosovën, dijeni se keni hyrë në rrugë të gabuar dhe është e gjykuar të dështojë.

Rrugë e ndarjes dhe jo e funksionalitetit të Kosovës nuk mund të zgjidhet kurrë pa zotin Ramush Haradinaj e këtë ju po e dini fort mirë. E pra, kujt po i pengon rruga e mundimshme jetësore dhe veprat e vazhdueshme në shërbim të lirisë, pavarësisë dhe konsolidimit e përparimit të shtetit të Kosovës, që dëshmoi në vazhdimësi zoti Ramush Haradinaj. Pse, ju që e keni plot gojën reciprocitet, s'po merrni masa reciproke ndaj serbëve që kanë bërë krime në Kosovë? Përkundrazi, ju po sillni në Kosovë me konvoje. Tha se e ndaluam Nikoliqin, po sillte një konvoj me serbë në Gjakovë, të nesërmen në krye, kinse me nënat serbe që kanë ardhur në Kishë, në atë ekip ishte edhe Gjokica Stojanoviqi, kur dihet kush ka qenë ai. Dhe, kur dolën nënat gjakovare për të protestuar, ju ato i maltretuat, i rrahët dhe i burgosët.

Qe pesëmbëdhjetë vjet, rreth pesëmbëdhjetë vjet mbahet në burg Anton Leka - Binço dhe asnjëherë asgjë Qeveria e Kosovës nuk bëri. Jam i vetëdijshëm se këto pyetje që po i bëj, nuk i dua sot as përgjigjet, sepse e di mirë që përgjigjet i dinë të gjithë ata që me qëllim apo pa qëllim, po bëjnë punën e dreqit këtu në Kosovë. Një dijeni, se kungulli mbi ujë nuk shkon gjithherë dhe ka filluar t'u fundoset. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, me kërkesën tuaj po shkojmë një orë në pauzë. Kush s'ka ngrënë drekë le të hajë...

\* \* \*



*Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Atëherë, po fillojmë! Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Është vërtet e dhembshme dhe e turpshme sa për ne, po aq edhe për Evropën që ne sot duhet të mblidhemi për të reaguar për arrestimin e zotit Haradinaj, arrestim i cili është bërë mbi akuzat, të cilat dy herë janë hedhur poshtë nga Gjykata e Hagës, por, si duket ende kanë relevancë për shtetet të cilat e kanë njohur pavarësinë e vendit tonë.

Me këtë rast nuk dua t'i akuzoj autoritetet franceze, të cilat thjesht e kanë kryer një urdhër, për të cilin ato i obligon marrëveshja e shtetit të tyre me Interpolin, por dua t'i akuzoj të gjithë ata, të cilët në një mënyrë apo tjetër ishin dhe janë ende të involvuar në zgjidhje të problemeve tona me shtetin e Serbisë.

Edhe kaq vjet pas luftës shihet se problemet esenciale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shtetit serb jo që nuk janë zgjidhur, por as që kanë pasur vullnet të zgjidhen.

Vendi ynë gjatë gjithë kohës, në çdo proces, ka hyrë i gatshëm të kontribuojë në stabilizimin e rajonit, shpesh duke e harruar edhe të kaluarën e vet përplot vuajtje e dhembje, shpesh duke bërë kompromise nga më të dhembshmet, dhe nga të gjitha këto procese ne i kemi këto rezultate të cilat dje, sot dhe pa dyshim edhe nesër do të na mbledhin në seanca të jashtëzakonshme dhe në nxjerrje të rezolutave, të cilat deri sot pak po merren parasys.

Diçka që më ka rënë në sy ditëve të fundit, ishin prononcimet tepër të njëanshme të disa personave, të cilët çdo situatë synojnë ta kthejnë në fushatë zgjedhore. Kjo sjellje më ka irrituar tej mase jo vetëm mua, por besoj edhe shumë qytetarë të vendit tonë dhe pa dashur të etiketoj askënd me emër, dua të bëj të qartë qëndrimin tim se autoritetet franceze nuk e kanë arrestuar kryetarin e një partie politike në Kosovë, nuk e kanë arrestuar një ish-kryeministër, por ata e kanë arrestuar një pjesëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ata e arrestuan një gjeneral që jetën e tij e bëri mburojë për jetën tonë.

Arrestimi i Ramush Haradinajt nuk është i pari dhe, për fat të keq, nuk besoj se do të jetë arrestimi i fundit i djemve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ne i kemi burgjet tona plot me ushtarë e komandantë të UÇK-së, të cilët qenë subjekte të gjyqeve të turpshme në mes të Kosovës, gjyqe që ndodhën para syve tanë dhe ne si shoqëri dështuam në mbrojtjen e tyre.

Shtrohet pyetja pse? Sepse brenda dhe jashtë vendit tonë ata ishin dhe janë pre e përndjekjeve dhe e politikave të caktuara, të cilat nuk ndodhin asnjëherë pa një qëllim konkret.

Krejt çka bëjmë është se ne rrimë duarkryq duke e akuzuar njëri-tjetrin se qenkemi folkloristë po qe se mbrojmë vlerat e UÇK-së dhe se jemi demode nëse flasim për luftën dhe sakrificën e kombit tonë.

Ne rrimë dhe ngushëllohem me përkëdhelje krahësh dhe me 'selfie' nga pritjet e ambasadave të huaja, duke dashur të transmetojmë në opinion një imazh të pranuar nga ndërkombëtarët.

Ne ende nuk e kemi kuptuar se duhet ta respektojmë veten për të pasur respektin e të tjerëve. Ne si popull u bëmë pjesë e përndjekjes së vlerave të UÇK-së, qoftë drejtpërdrejt, qoftë tërthorazi. Pa pasur aspak frikë se mund të tingëllojë patetike, them se ne vetë e shkelëm këtë vlerë, e cila na dha emër e krenari dhe falë të cilës ne jetojmë të lirë.

Të nderuar kolegë,

Edhe ne i kontribuam këtij procesi të përndjekjes së tyre. Kur e them këtë, e kam parasysh neglizhencën e arritjes së një mbrojtjeje institucionale në të mirë për vlerat e luftës. E kam parasysh heshtjen tonë në tavolina të vendimmarrjes. E kam parasysh heshtjen tonë përballë kampanjave kundër tyre. E kam parasysh gjunjëzimin e Kuvendit para Gjykatës Speciale kundër këtyre vlerave.

Pra, kujt duam t'ia drejtojmë gishtin me këtë seancë? Ne duhet të mendojmë dhe përfundimisht të pozicionohemi pro apo kundër këtyre vlerave, për të cilat nuk do të duhej të ekzistonte pazar personal.

Të vetëm, asnjëri s'e kemi fuqinë për të parandaluar këtë tendencë për zhvlerësimin e luftës sonë, por jam e bindur se bashkë e kemi dhe duhet ta shfrytëzojmë në formën më të prerë.

Unë sot, dua të kërkoj nga secili që është përgjegjës:

- Që të përpilohen listat me kriminelët e vërtetë serbë, të cilët dihen me emër e mbiemër dhe të ngritën aktakuza ndaj tyre.
- Të mos reagohet, por të hartohen politika proaktive, të cilat parandalojnë veprimet në dëm të vendit tonë.
- Të ristrukturohet dialogu me Serbinë dhe të mos vazhdohet më në formën aktuale.
- Të shkohet në bisedime me kërkesa strikte.

- Para dhe pas çdo takimi në Bruksel, ekipi i bisedimeve të raportojë para Kuvendit e të mos befasohe mi, siç u befasuam me murin në Mitrovicë.

Në fund fare, duke uruar që zoti Haradinaj t'i kthehet familjes dhe shtetit të Kosovës, dua të them edhe një herë: Faleminderit, UÇK, ju do të jeni histori e pavdekshme, përderisa ne do të përgjigjemi para historisë një ditë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Në Tribunalin e Hagës zoti Ramush Haradinaj, pasi la postin e kryeministrit të vendit, dëshmoi pafajësinë e tij, mbrojti me dinjitet luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe pasqyroi në mënyrën më besnike kauzën e popullit të Kosovës në luftën për liri dhe aspiratat për një shtet të lirë dhe demokratik, të barabartë në familjen e madhe evropiane.

Të gjitha këto zoti Haradinaj i bëri me vetëdije të lartë kombëtare në emër të Kosovës. Ai ishte i bindur thellë se ditët më të mira do të vijnë, pavarësisht sakrificave sublime të familjes së tij dhe të atij personale.

Zoti Haradinaj e vendosi veten e tij në dispozicion të lirisë e demokracisë si vlera universale të njerëzimit, duke mos kalkuluar për asnjë moment në veten, por gjithnjë i gatshëm për të sendërtuar këto vlera në funksion të një të ardhmeje më të sigurt për të gjithë ne.

Fatkeqësisht, veprimi i autoriteteve franceze, sido që të ketë ndodhur, është kryekëput politik dhe si i tillë, për ne i papranueshëm.

Veprimet e tilla nuk i kontribuojnë paqes dhe stabilitetit, edhe ashtu të brishtë në Kosovë, për të cilat zoti Haradinaj po punon me gjithë forcën dhe qenien e tij.

Ndalimi, pra, i zotit Haradinaj në Francë është i papranueshëm për faktin sepse, para se gjithash, është i padrejtë dhe si i tillë nuk e ndihmon integrimin e pakicave në Kosovë, në veçanti të pakicës serbe.

Këto veprime përkitazi nxisin tensione të reja, duke provokuar seriozisht situata të pakëndshme në regjion. Ky veprim është një abuzim i rëndë i Serbisë me vlerat demokratike evropiane nëpërmes Interpolit.

Prandaj, autoritetet franceze gabuan rënd në ndalimin e zotit Haradinaj.

Është për t'u habitur fakti dhe krejt i pabesueshëm se zoti Haradinaj u ndalua në një shtet, siç është Franca, shtet i cili zbatoi urdhrat për fletarrestime të një shteti agresor dhe diktatorial, siç është Serbia e Milosheviqit dhe pasuesve të tij të tanishëm, shtet të cilin Franca e luftoi në kuadër të Aleancës së NATO-s plot 72 ditë, duke e ndihmuar lirinë e një populli që vdiste nga makineria vrastare e Beogradit.

Këtu, të nderuar kolegë deputetë, qëndron absurdi i llojit të vet se si është e mundshme një gjë e tillë të ndodhë në një shtet, pra, siç është Franca, në këtë rast. Andaj, gabimi është tepër i rëndë.

Ndërsa, edhe më absurd dhe më i papranueshëm është reagimi i zbehtë i institucioneve të Kosovës, i presidentit të kontrabanduar, i cili tanimë është edhe zëdhënës i agjencive turistike të Kosovës që na tregoi se një biletë kushton 500 dollarë për të shkuar në Amerikë.

Por, nuk është vetëm kjo ironia që vetëm ai di ta bëjë, por është edhe e kryeministrit, i cili reagimin e tij, pra me një zë të mekur, e bëri në një takim të Qeverisë, të cilën e thirri jo me urgjencë, por si të zakonshme, me pika të tjera të rendit të ditës.

Jo, të nderuar deputetë. Kjo, pra, është në asgjë. Kjo është, në fakt, vetëm ajo që di të bëjë Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në Francë policia franceze ndaloi një lider politik me pasaportë diplomatike, një ish-kryeministër të vendit, prandaj në Francë francezët ndaluan Republikën e Kosovës, as më pak e as më shumë.

Për këtë arsye, edhe reagimi apo "shqetësimi" i Qeverisë është i barabartë me zero.

Andaj, ne kërkojmë me ngulm që Qeveria e Republikës së Kosovës të ndalojë procesin e dialogut me Serbinë jo vetëm deri në lirim të zotit Haradinaj, por deri në tërheqjen e plotë të fletarrestimeve ndërkombëtare për të gjithë pjesëtarët e UÇK-së.

Pra, kërkojmë nga drejtësia franceze reflektim të menjëhershëm dhe qasje të drejtë me rastin e zotit Haradinaj.

Ramushi duhet të lirohet! Këtë e thotë Kosova shtëpi më shtëpi. Këtë e thotë diaspora kudo, në Evropë, Amerikë dhe gjetiu.

Ndërsa, Bashkimi Evropian, Brukseli zyrtar, është e pakuptimtë të shtyjë përpara procesin e dialogut në mes të Kosovës e Serbisë përderisa kjo e fundit Kosovën e sheh edhe me kushtetutë si njësi të veten. Dhe, nuk e di Qeveria e Republikës së Kosovës çfarë kërkon më tutje.

Por, çka të bëjmë ne si Kuvend? Sot po debatojmë dhe në fund të nxjerrim një dokument, një rezolutë, për çka kemi përvojë shumëvjeçare të këtij Kuvendi dhe të kuvendeve të mëparshme kur kemi nxjerrë rezoluta, kemi nxjerrë dokumente të Kuvendit, të cilat asnjëherë nuk janë respektuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në vitin 2012 ky Kuvend nxori një rezolutë, e ndër pikat e asaj rezolute, një e para, e obligonte Qeverinë e Republikës së Kosovës që të kushtëzojë vazhdimin e bisedimeve deri në zbardhjen e fatit të të zhdukurit të fundit në luftën në Kosovë.

Por, këtë asnjëherë nuk e bëri dhe asnjëherë nuk u interesua për të vendosur këtë temë në bisedimet që vazhdoi t'i bënte.

Pra, sot po flasim për një temë shumë të ndjeshme, po flet Kosova dhe po flet çdo qytetar, por çfarë po bën Qeveria e Republikës së Kosovës?

Po flet se si gjoja e ndaloj vizitën e Nikoliqit në Kosovë. Por, në Kosovë kanë hyrë Nikoliqë, Daçiqë, e shumë e shumë serbë të tjerë, zyrtarë dhe jozyrtarë, në rrugë legale e ilegale dhe asnjëherë Qeveria e Republikës nuk ishte në vendin e duhur dhe asnjëherë s'e ngriti zërin për t'u thënë: "Ndall!". Për të nxjerrë një vendim dhe për të ndaluar njëherë e përgjithmonë çfarëdo vizite, të cilitdo zyrtar qoftë që vjen nga Serbia agresore.

Ndodhin edhe vizita, të cilat tentojnë gjëja të bëjnë vizita në institucione të Kosovës, siç ishte edhe rasti i fundit në manastirin në Gjakovë. Por ngritët edhe zëri për thyerjen e një xhami të një autobusi, përderisa brenda atij autobusi kishte edhe kriminelë me emër e mbiemër.

Kjo është më shumë se sa e patolerueshme, prandaj kush duhet ta ngrëjë zërin? Kush duhet të tregojë edhe një herë se është zot në shtëpinë e vet?

Fatkeqësisht këto institucione tona, në mënyrën se si kanë ardhur, po tregojnë edhe një herë se janë shumë joserioze dhe shumë jo të besueshme për të udhëhequr vendin, andaj vërtet rasti i zotit Haradinaj është një rast për të cilin qytetarët po e ngritin zërin. Ata e ngritën zërin edhe për shkarkimin e Jablanoviqit, për të cilin e detyruan kryeministrin Mustafë që ta shkarkojë, jo pse deshi ai, sepse ai nuk bëri asgjë.

Sot është momenti i fundit që Kuvendi jo vetëm të nxjerrë unanimisht një rezolutë, por të jetë mbikëqyrës me afat ditor për zbatimin e rezolutave, të cilat asnjëherë nuk u zbatuan nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Prandaj, deputetë të nderuar, t'i lëmë të gjitha inatet, inatet të cilat nuk do të duhej të ndodhnin nga institucionet, e aq më tepër nga përgjegjësit kryesorë, siç është, pra, kryetari i shtetit, zoti Thaçi, në mënyrën më injorante që veç ai di ta bëjë.

Por, po flitet për një njeri që më së paku ka nevojë ai sot të flitet në Kuvend se kush është zoti Haradinaj. Flet historia, flasin gjeneratat. Sot ne duhet të marrim një vendim dhe të mos hezitojmë, por një vendim të prerë dhe të tregojmë se vërtet jemi shtet dhe vërtet jemi një Kuvend i Republikës së Kosovës për mundin dhe sakrificën e të gjithë atyre që e sollën lirinë, dhe jo si zoti kryeministër Mustafa, i cili nuk i përkrahu në asnjë moment dhe historia tregon se asnjëherë s'ka qenë përkrahës, por të marrë guximin dhe një herë të jetë i përgjegjshëm në detyrën të cilën e ka marrë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhi Shala e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

E nderuar familje Haradinaj,

Sot në këtë seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës dëgjova ministra dhe deputetë, të cilët akuzojnë me të drejtë Serbinë se është duke zhvilluar një politikë agresive ndaj shtetit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Dua t'ju them se Serbia gjithë angazhimin e saj është duke e bërë që Kosova të jetë një shtet jofunksional, sepse ajo nuk po arrin të pranojë faktin se është humbëse e luftës së fundit në Ballkan.

Mirëpo, shtrohet pyetja: çka jemi duke bërë ne për Kosovën, që të jetë sa më funksionale? Kur ne edhe si deputetë, edhe si Qeveri nuk njohim ende vlerat tona kombëtare, luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për të cilën më shumë na e vlerëson bota se sa e vlerësojmë vetë ne.

Çdo ditë dëgjoj nga deputetët, ministrat dhe analistë të pavarur e të politizuar duke akuzuar komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ajo që është më e keqja, nga ky Parlament, institucioni më i lartë i vendit, kur është votuar krijimi i Gjykatës Speciale, e cila do t'i gjykonte vlerat tona më sublime, luftën e pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Mirëpo, një dua t'ua them të gjithëve, se po të mos ishte lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku do të ishit ju, deputetë, ministra e ju kryeministra? Do të ishit në Gjermani, e ju analistë, të cilët shfrytëzuan bursa të ndryshme dhe u shkolluat jashtë. Asnjëherë nuk dëgjova nga ju së paku për t'i falënderuar ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët ua mundësuan së paku të flisni lirshëm, por jo edhe të shani e të përluni vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse pa respektimin e këtyre vlerave, as bashkësia ndërkombëtare nuk do të na respektojë si shtet, prandaj për këtë arsye edhe sot arrestimi i gjeneralit Haradinaj nuk është i rastësishëm.

Kur them kështu, kam arsye, sepse edhe presidenti ynë, udhëheqësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili si sukses të vetëm si kryeministër numëronte bisedimet e filluara nga vetë ai dhe të mbështetura nga Partia Demokratike dhe këtë sukses po e vazhdon kryeministri i tanishëm Mustafa dhe partia e tij, bashkë me Listën serbe, të cilat bisedime, dëgjova nga shumë deputetë të dy taborëve, pozitë dhe opozitë, se duhet të ndërpriten, sepse kanë qenë bisedime të dëmshme për vendin.

Kërkoj nga ju, të nderuar deputetë, të deklaroheni për përgjegjësitë që i kanë pasur kryeministrat tanë, për dëmet që i janë sjellë vendit tonë, duke filluar nga falja e territorit, duke krijuar asociacionin, duke ndërtuar mure për ndarje të vendit, duke arrestuar çdo ditë edhe qytetarët tanë në Serbi dhe kudo në Evropë.

Në agjendën e presidentit tonë asnjëherë nuk ka ekzistuar së paku një takim formal me të gjithë liderët e partive politike që të diskutohet pozita e Kosovës karshi Serbisë dhe bashkësisë ndërkombëtare. Por çdo ditë shohim vizitat e tij nëpër varrezat e kriminelëve serbë dhe njëkohësisht dëgjojmë deklarata të tij se gjoja janë vrarë shumë dëshmitarë që kanë qenë kundër komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Të njëjtat deklarata i kemi dëgjuar edhe nga prokurorët dhe politikanët serbë.

Prandaj, po e theksoj edhe një herë se arrestimi i gjeneral Haradinajt nuk është i rastësishëm mu në një shtet të Bashkimit Evropian, siç është Franca. Pa shumë deklarata të politikanëve tanë, të cilat kanë akuzuar çdoherë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe komandantët e tyre, edhe këto vende të cilat sot veprojnë karshi programeve, të cilat i kanë kultivuar nga Serbia ose aktakuzat të cilat janë prodhuar nga shteti serb, mund të themi se edhe ne, edhe politika jonë, edhe shteti ynë, edhe Qeveria jonë nuk kanë bërë asgjë që sot komandantët tanë, lufta jonë të mos shahet, të mos burgosen njerëzit e Ushtrisë Çlirimtare.

Andaj, kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të ndërpriten bisedimet, të fillojë të merret më seriozisht me vlerat e vendit tonë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Mytahir Haskuka e ka fjalën.

**MYTAHIR HASKUKA:** Të nderuar deputetë e deputete,  
Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Arrestimi dhe mbajtja në paraburgim i Ramush Haradinajt është për dënim, nga se bazohet në fletarrestim të agresorit, pra të Serbisë dhe nuk është e pranueshme për një shtet me vlera demokratike, siç është Franca. Posaçërisht, nëse kemi parasysh se arresti bazohet nga viti 2004, periudhë pas Milosheviqit dhe del se fletarrestimi bazohet në regjimin e Milosheviqit.

Po a duhet ne të dënojmë vetëm Francën, apo vetëm Serbinë, ose fajet i kemi edhe ne, apo mospuna e institucioneve të Kosovës dhe papërgjegjësia e qeverive të deritanishme të Kosovës?

Ku është e vërteta? Sot Serbia i ka më shumë se 150 fletarrestime për shqiptarët, me dosje të përfunduara, të cilat i ka dorëzuar në Interpol.

Unë pyes Qeverinë, pyes prokurorinë dhe gjykatat: a ka dorëzuar Kosova ndonjë fletarrestim në Interpol për kriminelët serbë për krimet e kryera në Kosovë? A ka ndonjë dosje me të gjitha krimet dhe për personat që kanë kryer krime në Kosovë, dhe ku është prokuroria jonë lidhur me këtë?

Nëse shikojmë ‘ueb-saitet’, unë sot bëra një hulumtim të shpejtë në “Google” lidhur me krimet e luftës dhe nëse shikojmë numrin e ‘ueb-faqeve’, të cilat flasin për krimet e luftës në Kosovë, më shumë dalin ‘ueb-faqe’ të Serbisë, të cilat flasin për krime të luftës të kryera “ndaj serbëve në Kosovë” se sa ndaj shqiptarëve.

Mirëpo, ne i dimë statistikën. Ne e dimë se çfarë ka ndodhur në Kosovë dhe dimë se në kohën e Milosheviqit, përveç që është shkatërruar ekonomia pas vitit 1990, më shumë se 150 000 shtëpi u dogjën, 12 000 persona u vranë, me mijëra të tjerë u dhunuan, 1 000 000 njerëz u detyruan t’i braktisin shtëpitë e tyre dhe të shkojnë në Maqedoni, Shqipëri dhe vende të tjera.

Por, sot, nëse dikush bën hulumtim për krime të luftës të kryera në Kosovë, nga njëra prej faqeve që referohen njerëzit në gjithë botën, e që është Wikipedia, del faqja e përmbajtjes dhe kjo faqe fillon me krimet e luftës së shqiptarëve në Kosovë. Do të thotë, së pari fillon me krimet e shqiptarëve në luftë, me 17 pika, dhe pastaj me krimet e ushtrisë jugosllave. Do të thotë, nuk janë krimet e Republikës së Serbisë dhe as krimet e Serbisë, por krimet e Jugosllavisë, kurse tash Jugosllavia nuk ekziston më dhe, në njëfarë aspekti, është ndarë ajo periudhë dhe këtu i kemi vetëm 5 nëntituj dhe nga këta 5 nëntituj, nëse i krahasojmë dhe i lexon dikush që nuk ka jetuar në Kosovë dhe nuk e di se çfarë ka ndodhur në Kosovë dhe nuk i ka dëgjuar lajmet nga viti 1999, del përshtypja se shqiptarët kanë bërë pastrime etnike, i kanë vranë serbët, pra del e kundërta.

Tash, pse po ndodhë kjo? Po ndodh për shkak të mosangazhimit tonë. Do të thotë, pikësëpari për mospunën e institucioneve përkatëse, të cilat nuk kanë bërë asgjë lidhur me persekutimin e krimeve të luftës në Kosovë.

Unë edhe gjatë fjalimit tim për policin Nehat Thaçi pata marrë disa statistika, por që nga fillimi i vitit 1999, domethënë kur kanë filluar punën institucionet e përkohshme të qeverisjes dhe UNMIK-u. Sipas shifrave, ata kanë evidentuar diku rreth 1187 vepra të dyshuara të krimeve të luftës, të cilat ndërliken me masakra të ndryshme, të cilat kanë ndodhur në vende të ndryshme të Kosovës.



Por, nga këto 1187 vepra të dyshuara të krimeve të luftës, vetëm 50 raste janë shqyrtuar nga UNMIK-u, nga EULEX-si, nga institucionet e Kosovës, kjo është më pak se 5% të rasteve të krimeve të luftës që i ka kryer Serbia në Kosovë. Çka mund të presim prej ndërkombëtarëve kur nuk e bëjmë punën tonë vetë? Domethënë, 17 vjet pas luftës gjithmonë flitet për krimet e luftës dhe kriminelët serbë dhe asnjë dosje nuk bëhet gati.

Ne kemi masakra të ndryshme, të cilët kanë ndodhur, dihen emrat dhe mbiemrat e personave ose policëve serbë dhe ushtarakëve serbë, të cilët i kanë kryer këto krime dhe nuk ka asnjë dosje në prokurori për këto krime. Tash ne nëse nuk i bëjmë punët tona të shtëpisë dhe nëse nuk e mbrojmë veten, atëherë normalisht që Serbia i bënë edhe dëshmitë e falsifikuara, i bënë këto për ta paraqitur të vërtetën e saj ose gënjeshtret e saj lidhur me Kosovën. Si thashë, nëse i shikojmë tash 'web sajtet' në gjuhën angleze, e vërteta e Serbisë po e kalon të vërtetën e Kosovës, ose gënjeshtret e Serbisë po i kalojnë të vërtetat e Kosovës.

Edhe në atë aspekt unë me të vërtetë edhe një herë dua ta thërras Qeverinë që në vend se të solidarizohet, në vend se të tregojë keqardhjen, të fillojë të punojë, ashtu t'i dokumentojë të gjitha rastet e krimeve të luftës që Serbia i ka kryer në Kosovë, por jo vetëm gjatë '98-'99-ës, por edhe para asaj, se krimet e Serbisë në Kosovë fillojnë prej vitit 1912.

Edhe ne duhet të tregojmë këtë të vërtetë, normalisht, siç thashë, Franca e mban Ramush Haradinajn në paraburgim ngase po krijohet një opinion publik botëror që edhe shqiptarët paskan kryer krime, edhe shqiptarët domethënë ....

Edhe, në atë aspekt, të mos e zgjas, por dua t'ua tërheq edhe një herë vërejtjen kolegëve të mi, domethënë arrestimi i Ramush Haradinajt nuk mund të ndahet nga ndërtimi i murit në Mitrovicë, nga kolonilizimi që po bëhet në Luginën e Diellit, nga hekurudha Beograd - Mitrovicë, nga imponimi i Asociacionit të komunave serbe në Kosovë. Të gjitha këto po bëhen bashkërisht, në mënyrë që të na merret edhe ajo pak shtetësi që e kemi nëpërmjet instrumenteve të Serbisë në Kosovë.

Prandaj, unë besoj që me të gjitha këto që po ndodhin, duhet të vetëdijesohemi me të vërtetë dhe të fillojmë të punojmë për të mirën e këtij vendi dhe të mundohemi të rregullojmë edhe imazhin, domethënë jo imazhin, por të tregojmë të vërtetat e Kosovës, edhe atë çka ka hequr populli ynë, në mënyrë që të mos ndodhin këto padrejtësi në të ardhmen, nga se shumë shpejt e harruam atë çka na ndodhi në vitet 1998-'99. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Labinotë Demi-Murtezi.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!  
I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që edhe unë të shpreh indinjatën time për arrestimin e zotit Haradinaj bazuar në një fletarrestim të lëshuar nga Serbia.

Ky akt nuk ka koment, nuk ka asnjë lloj arsyeshmërie ndaj zotit Haradinaj, si qytetar i Kosovës, si lider partiak, si ish-kryeministër i vendit si dhe ndaj Kosovës si shtet i pavarur.

Andaj ajo çfarë ne presim dhe për çka jemi të gjithë sot këtu është lirimi sa më i shpejtë i tij. Sot më shumë se kurrë Kosova me delegacionin e saj në bisedimet me Serbinë duhet të rishikojë dhe t'i rishqyrtojë të gjithë hapat e arritur dhe të ngecur në këto bisedime.

Duke ditur faktin se zoti Haradinaj është shpallur i pafajshëm edhe nga Gjykata e Hagës, në anën tjetër, duke i pasur ende të freskëta ndjesitë e dhunës dhe gjenocidit që Serbia i bëri popullit të Kosovës, kam frikë se në të ardhmen, kur ne një ditë do të kemi mundësinë e lëvizjes së lirë në vendet e Bashkimit Evropian, do të mund të arrestohemi ndoshta edhe vetëm pse e urrejmë Serbinë, përkatësisht politikën e saj karshi Kosovës.

U thanë shumë për këto arrestime, për këtë arrestim, për këto raste që po përsëriten, nuk dua të përsëris të tjera, vetëm të them se sot të gjithë ne jemi në përkrahje të zotit Ramush Haradinaj dhe familjes së tij, familje e cila është simbol i luftës për liri dhe për shtetndërtimin e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Veton Berisha.

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar familje Haradinaj,

Sot jemi në një seancë, e cila nuk është e para e llojit të tillë. Arrestimi i fundit me fletarrestim të lëshuar nga Serbia në vitin 2004 ndaj një çlirimtari, siç është gjenerali Ramush Haradinaj. Ky arrestim është një goditje për gjithë popullin e Kosovës që shtetin e Kosovës e njohin si shtet të tyre pa dallim etnie, në këtë rast, është goditje edhe për komunitetin egjiptian të Kosovës.

Zonja dhe zotërinj,

Arrestimi i zotit Haradinaj me fletarrestim nga shteti fqinj serb është vetëm një provokim ndaj lirisë dhe të jetuarit të lirë në Kosovë. Kjo nuk e zbeh lirinë dhe të jetuarit e lirë në Kosovë, përkundrazi e forcon dhe e bën shumë më të fortë dhe duke qenë më gardian i pavarësisë së Kosovës.

Unë si një përfaqësues prej komuniteteve joshumicë në Kosovë, ndër më të mëdhatë në Kosovë, atij egjiptian, nuk e mora rastësisht fjalën, por duke gjetur edhe momentin për të shprehur indinjatën e thellë edhe të komunitetit tonë ndaj veprimeve të tilla të Serbisë.

Edhe ne si komunitet ishim viktimë e dhunës, presionit dhe krimeve të Serbisë dhe aq më tepër viktimë e dyfishtë e kryekriminelit Slobodan Milosheviq, i cili përpos që nuk na kurseu nga veprimet e tij kriminale, ai luajti edhe një rol shumë më të egër shkatërrues dhe të futjes së urrejtjes, duke detyruar dhunshëm njerëz, individ, intelektual të komunitetit të asaj kohe, duke përdorur edhe masa të dhunshme ndaj tyre dhe familjeve të tyre, nga të gjitha komunitet pakicë në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetin egjiptian, por duke mos përjashtuar as individ të komunitetit shqiptar.

Në këtë formë ai tentoi të krijojë fakte të rrejshme kundër vullnetit të përgjithshëm para faktorit ndërkombëtar të asaj kohe të viteve 1998-1999, duke rreshtuar dhunshëm ai krijoi delegacione fiktive, siç ishte ai i Rambujesë në Francë dhe u mundua të krijojë përshtypje ndërkombëtare se kinse të gjithë popujt në Kosovë janë në anën e Serbisë, ndërsa e vërteta ishte krejt ndryshe. Se komuniteti im egjiptian dhe djemtë më të mirë të asaj kohe ishin të rreshtuar nën komandën e komandantit të atëhershëm dhe tani i arrestuar, zotit Ramush Haradinaj dhe komandantëve të tjerë në zona të tjera.

Ndërsa, pjesa tjetër dërmuese ishin të larguar dhunshëm nga Kosova bashkë me qytetarë të tjerë nga forca paramilitare serbe, kurse pjesa tjetër, në masë të madhe që jetonin dhe vepronin në diasporë, ishin duke u kujdesur intensivisht për mbështetjen ndaj fondeve “Vendlindja thërret”, Fondit të 3%-shit dhe Fondit për pavarësinë e Kosovës.

Jorastësisht po i përmend këto fakte reale, sepse nga ngritja e kësaj urrejtjeje nga politikat e egra të Slobodan Milosheviqit në Kosovën e pasluftës shkaktoi ndarje dhe urrejtje ndëretnike, ku fatkeqësisht shumë individë ranë pre e kësaj politike përfaqësuese, ku si pasojë e kësaj urrejtje pësuan shumë viktima civile nga persona dhe individ të papërgjegjshëm, të cilët janë kryer për qëllime personale dhe përfitime materiale dhe këta individë të gjitha këto veprime do të duheshin t’i kryenin sigurisht duke ia veshur luftës së pastër të UÇK-së dhe udhëheqësve të saj.

Sigurisht që barrën e përgjegjësisë e mbajnë institucionet e Kosovës, sepse për secilin rast kriminal ndaj viktimave civile do të duhej të trajtoheshin me prioritet, të sjellin drejtësi dhe dënimet e merituar t’i marrin ata që kanë kryer vepra kriminale me argumente dhe fakte ndaj secilës viktimë të pafajshme dhe jo të akuzohen, të arrestohen persona të pafajshëm dhe atë të shpallur edhe me verdikte gjyqësore si të pafajshëm.

Unë i jam mirënjohës Qeverisë së Kosovës për veprimet e ndërmarra për lirimin e zotit Haradinaj dhe besoj e shpresoj fuqishëm në lirimin e plotë të zotit Haradinaj. Por uroj dhe lutem

që institucionet e Kosovës t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e situatave të tilla të papranueshme për të gjithë ne.

Unë dhe komuniteti im egjiptian shtetin e Francës e shohim si shtet mik i vërtetë i Kosovës dhe popujve që jetojnë në Kosovë. Franca si shtet është kontribuuese e çlirimit dhe pavarësisht të Kosovës dhe besoj fuqishëm se vendimi për ndalimin e zotit Haradinaj nga ana e shtetit të Francës është vetëm vendim ligjor, bazuar në obligimet ndërkombëtare dhe besojmë se vendimi nuk është politik i ndikuar akoma nga politikat shkatërruese të shtetit të Serbisë dhe besojmë se Franca me procedimin e të gjitha fakteve do ta lirojë zotin Haradinaj.

Të nderuar qytetarë dhe deputetë të Republikës së Kosovës,  
Duke kërkuar mirëkuptimin tuaj dhe respektin e ndërsjellë mes nesh, arrestimin e zotit Haradinaj mos e konsideroni se është sulm dhe dëm vetëm ndaj shqiptarëve, sepse kjo nuk na bënë të ndihemi mirë.

Unë nga këtu e them me bindje të plotë se arrestimi i çlirimtarëve është sulm dhe tendencë për të penguar lirinë e plotë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallim etnie.

Ne bëjmë pjesë në grupin e komuniteteve, të cilat e njohin shtetin e Kosovës si shtet legjitim. Andaj, edhe arrestimi i zotit Haradinaj është arrestim dhe pengesë për jetë të dinjitetshme për të gjithë qytetarët e Kosovës. Urojmë, lutemi dhe shpresojmë që në vendimin e ardhshëm zoti Haradinaj të jetë i lirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr Enver Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

E nderuar familje Haradinaj,

Na vjen keq që këtu prej Qeverisë ka mbetur vetëm zëvendëskryeministri dhe të tjerët kanë dalë, por kjo nuk është diçka risi.

Njëkohësisht urojmë që të mos përsëriten raste të tilla dhe Kuvendi i Kosovës të mos mblidhet për çështje të tilla më.

Më 29 nëntor 2012 Gjykata Ndërkombëtare e ka liruar zotin Haradinaj nga të gjitha akuzat dhe që nga ajo ditë ka përfunduar punët me drejtësinë. Prandaj, arrestimi i zotit Haradinaj është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe kryekëput politik.

Që nga lirimi i zotit Haradinaj ka lëvizur në shumë vende, e tani shtrohet pyetja pse pikërisht tani ai ndalohet në Francë? Në këto momente, kur Kosova po përballlet me sfida të mëdha dhe më të rrezikshme që nga pas pavarësia e këndeje, si rezultat i një Qeverie të dobët, të paafte e mashtruese, e mbi të gjitha nuk po ka guximin për t'u përballur me Serbinë. Është e ditur dhe nuk do asnjë koment se politika e udhëhequr nga Nikoliqi, Vuçiqi dhe Daçiqi është vazhdimësi e politikës së Milosheviqit, e Pashiqit, e cila në thelbin e saj ka pushtimin, sundimin, politikën e forcës, e si gjithmonë ka qenë dhe është faktor destabiliteti dhe duke pasur parasysh këto qëndrime, Serbia paraqet pasiguri për rajonin, e në mënyrë të veçantë për Kosovën dhe shqiptarët.

Pra, Serbia mbetet armik i përhershëm yni, ndaj të cilit duhet të sillemi me përgjegjësi të lartë shtetërore, institucionale e kombëtare, e jo ashtu siç po bën Qeveria e Kosovës që nga fillimi i bisedimeve e deri më tani.

Bisedimet filluan për të siguruar integrimin e vendit në mekanizma ndërkombëtarë, për të shtrirë sovranitetin e institucioneve të Kosovës në veri, për të normalizuar marrëdhëniet me Serbinë, por cila është sot gjendja? Mendoj se në të gjitha sferat është më keq se para fillimit të këtyre bisedimeve.

Më 18 qershor 2015 ne nxorëm një rezolutë, ku në pikën 2 kërkuam nga Qeveria që të marrë masa për largimin e të gjitha fletarrestimeve të ngritura nga Serbia për ish-ushtarët e UÇK-së, por sot të gjithë ne dhe qytetarët e panë se asnjë veprim konkret nuk u paraqit nga Qeveria në realizimin e kësaj pike.

Dëgjuam një vajtim e mashtrim nga këta qeveritarë e deputetë të partive në pushtet, sikur që nuk janë përgjegjës fare për atë se çka përfaqësojnë, duke tentuar të shpërndajë përgjegjësi dhe të fshihen pas situatës së krijuar në vend.

Jo, të nderuar, është momenti i fundit të merrni së paku guximin dhe të deklaroni se nuk po keni guxim të përballeni me Serbinë dhe se keni dështuar e po i bëni dëme të shumta vendit.

Sot nuk mund të flasim se kemi funksionim të institucioneve, e kur ia shtojmë edhe disa qëndrime me hile të disa faktorëve dhe eksponentëve politikë, sidomos ato që ka të bëjnë nga kryeministri i vendit lidhur me zotin Haradinaj, deklarimi i fundit i zotit Thaçi dhe i shumë politikanëve në vend lidhur me luftën dhe me njerëz të luftës, mendojmë se kjo rëndon edhe më tej situatën dhe është momenti i fundit që ne të distancohemi nga ky fjalor politik dhe të marrin përgjegjësitë e duhura dhe të qëndrojmë e të punojmë për të ardhmen e vendit.

Unë në fund shpreh edhe një herë indinjatën e thellë për mosveprimin e Qeverisë dhe i lutem Zotit që Haradinaj të kthehet në atdhe dhe te familja e tij, e Zoti i ndihmoftë, se kjo Qeveri nuk mund t'i ndihmojë asgjë, vetëm sa mund të jetë pengesë e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar dhe shumë e respektuar familje Haradinaj, prind të Ramushit, baca Ilmi,

Kolegë të nderuar,

Unë personalisht nuk e shoh rastin e zotit Haradinaj si një rast që ka të bëjë me individin, po e shoh si një mesazh të qartë për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe një veprim që atakon drejtpërsëdrejti vlerën tonë më të çmuar, luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kemi të bëjmë me një familje, e cila jo vetëm që ishte pjesëmarrëse aktive e luftës, po kemi të bëjmë me një familje e cila ka dhënë një kontribut të çmuar edhe për përgatitjen e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Familja Haradinaj ishte frymëzim për gjenerata të tëra se si duhet të mendohet, të vepohet dhe të punohet për çlirimin e vendit.

Unë po e përkujtoj vetëm një moment nga një anëtar i familjes Haradinaj, këtu e 36 vjet më herët, kur në bisedë e sipër e tha shumë qartë se liria nuk pikë nga qielli, por duhen sakrificat. Me këtë dua të them se familja Haradinaj është një familje e cila nuk ka marrë pjesë asnjëherë rastësisht, po me vetëdije të plotë, duke qenë e përgatitur edhe për sakrificat e mundshme që realisht kjo familje i dëshmoi.

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës vlerësoj se tashmë nuk i takon asnjë individ, asnjë grupi, sado i madh qoftë ai, është një vlerë kombëtare, për të cilën ka obligim çdo qytetar i ndërgjegjshëm dhe i përgjegjshëm që të japë kontributin e vet në ruajtjen, mbrojtjen e pastërtisë së kësaj lufte.

Sa kemi bërë në këtë drejtim, unë besoj që nuk kam nevojë të komentoj, historia do të dëshmojë për secilin në mënyrë individuale, do t'i respektojë dhe do t'i vlerësojë kontributet e gjithsecilit veç e veç, të atij që ka dhënë një kontribut sado të vogël për mbrojtjen, ruajtjen e kësaj vlere kombëtare. Por gjithsesi historia do t'i dënojë të gjithë ata të cilët kanë kontribuar dhe kanë bërë përpjekje që me shpifje, trillime, akuza të pabaza e përpjekje për të hedhur baltë mbi luftën tonë të drejtë, do t'i dënojë histori. Dhe, të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm se nëse sot jo, e vërteta mund të fshihet për një kohë, a për disa vjet, por pa tjetër e vërteta një ditë do të dalë në shesh.

Të nderuar kolegë,

Ne sot këtu po merremi me pasojat. Nuk është rasti i parë dhe i vetëm që i ka ndodhur zotit Haradinaj. Ky është rasti i dytë që drejtpërsëdrejti është përballur zoti Haradinaj, po kemi edhe raste të tjera dhe ne prapë, nëse nuk e luftojmë shkakun, atëherë prapë do të merremi me të njëjtën gjë. Shkaktar i të gjitha këtyre është politika shoviniste e udhëhequr nga përfaqësuesit e Qeverisë së Beogradit, vazhdimësi e politikës paraprake të Milosheviqit, të njohur, të cilësuar dhe të vlerësuar si “kasap i Ballkanit”.

Mendoj se si ne, edhe më mirë e dinë dhe e njeh gjuhën, veprimet dhe pabesinë e Beogradit edhe vetë familja Haradinaj dhe për këtë arsye, duke pasur parasysh këtë, ne kemi kërkuar dhe jemi përcaktuar qartë, drejt, të ndërtojmë urat e miqësisë me të gjithë popujt fqinjë dhe këtë e kemi kërkuar sepse e kemi njohur, e njohim e dimë kush, cila është politika që është udhëhequr dhe vazhdon të udhëhiqet nga përfaqësues të shtetit serb.

Për këtë arsye kemi kërkuar ndërmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare, kemi kërkuar si garanci Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe për t’i ndërtuar këto ura të miqësisë e të bashkëpunimit të popujve, normalisht se nevojitet gatishmëria e të dy palëve.

Ne e kemi dhënë pëlqimin tonë, por po shihet qartë se me të gjitha veprimet Beogradi po dëshmon të kundërtën, se po udhëhiqet me politikën e vjetër, se mentaliteti i të kaluarës është ende prezent në Beograd.

Prandaj, mendoj që rasti i tashëm, muri i ngritur në Mitrovicë në shekullin XXI, kur të gjithë popujt bëjnë përpjekje t’i shembin të gjitha muret ndarëse, Beogradi bën përpjekje të ngrejë mure ndarëse që mbjellin vdekjen e njerëzve. Provokimet dhe politika agresive që po udhëhiqet nga Beogradi jo vetëm kundër Kosovës, por edhe ajo që po ndodh në Bosnjë, edhe ajo që ka ndodhur në Mal të Zi, edhe ajo që ka ndodhur në Maqedoni dhe kjo në Kosovë, na kthen në vitet ’90-ta.

Prandaj, është momenti kur edhe institucionet e vendit, edhe institucionet ndërkombëtare duhet të ndalen dhe të mendojnë seriozisht nëse nuk duan që të mos përballen me skenat e tmerrshme të së kaluarës, duhet të ndalen dhe t’i thonë “Stop” një herë e përgjithmonë dhe t’i japin atë që e meriton politikës së Beogradit e udhëhequr jo vetëm ndaj Kosovës, por ndaj të gjithë popujve të tjerë.

Ne e dimë të gjithë se pikërisht Beogradi ka qenë shkaktar apo i ka shkaktuar katër luftëra dhe ka mbjellë vdekjen e dhjetëra-mijëra njerëzve të pafajshëm.

Prandaj, unë mendoj që Qeveria jonë, institucionet tona duhet të ndalen dhe të mendojnë dhe një herë e përgjithmonë të kërkojnë nga institucionet ndërkombëtare tërheqjen e të gjitha fletarrestimeve për luftëtarët e lirisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuredin Ibishi, nuk është. Rrustem Berisha e ka fjalën.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

E nderuar familje Haradinaj,

Unë konsideroj dhe vlerësoj që ndalesa edhe arrestimi i zotit Haradinaj në Francë është shumë më alarmante se sa po prezantohet sot këtu dhe sa seriozisht shteti ynë e merr këtë çështje.

Së pari, të gjithë e dimë se kjo ndalesë-arrestim është bërë mbi bazën e një fletarrestimi të regjimit të Milosheviqit dhe bashkëpjesëmarrësve të tij. Po ashtu, e dimë se çfarë pasojash dhe çfarë ka bërë në Kosovë prej terrorit, gjenocidit, masakrave të shumta. Po ashtu, jemi të vetëdijshëm që lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është një luftë e shenjtë dhe Ramush Haradinaj si njëri prej komandantëve të kësaj lufte është një simbol i kësaj lufte, është një njeri që bashkë me familjen e tij kanë kontribuar dhe kanë dhënë shumë për këtë çështje.

Po ashtu, edhe roli i Ramushit në kohën e pasluftës është i pamohueshëm, sidomos në unifikimin e faktorit ushtarak dhe në fuqizimin e shtetit të Kosovës, dhe kjo që po ndodh sot nuk mund ta quajmë se është një rastësi, por tashmë kjo ka filluar të bëhet dukuri te ne në Kosovë dhe për çdo ditë mund të presim provokime shumë më të mëdha nga shteti serb në raport me Kosovën.

Jemi të vetëdijshëm që Kosova po i zhvillon bisedimet me shtetin e Serbisë. Sipas njerëzve tanë, delegacionit tonë, arsyeja dhe qëllimi i këtyre bisedimeve është zgjidhja e shumë çështjeve, e problemeve që i kemi në raport me shtetin e Serbisë dhe normalizimi i marrëdhënieve të dy shteteve, ndërsa Serbia nuk e ka këtë qëllim, nuk e ka këtë objektiv. Serbia i shfrytëzon këto bisedime si mundësi të rikthimit të forcave serbe dhe të Serbisë në Kosovë. Pra, kurrsesi nuk i kemi objektivat e njëjta dhe unë mendoj se shteti ynë duhet ta ndryshojë qasjen, duhet t'i ndryshojë edhe defektet e këtyre bisedimeve, duhet t'i shqyrtojë shumë seriozisht.

E dëgjuam shtetin tonë, Qeverinë tonë, ministrat tanë, hapat konkretë që i kanë ndërmarrë prej momentit të arrestimit zotit Haradinaj në Francë. Por, nuk dëgjuam asnjë hap, asnjë informatë konkrete çfarë ka bërë Qeveria jonë prej momentit kur zoti Haradinaj është arrestuar në Slloveni, kur pjesëtari i Forcës së Sigurisë së Kosovës, zoti Gafurr Dugolli është arrestuar në Maqedoni, cilët janë hapat që shteti ynë, Qeveria jonë i ka ndërmarrë në këtë drejtim. Po ashtu, nuk dëgjuam prej Qeverisë sa janë garancitë se Ramush Haradinaj nuk do të ekstradohet në Serbi.

A duhet ne prapë të ulemi dhe të bisedojmë se si Ramush Haradinaj u ekstradua në Serbi? Cili është qëndrimi i Qeverisë sonë ndaj shpifjeve të reja që i ka deponuar Serbia për zotit Haradinaj? Cila është preventiva, cilat janë masat që ne po i ndërmarrim në raport me lirimin e zotit Haradinaj, sepse nuk konsideroj që ky është rast që duhet të trajtohet si rast personal, besa



edhe i shtetit të Kosovës, por duhet përdoret edhe ndikimi ndërkombëtar, edhe i shteteve tjera, sepse çështja është shumë më serioze sesa që po prezantohet sot këtu.

Unë shpresoj që ne si shtet do t'i nxjerrim mësimet e mësuara nga ky arrestim, do të punojmë që bashkërisht ta forcojmë shtetin e Kosovës, duhet të bashkohemi për çështjet nacionale, goditjet, të cilat po ndodhin mes luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e që janë shumë më të mëdha, shumë më të dhimbshme se sa goditjet që po na vijnë prej kundërshtarëve tanë, sepse ne sigurisht ato prej kundërshtarëve i presim, por goditjet, ndasitë, ndarjet, përçarjet që po ndodhin mes luftëtarëve, mes njerëzve të luftës kanë pasoja shumë më të mëdha se sa prej të tjerëve.

Unë shpresoj që ne do të jemi në nivel të përgjegjësisë, në nivel të detyrave dhe trajtimin e kësaj çështjeje ta marrim si shumë më serioze me qëllim që t'ia mundësojmë që zoti Haradinaj të kthehet sa më shpejt në Kosovë dhe të vazhdojë punën e vet në shtetin e vet, për çka edhe është sakrifikuar dhe ka dhënë shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

E nderuar Familje Haradinaj,

Kolegë dhe kolege deputetë të nderuar,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Në seancën e fundit, të cilin e kemi pasur në Parlamentin e Kosovës, e cila e ka trajtuar temën e njëjtë që pikërisht kishte të bëjë me arrestimin e qytetarëve të Kosovës, konkretisht pjesëmarrësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kur fjala ishte për drejtorin rajonal Nehat Thaçi, pas përfundimit të asaj seance, thënë të drejtën, nuk kam pas dëshirë të kemi më situata të tilla në Kosovë, por e kam ditur se mund të ndodhin prapë. Pavarësisht dëshirës sime mund të ndodhin. Pse mund të ndodhin? Ngase edhe ne si Kuvend i Kosovës, edhe si Qeveri e Republikës së Kosovës, nuk kemi treguar gatishmëri që t'i mbrojmë qytetarët tanë.

Fjala këtu është, jo vetëm nëse duhet të adresojmë kritika a jo ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës, por edhe ndaj Kuvendit, ngase asnjëherë nuk kemi qenë të fuqishëm të mbrojmë dhe njëherë të shprehim guximin tonë dhe fuqinë tonë përballë partnerit të bisedimeve në Bruksel, konkretisht përballë Serbisë. E arrestimi i fundit i ish-kryeministrit të Republikës së Kosovës, i ish-gjeneralit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, nuk është goditje vetëm për familjen, nuk është goditje vetëm për partinë e tij, por është goditje për tërë shtetin dhe për tërë qytetarët e Republikës së Kosovës, ngase është arrestuar një ish-kryeministër, një gjeneral i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili dy herë në dy procese të drejta ndërkombëtare e ka dëshmuar pafajësinë e tij dhe tash arrestohet padrejtësisht me një fletarrest të adresuar nga Republika e Serbisë.

Është shumë i dhimbshëm dhe shumë i rëndë për ne si qytetarë të Kosovës ky arrestim i Ramush Haradinajt. Këtë situatë e bën edhe më të rëndë fakti se sot Republika e Serbisë ka kërkuar ekstradimin e tij nga Franca në Beograd, konkretisht në Serbi, që atje të gjykohet. Unë mendoj, pa dashur ta zgjas më shumë, në aspektin se cila është politika e Beogradit përballë neve, të gjithë e dimë politikën e Beogradit edhe para luftës edhe pasluftës, por shqetësimi im kryesor mbetet te ne. Çka ne si Kuvend, çka ne si Qeveri e Republikës së Kosovës jemi të gatshëm të bëjmë për mbrojtjen e qytetarëve tanë që po arrestohen.

Në seancën e fundit kam kërkuar, kërkoj edhe tash - domosdo hapi i parë që duhet të ndërmerret në raport me Serbinë është ndërprerja e bisedimeve njëherë e përgjithmonë, të tregojmë guximin, vullnetin dhe fuqinë tonë që dimë dhe duam t'i mbrojmë qytetarët e Republikës së Kosovës. Nëse sot është arrestuar Ramushi, nesër mund të arrestohen edhe të tjerët. Prandaj, ne si shtet duhet t'i mbrojmë qytetarët e Republikës së Kosovës në çdo rast dhe në çdo situatë, e në veçanti duhet ta mbrojmë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Pyes veten edhe ju: A kemi shtet, a kemi institucione, a janë të gatshëm ata t'i mbrojnë qytetarët e Republikës së Kosovës? Të mos harrojmë se edhe Qeveria edhe Kuvendi e kanë një detyrë, ta mbrojnë interesin e qytetarëve të shtetit të Kosovës, e jo t'i mbrojnë interesat e veta. Fundja-fundja, në bisedimet që po zhvillohen në Bruksel e kemi parë që sa vjet me radhë se kush po përfiton nga ato. Përfituesi kryesor pa dyshim është Serbia. Ajo, përveç që ka fituar para shumë viteve liberalizimin e vizave, tash pritet ta fitojë edhe statusin e kandidatit për anëtarësim në BE, përderisa qytetarët e Kosovës ende nuk kanë drejtë të lëvizin pa viza.

I dëgjova këtu nga deputetët parafolës edhe disa shqetësime, reagime dhe kritika se Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të mendojë. Unë mendoj që Qeveria nuk duhet të mendojë, Qeveria duhet të veprojë. Mjaft ka menduar deri tash, ngase si pasojë e mosveprimit të Qeverisë dhe mosveprimit të Kuvendit e kemi 'atrofinë' - zvogëlim të shtetit edhe në aspektin fizik, edhe njerëzor. Në mjekësi, në gjuhën latine përdoret një fjalë - "atrofia si pasojë e mosfunksionimit". Ne kemi atrofi, zvogëlim të shtetit edhe në aspektin fizik, edhe në aspektin njerëzor.

Në aspektin fizik e kemi murin që është ndërtuar dhe po e ndan Kosovën dhe kemi çdo ditë zvogëlim të njerëzve, të qytetarëve të Kosovës, të cilët në vazhdimësi arrestohen nga Republika e Serbisë.

Prandaj, edhe një herë pa dashur të zgjas më shumë, edhe ne si Kuvend, edhe si Qeveri, duhet njëherë e përgjithmonë t'i themi vetes, të reflektojmë, të jemi vetja jonë, ta mbrojmë qytetarin e Republikës së Kosovës, ngase janë bërë shumë arsye pse duhet të ndërpriten bisedimet.

Arsyeja e parë është pikërisht kjo seanca për të cilën ne po flasim - arrestimet, dhe arrestimi i fundit i komandantit dhe ish-kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj. Pastaj,

mosdorëzimi i personave të pagjetur, mosrespektimi i marrëveshjeve të Brukselit, ndërtimi i murit, cenimi i integritetit territorial në vazhdimësi nga Beogradi. Të gjitha këto janë argumente që Kosova njëherë e përgjithmonë duhet të tregojë se është shtet, se ka Qeveri dhe ka Parlament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kolegë deputetë, ju njoftoj që janë edhe 11 kërkues për të folur, të gjithë janë të PDK-së, prandaj do t'ju jap fjalën me radhë. Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se gospodine predsedavajući,  
Poštovani kolege poslanici,  
Poštovani građani.

Verujući u pravosudni sistem Republike Francuske, jedan od najstarijih demokratskih zemalja u Evropi po pitanju vladavine, prava i demokratskih baznih principa, verujući u naš pravosudni sistem i sve napore koje Kosovska Vlada čini da se gospodin Haradinaj oslobodi u što skorijem vremenskom periodu i vrati svojoj porodici i društvu u celini, kao poslanik Bošnjačke nacionalne zajednice želim da se za ovom govornicom u Parlamentu javno solidarišem sa svim mojim kolegama, smatrajući da je g. Ramush Haradinaj predsednik AAK – partije, jedan od retkih albanskih lidera koji poštuje i uvažava prava svih zajednica i naroda koji žive u našoj državi, a koja su Ustavom Republike Kosova regulisana i zagantovana.

Njegova humanost i ljudskost dovodi sve nas u obavezu da danas, kada je njemu naj potrebniije, budemo uz njega i podržimo ga u ovim teškim trenucima, i pružimo podršku rezoluciju koju ćemo danas izglasati u ovom Parlamentu. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Agim Çeku e ka fjalën, përgatitet Fatmir Shurdhaj.

AGIM ÇEKU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Desha edhe unë t'u bashkohem të gjithë juve dhe të gjithë atyre që e kundërshtojnë ashpër ndalimin apo arrestimin e zotit Ramush Haradinaj, dhe këtë veprim e konsiderojnë të papranueshëm, të papabazë ligjore, absurd dhe tendencioz.

Dua gjithashtu të shpreh solidaritetin tim me të, me zotin Ramush Haradinaj, me familjen e tij, me të afërmit e tij dhe ta ndaj ndjenjën e pezmit me ta dhe t'i bashkohem urimit që ky të jetë shqetësimi i fundit që i bëhet atij dhe familjes së tij.

Dua gjithashtu t'i vlerësoj veprimet e Qeverisë së Kosovës që i dëgjuam edhe këtu sot, përpjekjet e tyre, angazhimet e tyre që Ramush Haradinaj të kthehet sa më shpejt në vendlindje.

Por, e mora fjalën që ta them mendimin tim për këtë çështje, që mendoj që edhe për shkak të angazhimit tyre që ka hapësirë dhe ka nevojë që të bëhet edhe më shumë se sa janë duke bërë.

Deri në lirimin e Ramush Haradinajt, lirimi i tij dhe çështja rreth këtij arrestimi duhet të jetë top-temë në agjendën e secilit prej nesh, gjithashtu edhe në agjendën e kryeministrit dhe të të gjithë ministrave. U pa që janë bërë shumë telefonata, janë bërë shumë kontakte, janë bërë shumë përpjekje, por më lejoni ta keqpërdor këtë fjalë dhe të them që dua t'i ndaj me ju disa përvoja që edhe unë kam kaluar situata të ngjashme, apo të njëjta, dhe mendoj që këto çka i ka bërë Qeveria janë të pamjaftueshme.

Telefonatat kanë efekt vetëm përderisa Ramush Haradinaj është ndodhur në aeroport, është ndodhur në hapësirat e policisë kufitare, e në momentin që del nga ato hapësira, atëherë më telefonatat nuk mund të kryejnë punë. Atëherë fillon një proces gjyqësor, një procedurë e rregullt të një shteti, i cili ka obligimin ndërkombëtar dhe duhet t'i respektojë procedurat e trajtimit të arrestuarit në bazë të fletarrestit të Interpolit.

Kështu që këtu bëhet fjalë për dokumente, bëhet fjalë për fakte, sepse kemi të bëjmë me një procedurë gjyqësore. Unë jam liruar çdo herë, por argumenti kryesor për lirimin tim ka qenë letra e autoritetit kryesor të shtetit. Thjesht, referencë e vendimit për lirimin tim në dy raste ka qenë letra e shefit të UNMIK-ut, referencë për lirimin tim nga Bullgaria ka qenë letra e ish-kryeministrit Thaçi, e cila është marrë si dokument. Telefonatat nuk merren si dëshmi në gjykata. Kemi dëgjuar se gjykata duke pritur dëshmitë shtesë nga Serbia e tjera, e tjera.

Më vjen keq që nuk është kryeministri këtu, dhe më vjen keq që nuk e mora fjalën më herët, por kisha kërkuar nga kryeministri që vetë ai t'ua dërgojë një letër autoriteteve franceze. Është peshë shumë më e madhe, pa keqkuptim, se sa nga ministrja e Drejtësisë, kështu që mendoj që edhe këtë veprim duhet ta bëjë kryeministri dhe t'i drejtohet me një letër, ta sqarojë gjithë atë që na sqaroi neve këtu për autoritetet franceze.

E dyta çka mendoj që duhet bërë është se duhet ta kemi një ministër apo dy, ministrin e Punëve të Jashtme dhe ministrin e Drejtësisë në Francë, pa marrë parasysh, të kemi përfaqësues tonë diplomatik atje, mund të angazhohen në takime, por mund të angazhohen edhe në fusha tjera, sidomos ekstradimi i zotit Ramush Haradinaj në Beograd është një prej qëllimeve, por këtu ka shumë qëllime tjera. Ka qëllime që të portretizohet UÇK-ja si organizatë terroriste, të portretizohen shqiptarët e Kosovës si njerëz që kanë kryer krime, të portretizohet Serbia si viktimë, të mbahen në agjendën ndërkombëtare kohë pas kohe me arrestime të tilla, me mbajtje të tilla, të flitet për krimet që janë bërë kundër serbëve.

Një kohë u arrestua Ramush Haradinaj në Slloveni, pastaj Gafurr Dugolli, pastaj zoti Thaçi në Serbi, tash prapë Ramush Haradinaj, kështu që ata e imponojnë një agjendë të tillë, që të mbajnë

aktivë, domethënë që ndaj serbëve janë kryer krime, shqiptarët i kanë kryer këto krime, trajtohen dhe e luajnë rolin e viktimës. Gjithashtu, qëllimi i dytë që ata dëshirojnë ta bëjnë me arrestime të tilla është që t'i zbehin apo që t'i ftoh in marrëdhëniet me shtetet, të cilat reagojnë në këto fletarrestime të Interpolit. Vendosin njolla në marrëdhëniet e tyre, bëhen pengesë për zhvillim të mëtutjeshëm të marrëdhënieve miqësore dhe për këtë arsye ne duhet të flasim në Francë, me mediet në Francë, me mediet ndërkombëtare, e për të folur duhet qenë atje.

Veprimi i tretë çka mund të bëjë Qeveria jonë, kemi përfaqësues diplomatikë, t'i angazhojë miqtë të shumtë në Francë që i kemi, që ata të flasin për këtë çështje. E kemi një Bernard Kushner, një mik të Kosovës, administrator të Kosovës, i cili vetë ka qenë i akuzuar nga Serbia; i kemi dy ish-komandantë të KFOR-it, dy ish-drejtorë të EULEX-it që kanë qenë disa misione këtu, që e dinë situatën, e dinë natyrën e këtyre fletarrestimeve, i dinë qëllimet e Serbisë dhe duhet t'u kërkohet atyre që të dalin në opinion, ta japin mendimin e tyre, ta krijojnë një opinion publik në lidhje me këto arrestime, t'i demaskojnë qëllimet e tyre, t'i mbrojnë marrëdhëniet e mira të Francës dhe Kosovës, të mos lejojnë që të hidhen njolla në këtë marrëdhënie.

Kështu që nuk kam dëgjuar ende që ata kanë folur, e jam i sigurt se janë të gatshëm që të flasin, edhe për ta mbrojtur Kosovën, edhe për ta mbrojtur zotin Haradinaj, edhe për ta mbrojtur të vërtetën, sepse ata e dinë se këto fletarreste nuk janë legjitime dhe janë pa bazë ligjore. Kështu që mendoj që Qeveria mund t'i bëjë këto veprime sot, apo edhe gjatë ditës së nesërme.

E dyta, që e thanë edhe këtu shumë kolegë të mi, është se çka të bëhet në përgjithësi me këto fletarrestime? Problemi është Serbia, normalisht. Por, unë u bashkohem të gjithë atyre që e kërkojnë një analizë serioze të bisedimeve me Serbinë, të krejt këtij procesi, se çka na sollli ky proces i bisedimeve. Po, duhet të bisedohet. Pajtohem! Duhet të bisedojmë, por duhet ta bëjmë një analizë. Kam përshtypjen që nuk mund të ikim nga kjo se këto bisedime më së shumti na e sollën Serbinë në Kosovë, më shumë se sa e kemi pasur ndonjëherë prej qershorit '99.

Serbinë e kemi më shumë brenda. Kështu që duhet t'i shikojmë. Mendoj që duhet të rishikohet edhe përmbajtja edhe formati, edhe temat, të cilat duhet të shtrohen. Më falni, se pak po e përdor terminologji ushtarake - "nuk ka paqe pa na nënshkruar armëpushim". Nuk ka bisedime për normalizim në qoftë se në fillim nuk mënjanohen të gjitha pengesat që gjatë rrugëtimit të normalizimit mund të na kthejnë në pikën zero. Domethënë, që të largohen kushtimisht po them "minat" apo "bombat" që mund të eksplodojnë gjatë procesit të normalizimit të bisedimeve dhe të na kthejnë prapë ku kemi qenë. Njëra nga këto mina, një nga këto bomba, një nga ato çështje që është bërë pengesë reale, është çështja e të zhdukurve, janë fletarrestet e Serbisë, janë strukturat paralele, e shumë e shumë të tjera, por këto duhet të trajtohen me seriozitetin më të madh, të kërkohet të largohen këto fletarreste nga Interpoli dhe të cilësohen si të papranueshme.

E thanë, unë s'po i përsëris të tjerët, por duhet seriozisht të merremi me çështjen e bisedimeve.

E dyta, si duhet të trajtohen këto çështje me Interpolin? Unë e kam një përvojë në lidhje me këtë dhe e di se Kosova nuk është anëtare e Interpolit, por ne e kemi këtu një organizatë, të cilën ne me arsye po e injorojmë, ajo është UNMIK-u, apo shefi i UNMIK-ut, që fatkeqësisht është i vetmi institucion i cili ka bashkëpunim zyrtar me Interpolin. Edhe Interpoli ka bashkëpunim zyrtar dhe konkret, e respekton dhe e trajton si partner në Kosovë vetëm shefin e UNMIK-ut. Dhe, ne duhet ta trajtojmë UNMIK-un, jo si mision, por si zyrë të OKB-së, apo si përfaqësues të OKB-së këtu në Kosovë, dhe duhet të kërkojmë edhe ndihmën e tyre.

E dyta, e di se Qeveria ka angazhuar kompani lobuese, avokatë ndërkombëtarë, dhe disa herë më është sugjeruar mua që t'i sugjeroj Qeverisë që të angazhohet një kompani apo avokat ndërkombëtar dhe ta përfaqësojë Kosovën në Interpol dhe të kërkojë nga Interpoli që t'i shpallë të pavlefshme këto akuza. Dhe, së fundi, u tha edhe këtu disa herë, duhet bashkëpunojmë më shumë, t'i bashkërendojmë veprimet me Kroacinë, me Bosnjën, që t'i bëjmë presion Serbisë që ta tërheqë këtë ligj të drejtës universale për krimet e luftës, sepse Serbia me qëllim është duke e bërë këtë çështje që të fitojë amnistinë nga historia dhe nga bashkësia ndërkombëtare për krimet e veta, duke ngrehur vazhdimisht akuza ndaj qytetarëve të popujve tjerë për krime ndaj tyre.

Kështu që mendoj që të mos na përsëritet edhe një rast...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Fatmir Shurdhaj, bëhet gati Bekim Haxhiu.

FATMIR SHURDHAI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

E nderuar Familje Haradinaj,

I nderuar bacë Ilmi,

Ne sot jemi mbledhur këtu në një seancë të jashtëzakonshme, e jo pak ditë më parë kaluam prej një seance tjetër të jashtëzakonshme dhe po e fillojmë vitin prapë me një seancë të jashtëzakonshme.

Kjo është fatkeqësia e institucioneve, të cilat kanë dështuar në performansën e tyre për ta mbrojtur sovranitetin territorial, integritetin territorial të shtetit dhe për t'i mbrojtur shtetasit e vet me shtetësi të Kosovës, të cilët po i padit Serbia në Interpol, në gjykata ndërkombëtare dhe po i trajton si shtetas të vet. Piku i këtij cirku është dialogu me Serbinë. Këtu ka mbërri kulmi i arrestimit të Ramush Haradinaj, jo rastësisht kjo temë pas murit në Mitrovicë, sepse ne po mbajmë seancë të jashtëzakonshme, po nxjerrim disa rezoluta dhe po shkojmë në shtëpi. Ministria për Dialog prapë po e vazhdon dialogun me Serbinë, Serbia po afirmohet në

marrëdhëniet ndërkombëtare, po e dëmton sovranitetin e Kosovës, po e paraqet Kosovën si shtet kukull në marrëdhënie ndërkombëtare. E kam thënë në seancën tjetër, Kosova po shkon drejt sovranitetit të disiplinuar sikur Bosnjë-Hercegovina.

Ky është sovraniteti i disiplinuar. Këtë na e dëshmoi përfaqësuesi ndërkombëtar i Ambasadës së Francës në Kosovë, miku ynë francez, kur tha: “Si vous voulez passer par la France, tu viens prendre les papiers.... ..” Çka do të thotë kjo? “Nëse doni të shkoni në Francë, ejani merreni nga një letër...”.

Të nderuar kolegë deputetë,  
Kabinet i Qeverisë,

A funksionon Ministria e Punëve të Jashtme? Cila është strategjia politike e saj? Cilat janë objektivat e saj shtetërore? A po e shohim ne, se Ministria për Dialog, që po e udhëheq ministrja Tahiri, po e keqpërdorë detyrën zyrtare? A po e shohim ne, deputetë të nderuar, se ministrja për dialog e ka izoluar Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe strategjia politike e jashtme e Qeverisë së Kosovës ka dështuar, ka mbetur ministri me bë telefonata, me dërgua SMS, me bë takime protokollare.

Ky është kulminacioni i dështimit të dialogut Kosovë – Serbi me ndërmjetësim ndërkombëtar, në këtë rast Bashkimin Evropian. Dhe, prapë ne, po kthehem në kohën e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës, ta kthejmë kryet kah Dragodani, të shkojmë të marrim dorë në Dragodan prapë, të përkulemi atje, mos po shpëtojmë...

Shikoni, kjo është praktikë e vjetër, këtë praktikë shumë ministra, deputetë e komandantë të UÇK-së e kanë kaluar, e thanë edhe gjeneral Çeku, e thanë edhe deputet Antoni, plotë ushtarë të UÇK-së mbeten nëpër kufij, edhe në Shqipëri me shkua, e fute pasaportën në skanim, mbetesh në kufi. Edhe zonja Osmani, sepse Kosova nuk po i përdor mekanizmat juridikë që i ka në dorë si shtet, përkundër përpjekjeve të ministrit të Punëve të Brendshme për tu anëtarësuar në Interpol. Po, neve na paditi Serbia për shkak të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në Gjykatë Ndërkombëtare. A nuk mund Kosova të ngre padi Serbisë në Gjykatë Ndërkombëtare dhe t’i thuhet që këta shtetas që i ke futur në Interpol janë qytetarë të Republikës së Kosovës. Zoti Ramush Haradinaj është qytetar i Republikës së Kosovës me pasaportë diplomatike dhe shtetësia e tij është Kosova, jo Serbia.

A mos po presim ne që ajo fusnota, ajo “fluska” e zonjës Tahiri, t’ia vënë Ramushit në krahë e ta kalojë ‘menorën’ a, nëpër kufi... Kjo, me të vërtetë është qesharake për Ministrinë për Dialog. Është me të vërtetë qesharake edhe për ne si deputetë, që pranojmë të bëjmë rezoluta, nuk vjen ministrja fare këtu, ajo shkon kthehet, bën shëtitje poshtë lartë dhe izolohet komplet Ministria e Punëve të Jashtme.

Unë pashë shumë deputetë këtu të Kuvendit, që edhe filluan t'i shpalosin inatet personale ndaj ministrave, presidentit dhe shumë të tjerëve, për t'i akuzuar drejtpërdrejt. Ky nuk është problemi personal, ky është problem shtetëror. Ky është problem i subjektit ndërkombëtar të shtetit, të cilin ne duhet ta trajtojmë seriozisht. Nëse duhet të kthehemi prapa, sikur në institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës, mund të vazhdojmë kështu, nxjerrim një rezolutë dhe shkojmë në shtëpi.

Prapë do të ndodhë një arrestim tjetër. Serbia nuk e ka ndërmend të heqë dorë prej Kosovës, madje edhe Listën Serbe “master Lista serbe”, që është themeluar në Bruksel në marrëveshje me Kosovën, po e përdor si instrument të shtetit të vet. Ky instrument paguhet me lekët e qytetarëve të Kosovës. Cila është kjo politika e dialogut? A paskemi pasur nevojë në pako të na i bien deputetët, të krijohet njëfarë “sovrانيتi politik” brenda kësaj dhome, të cilët e paraqesin Serbinë këtu? Këtë ndërhyrje të brendshme të shtetit duhet ta marrë seriozisht Qeveria dhe kryeministri.

Mendoj se ky është një... arrestimi i Haradinajt nuk është i rastësishëm, është një leksion për liderët kosovarë, është një leksion për ne këtu që jemi deputetë, jo rastësisht, sepse zoti Haradinaj e kundërshtoi demarkacionin, asociacionin e shumë përpjekje të tjera, që Serbia po mundohet të futet brenda. Ne po u dashka ta mbyllim gojën e të mos guxojmë të flasim as në Parlament për këto gjëra!? Po u dashka t'i rrimë “gatitu” bashkësisë ndërkombëtare, e cila po na trajton neve tamam sikur një fëmijë të vogël. Jo!

Bashkësia Ndërkombëtare është duke e keqpërdorur autoritetin e një shteti, i cili ka qenë krizë ndërkombëtare, që është krijuar prej një lufte, sepse ne jemi bërë servilë të tyre. Janë lëvizje të kota të ministrit Hyseni, le të shkojë sa herë të dojë për të hyrë në Interpol, se nuk do e lënë. Janë të kota përpjekjet e ministrit të Punëve të Jashtme, sepse është izoluar nga dialogu. E thanë shumë deputetë dhe ajo që dua të them se duhet të ndërpritet dialogu me Serbinë. Të krijohet një strategji e re kombëtare, shtetërore, pse jo të krijohet edhe një grup uniteti, siç ka qenë më parë. Por, jo me këto referenca që i kemi marrë tash nga zonja Tahiri, sepse një ministri e cila është në kundërshtim me politikën e jashtme, është në kundërshtim me strategjinë politike të shtetit, ta izolojë vendin e vet në këtë formë dhe të dalë e të na paraqesë neve këtu suksese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne që kemi qenë pjesëtarë të UÇK-së, me të vërtetë është e dhembshme, është emocionale kjo, se përditë po arrestohen ata, madje po mbahen peng nëpër burgje edhe në Kosovë, siç është rasti Drenica e raste tjera të luftëtarëve të UÇK-së.

Serbia kurrë s' do të ndalet së akuzuari ne, asnjëherë! Por, ne si shtet duhet të jemi shumë seriozë para qytetarëve tanë, për atë që është votuar kjo Qeveri, ta kryejë detyrën e vet në mandatin që e ka. Përndryshe, ne prapë do të thërrasim seanca të jashtëzakonshme e do të kalojmë prej një



seance të jashtëzakonshme në tjetrën. Kjo është fatkeqësi politike që po i ndodhë këtij vendi, me këtë performansë të dobët të ministrave, me këtë performansë të papjekur politike në raportet ndërkombëtare të shtetit të Kosovës. Më shumë po bëjnë punë shtetet fqinje, Shqipëria e të tjerat, se sa po bëjnë punë institucionet e Kosovës, sepse janë izoluar. Janë vetizoluar me një dialog, i cili na ka sjellë sot këtu. Faleminderit!

Uroj që familja Haradinaj sa më shpejt ta ketë Ramushin në shtëpi dhe ai t'i kthehet jetës politike, t'i kthehet opozitës ku është, se të jesh opozitar është çështje shumë e drejtë, është shumë e mirë, ta thotë qëndrimin e vet e jo të vijë këtu për tu përklarë. Uroj, që sa më shpejt të takohemi edhe me ata të tjerët që janë nëpër burgje e po i mbajnë kot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr Bekim Haxhiu, të bëhet gati Selviqe Halimi.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të fokusohem në diskutimin tim e ndjej për obligim njerëzor dhe qytetar t'i përgjigjem kolegut nga opozita, Albinit, edhe pse ai nuk e ka fort në qejf dhe nuk preferon tu përgjigjet pyetjeve që i parashtrihen, sepse ai i ka ende të hapura disa pyetje dhe dilema rreth tij.

Albini më pyeti, ke pasur mundësi me u dëshmuar në raport me Serbinë. Unë po i them Albinit, që kur ka qenë koha, me tërë qenien time njerëzore jam munduar t'i kundërvihem Serbisë, jam plagosur në luftë. Më vjen keq, që nuk kam vdekur, s'kam pasur fatin të vdes për këtë vend, edhe pse në çdo sekondë të jetës sime kam qenë i gatshëm të vdes. Por, në atë kohë, Albini nuk ka qenë i gatshëm, ai i është dorëzuar Serbisë, nuk është dëshmuar.

Sot nuk është koha për këto divergjenca, sepse unë nuk po dua ta akuzoj as Albinin, as kolegët e tij, pse e lanë Kuvendin pa kuorum, kur ne kishim këtu në Kuvend për të miratuar rezolutën për krimet serbe në Kosovë? Por, është një tentativë për ta zhvendosur, vetë Albini, vëmendjen nga tema për të cilën është thirrur kjo seancë.

Prandaj, unë kërkoj nga të gjithë, që vërtetë të fokusohemi në temën për të cilën është thirrur kjo seancë dhe tu ikim këtyre divergjencave të ngushta politike.

Ndalimi i Ramush Haradinajt e më pas vendimi i një gjykate në Francë për ta mbajtur në paraburgim Ramush Haradinajn është i padrejtë dhe i papranueshëm, edhe pse kjo ndodh në një vend mik, siç është Franca, ku vetë Sarkozy në ligjëratën e tij para nxënësve kishte paralajmëruar njohjen apo lindjen e shtetit të ri të Kosovës.

Urdhërarresti ndërkombëtar ndaj Ramush Haradinajt dhe liderët tjerë shtetëror të Kosovës, është keqpërdorim flagrant i së drejtës ndërkombëtare nga Serbia për qëllime politike dhe destabilizuese të rajonit, duke vënë në lajthitje institucionet e sigurisë dhe drejtësisë në vendet e Bashkimit Evropian.

Ramush Haradinaj është ndaluar dhe po mbahet në paraburgim për çështje, për të cilat ai është gjykuar më parë nga Gjykata Penale Ndërkombëtare dhe është shpallur i pafajshëm. Rasti Haradinaj, ndalimi dhe më pas lirimi i tij në Slloveni në vitin 2015 dhe ndalimi i tij i tanishëm në Francë shpërfaqin asnjë rast tjetër abuzimin e Serbisë me urdhërarrestet ndërkombëtare, që për qëllim ka vetëm destabilizimin e vendit dhe rajonit, sepse kërkesa për ekstradim të Ramush Haradinajt në Serbi është provokim i hapur për destabilizim të Rajonit dhe është provokim i hapur edhe për luftë.

Bashkësia Ndërkombëtare, në veçanti Bashkimi Evropian, duhet t'i përcjellë me vëmendje të shtuar veprimet e fundit të Serbisë për destabilizim të rajonit, me murin në veri, me ndërhyrjet në zgjedhjet në Mal të Zi, me provokimin e konfliktit në Maqedoni, me arrestimin e Nehat Thaçit dhe me kërkesën për ekstradim të Ramush Haradinajt, janë tentativa të dukshme për destabilizim të rajonit dhe përpjekje për të nxitur një luftë të re në rajon.

Ramush Haradinaj, ashtu si edhe liderët tjerë politikë për të cilët Serbia ka lëshuar fletarrestim ndërkombëtar vetëm pse ishin pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Qeveria e Serbisë e din se pas këtyre veprimeve ndalimi apo ekstradimi mund të ketë edhe reagime nga bashkëluftëtarët e tyre, nga përkrahësit e tyre, ku grupet e caktuara në shenjë pakënaqësie mund të nxisin konflikte dhe kjo pastaj do të përbëjë një problem dhe shqetësim të madh, jo vetëm për Kosovën, por edhe për rajonin dhe vendet e Bashkimit Evropian. Çdo shkëndijë konflikti në vendin tonë dhe rajon do të jetë mundësi e involvimit të elementëve ekstremë. Çdo shkëndijë konflikti në rajonin tonë do të përbëjë rrezik potencial edhe për sigurinë në Evropë, sepse çdo shkëndijë konflikti në Kosovë me mundësi të involvimit të elementëve ekstremë ka mundësi të shpërndarjes së këtij konflikti në Maqedoni, në Mal të Zi, në Sanxhak, besa edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë. Kur ndodhemi para një rreziku të tillë, atëherë veprimet e institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë vendore e në veçanti, atyre ndërkombëtare, duhet të veprojmë me maturi dhe përgjegjësi të lartë.

Prandaj, në këtë kohë kur Bashkimi Evropian po diskuton me Serbinë për anëtarësimin e saj në BE duhet t'i bëhet e qartë Serbisë, se me këto politika konfliktuoze nuk mund të jetë pjesë e BE-së dhe se nuk ka vend për të në Bashkimin Evropian pa e njohur Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo do të ndikojë drejtpërdrejtë në sigurinë dhe stabilitetin e rajonit, në të kundërtën zhvillimet në rajon, në të ardhmen, do të jenë të paparashikueshme me këtë qasje aktuale të Serbisë, jo vetëm ndaj Kosovës, por edhe ndaj vendeve tjera të rajonit, sepse Serbia pasi humbi luftën dhe pushtetin në Kosovë, pas pavarësisë të Maqedonisë dhe të Malit të Zi ajo vazhdoi

dhe po vazhdon luftën speciale, si në Kosovë ashtu edhe jashtë saj për të destabilizuar Kosovën dhe vendet e rajonit.

Kemi pasur këto ditë edhe deklarata të zyrtarëve të Qeverisë së Serbisë në raport me njohjen nga Serbia të vetë shtetit të Maqedonisë, që përbëjnë etapa të reja të zhvillimeve në rajon.

Të nderuar të pranishëm,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare, bazuar në vlerat e luftës për liri, luftës së shenjtë për liri dhe partneritetit të përhershëm me shtetet e bashkuara dhe Bashkimin Evropian kanë pranuar si asnjë ushtri çlirimtare më parë, që t'i nënshtrohen drejtësisë në pesë gjykata, një vendore dhe katër ndërkombëtare. Ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u gjykuan dhe po gjykohen nga gjykata e UNMIK-ut, nga gjykata e EULEX-it, gjykata e Hagës dhe gjykata speciale, andaj Serbia nuk ka asnjë të drejtë për të lëshuar urdhërarrestime ndërkombëtare për pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kjo duhet tu bëhet e qartë nga të gjitha mekanizmat vendore dhe ndërkombëtare, sepse edhe ashtu ato janë akuza të fabrikua ndaj pjesëtarëve dhe eprorëve më të lartë të UÇK-së, që janë përpjekje e vazhdueshme e Serbisë për të kriminalizuar Luftën Çlirimtare të popullit të Kosovës dhe për të destabilizuar rajonin.

UÇK-ja ka bërë luftë të drejtë çlirimtare për liri dhe dihet botërisht se kush ka bërë krime dhe gjenocid në Kosovë, në Bosnjë dhe Kroaci. Qëllimi i akuzave ndaj pjesëtarëve të UÇK-së është kriminalizimi i luftës për liri, është kundër shtetësisë së Kosovës dhe njëkohësisht është tendencë për dëmtim të imazhit të Kosovës për të penguar rrugëtimin e saj në Bashkimin Evropian. Akuza ndaj Ramush Haradinajt, ish-kryeministrit të Kosovës dhe shpifjet e Dik Martit ndaj ish-kryeministrit dhe presidentit aktual Hashim Thaçi, kanë një adresë dhe një sponsorizues, që është Serbia dhe ka për qëllim dëmtimin e imazhit të Kosovës dhe kriminalizimin e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Të nderuar të pranishëm,

Është diskutuar këtu edhe sot dhe në disa raste të tilla për ndërprerjen e dialogut me Serbinë. Nuk ishte as vullnet as dëshirë e Serbisë që të dialogojë me Kosovën, me kryeministrin e në veçanti, me kryeministrin e Kosovës që ka shpallur këtu në këtë foltore shtetin e pavarur të Kosovës. Ju kujtoj, se Serbia nuk ka qenë e gatshme të bashkëbisedojë me ne, as në nivelin e organizatave dhe OJQ-ve si Shën Exhidio, e lëre më me ndërmjetësimin e Bashkimit Ndërkombëtar e në veçanti me ndërmjetësimin e BE-së dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Serbia historikisht asnjëherë nuk ka dashur të bisedojë me ne, asnjëherë. Mirëpo, lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ndërhyrja e NATO-s e detyroi atë që të ulet në tavolinën e bisedimeve me palë të barabarta, me Kosovën.

Prandaj, në këtë moment kërkoj dhe është më se e nevojshme, që për interesat e qytetarëve të dialogohet, por tani është më se e nevojshme që formati i bisedimeve me Serbinë të ndërrohet, që të ecim tutje drejt integriteteve evropiane. Është më se e nevojshme, që Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi duhet të përdorë gjithë mekanizmat ligjorë dhe institucionalë që Ramush Haradinaj të lirohet dhe të anulohen nga Interpoli të gjitha fletarrestimet ndërkombëtare për të gjithë pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të lëshuara nga Serbia.

Ramush Haradinaj është mishërim i lirisë dhe Pavarësisë së Kosovës. Ai dhe familja e tij sakrifikuan shumë për lirinë, të cilën ne sot po e gëzojmë. Uroj, që shumë shpejt ish-komandanti ynë, i UÇK-së, Ramush Haradinaj t'i kthehet familjes dhe Kosovës dhe të vazhdojë jetën e tij politike dhe qytetare në Kosovë. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.)*

KRYETARI: Faleminderit, zoti Haxhiu! Zonja Selviqe Halimi, ndërkohë bëhet gati zonja Luljeta Veselaj-Gutaj.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është shqetësuese që si në raport me veprimet dhe politikën e brendshme ashtu edhe me veprimet, gjegjësisht politikën e jashtme, në veçanti dialogut me Serbinë, Kuvendi i Kosovës të thërrasë seanca dhe të merret me pasojat e veprimeve.

A mundet dikush në Kosovë ta justifikojë vetveten kur ne takohemi të merremi me pasojat? Unë mendoj se jo.

Serbia në vazhdimësi është duke abuzuar me të drejtën ndërkombëtare duke vepruar asisoj, që cenon lirinë e lëvizjes së qytetarëve të Kosovës duke detyruar shtetet tjera edhe në arrestimin e tyre. A është kjo e pranueshme për ne? A është e pranueshme për botën demokratike? Unë sërish mendoj se jo.

Evropa dhe bota mbarë e dinë shumë mirë historinë e trevave të Ballkanit e në veçanti trevave shqiptare, të cilën histori dhe të cilën gjendje e kanë pjesë të gjeostrategjive të tyre, qoftë në politikat nacionale, ashtu edhe ato ndërkombëtare. Kur ne u bëmë unikë dhe sublimuam vite e vite përpjekje të popullit për të çliruar këtë vend edhe kjo Evropë edhe kjo botë demokratike u rreshtua pro nesh. Na ndihmuan dhe na përkrahën që të çlirohemi dhe këtë përkrahje dhe këtë ndihmë e bënë në sajë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, jo në sajë të deklaratave, jo në sajë të lutjeve, jo në sajë të kërkesave, por në sajë të veprimeve konkrete.

Si është e mundur, që 16-17 vjet pas luftës tashmë ata aleatë të botës demokratike të përndiqen, të arrestohen, të ndalohen? Pse po ndodhë kjo?

Unë për këtë e kam një përgjigje shumë personale, që ma ndjen zemra dhe dua ta ndaj me ju, kolegë deputetë dhe me ju qytetarë të Kosovës. Ashtu si ne i trajtojmë institucionet e Kosovës, ashtu si ne e vlerësojmë njëri-tjetrin dhe kontributin e njëri-tjetrit, ashtu do na trajtojnë dhe ashtu do na vlerësojnë. Prandaj, si kurrë më parë na duhet një unitet kombëtar. Për çka? Për të rishikuar platformën e dialogut me Serbinë e jo për të gjykuar njëri tjetrin “çfarë bërë deri sot nga çlirimi apo nga shpallja e Pavarësisë”, por t’i shpallim luftën diplomatike, kulturore e juridiksionale Serbisë, duke u thirrur në dokumentet tona shtetërore, në Kushtetutën e Kosovës dhe në ligjet e saj.

Kemi një Kushtetutë më demokratike, se pothuajse të gjitha vendet edhe vetë ato që e krijuan Evropën e Bashkuar dhe tashmë, mbi atë Kushtetutë kemi të drejtë të veprojmë.

Qytetarët e Kosovës nuk janë më qytetarë që mund t’i trajtojë kushdo, kurdo e si të dojë, janë popull që kanë formuar shtetin e tyre dhe dinë t’i dalin zot, por prapë këtu kërkohet një unitet.

Abuzimi me të drejtën ndërkombëtare nga ana e Serbisë, dy vjetët e fundit ka tejkaluar çdo përmasë. Për çdo ditë ne akuzohemi, shantazhohemi e kërcënohemi nga liderët “proevropianë” të Serbisë dhe Serbia heshtë, bota demokratike, BE-ja heshtë, ngritin zërin por jo me veprime konkrete. Përditësohen kriteret për Kosovën në emër të çdo problemi që mund të ndodhë gjatë zhvillimit në cilindo shtet anëtar të BE-së duke iu vu barrë Kosovës. Përditësohen edhe listat e Interpolit me listat e kohës kur Milosheviqi priste dhe grinte njerëz në trojet e ish-Jugosllavisë e në veçanti në Kosovë. Nëse kjo botë demokratike trumbeton dhe kërkon që drejtësia duhet të jetë e ndarë nga politika, atëherë edhe vetë organizata e Interpolit, edhe vetë BE-ja duhet që të ndajë drejtësinë nga politika, të pastrojë listat nga pjesëtarët dhe nga qytetarët e Kosovës, të cilët vetëm politikisht, pse janë shqiptarë, pse luftuan për vendin e vet, pse çliruan vendin e vet, gjenden në ato lista.

Shtetet anëtare të BE-së, shtetet anëtare të Interpolit, nuk guxojnë të veprojnë në bazë të këtyre listave, sepse politikisht po e dëmtojnë drejtësinë, politikisht po e thyjnë një parim të ndarjes së pushteteve. Andaj, edhe një herë, mendoj se duhet të rishikohet platforma e dialogut me Serbinë në të gjitha fushat, të rishikohet dhe të bëhet një vlerësim i të gjitha marrëveshjeve të arritura me Serbinë, se kush, cila palë është ajo që po pengon zbatimin e marrëveshjeve, që po cenon interesat e dy popujve të të dyja vendeve. Dhe, këto të bëhen publike me përmasat, me veprimet e tyre dhe pos kësaj, përveç Qeverisë që e përmendi njëri nga kolegët, që Qeveria vetë t’i drejtohet Francës, unë mendoj që edhe Kuvendi duhet përmes një kërkese vetë, edhe t’i drejtohet vetë Interpolit për spastrimin e këtyre listave edhe t’i drejtohet Francës dhe të gjitha shteteve të

BE-së, që të mos na ndodhin seanca të jashtëzakonshme për raste siç është kjo për zotin Haradinaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Luljeta Veselaj-Gutaj, ndërkohë bëhet gati zonja Flora Brovina.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

E nderuar dhe shumë e respektuar familje Haradinaj,

Lëshimi i fletarresteve nga Serbia për ndalimin e kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotit Ramush Haradinajt dhe ish-luftëtarëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë vetëm politike dhe s'kanë të bëjnë asgjë me drejtësinë dhe me asnjë të vërtetë.

Ky është një veprim i qëllimshëm, i cili po synon që ta destabilizojë vendin duke denigruar imazhin dhe personalitetin e personave të caktuar për ta njoosur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës këtu duke e keqpërdorur edhe Interpolin. Çfarë drejtësie po kërkohet tani?

Në të gjitha proceset gjyqësore, të cilat u zhvilluan në Hagë, çdoherë u vërtetua se zoti Haradinaj dhe lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bashkë me udhëheqësit dhe ushtarët e saj kanë qenë të udhëhequr nga ndjenja e barazisë për liri, për çka këtu u dëshmuar dhe u vërtetua.

A nuk ishte e mjaftueshme kjo, apo ndoshta kjo po suprimon dhe konteston drejtësinë tuaj ndërkombëtare.

Nisur nga funksioni dhe qëllimi i institucioneve gjyqësore, qofshin vendore apo ndërkombëtare, bëjnë drejtësinë mbi bazën e fakteve dhe dëshmive të vërtetuara, por jo të ndikuara nga dëshmitë armiqësore, të fabrikuara me motive politike ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo tani po na bënë të ndihemi të pasigurt në lirinë, në të cilën po jetojmë.

Fletarrestimet e tilla jo vetëm që janë shumë shqetësuese dhe të dëmshme për Kosovën, por ato janë duke e fyer edhe motivin më të vogël për një jetë normale në vendin tonë.

Dialogu është një proces, të cilin ne të gjithë e kemi mbështetur, duke besuar në normalizimin e raporteve fqinjësore, por po ndodh e kundërta. Politika serbe në asnjë mënyrë nuk po shpreh madje as gatishmëri për të vepruar në drejtim të ndryshimit të kursit të saj. Arrestimet e tilla, krejtësisht me prapavijë politike, me aktakuza të sajuara nga regjimi i njohur botërisht, jo që janë vetëm të papranueshme në deklarime, por duhet vepruar kundër tyre në mënyrë të qartë dhe pa asnjë vonesë.

Cenimi i lirisë së lëvizjes së qytetarëve tanë duhet të marrë përgjigje të merituar nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës, sepse nuk është vetëm zoti Haradinaj që po kalon nëpër këtë proces, janë edhe shumë zyrtarë e qytetarë të tjerë të Kosovës, të cilët e kanë lirinë e lëvizjes të cenuar.

Delegacioni shtetëror i Kosovës në dialog që po zhvillon në Bruksel duhet të kërkojë me urgjencë bisedime për çështjen e aktakuzave të ngritura nga koha e regjimit të Milosheviqit në Serbi për qytetarët shqiptarë të Kosovës. Dhe, duke parë se tashmë kemi një sulm direkt, ne duhet të reagojmë me shpejtësi për ta liruar sa më shpejt zotin Haradinaj dhe njëkohësisht të sigurohet qarkullimi dhe jeta e të gjithë qytetarëve të tjerë që të jenë të lirë në lëvizje, pa kurrfarë cenimi.

BE-ja duhet të jetë e angazhuar për të parandaluar qëndrimet dhe veprimet e tilla dhe këto aktakuza duhet të zhvleftësohen në tërësi.

Delegacioni i Kosovës për bisedime në Bruksel duhet të kërkojë prerazi që të kemi një rund urgjent bisedimesh për rastin e aktakuzave ndaj qytetarëve tanë nga ana e shtetit serb.

Unë uroj që zoti Haradinaj sa më parë t'i bashkohet familjes, miqve dhe t'i kthehet detyrës së tij në Kosovë, ndërsa paqes e sigurisë në rajon nuk i nevojitet dhe nuk i kontribuon në asnjë mënyrë kjo sjellje e shtetit serb dhe këto arrestime, krejtësisht politike, e madje as krijimit të raportit të shëndoshë multietnik në vend. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Brovina, e keni fjalën, ndërkohë të bëhet gati Nuredin Ibishi.

FLORA BROVINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë e kolege,

Ramush Haradinaj është hero i kombit tonë, hero i gjallë i lirisë së Kosovës. Gjatë luftës ai i doli zot vendit si bir i denjë i saj. Ai diti t'i mbrojë vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës, kur doli i pafajshëm dy herë pas akuzave që iu bënë nga shteti okupator dhe gjenocidial i Serbisë.

Ndalimi i tij në Francë është një ndalim përtej ndalimi të një heroi. Është përbuzje e lirisë së Kosovës, i shtetit tonë, është provokim dhe karshillëk i shtetit që shkaktoi luftërat në Ballkan dhe që ka për qëllim destabilizimin e Kosovës, e jo vetëm të saj.

Kjo sjellje iu mundësua Serbisë sepse ajo asnjëherë nuk mori shkopin ndërkombëtar, por u shpërblye me karota, me gjithë sjelljen tonë korrekte, ajo pati logjikën e vjetër hegjemoniste, nga e cila nuk hoqi dorë asnjëherë në esencë, duke e shfrytëzuar edhe korrektësinë tonë për fqinjësi të mirë dhe fillimin e bisedimeve në Bruksel.

Po ashtu, asaj iu mundësua, me gabimet tona, edhe përzierja në punët tona të brendshme dhe manipulimi me minoritetin serb në Kosovë si dhe me deputetët e këtij Parlamenti.

Historia dhe metodat e vjetra të Serbisë edhe tani po funksionojnë. Është koha ta kuptojmë këtë dhe të sillemi ndryshe në këtë Parlament dhe të marrim vendime të rëndësishme.

Kjo do të thotë: “Përçaj e sundo”. Gjithnjë kur na përçan, ne kemi humbur, por është momenti të ndërtojmë një platformë nacionale dhe mënyrë tjetër të komunikimit.

Unë në këtë rast nuk dua të zgjas, sepse të gjithë diskutuan gjerësisht gjatë kësaj dite, por kam disa propozime e kërkesa.

Kërkoj nga Qeveria franceze që menjëherë ta lirojë zotin Ramush Haradinaj, në bazë të aktakuzës të vitit 2004 të shtetit të Serbisë dhe Malit të Zi.

Kërkoj që ministri i Jashtëm dhe kryeministri të kontaktojnë menjëherë me Qeverinë mike të Malit të Zi që t’i drejtohet ajo Francës me shpjegime se ky formacion i shtetit të Serbisë dhe Malit të Zi kaqerë nuk ekziston dhe ajo të pranojë se Mali i Zi nuk qëndron pranë kësaj akuze.

Bisedimet në Bruksel tani kanë marrë një formë tjetër. Nuk janë ato bisedime, për të cilat na është thënë. Prandaj, duhet të diskutojmë për ndërprerjen e përkohshme të këtyre bisedimeve dhe transformimin e tyre.

Të diskutojmë për një transparencë dhe të merren vendime që asnjë marrëveshje të mos nënshkruhet para se ajo të dërgohet në Kuvendin e Kosovës dhe të njihemi me të.

Kjo për arsyet që u thanë, sepse shteti ynë ka nënshkruar shumë marrëveshje të cilat kanë mbetur në letër dhe nuk po zbatohen.

Në bisedime të mos ketë përzierje në punët e brendshme të shtetit tonë.

Dhe, gjithashtu, kërkoj që Kuvendi dhe Qeveria t’i drejtohen Interpolit me kërkesë dhe shpjegime që listat për ndalesa të korrigjohen dhe të kemi njohuri më të sakta për to.

Më falni, sepse unë që në fillim desha ta përshëndes familjen e ngushtë dhe të gjerë të zotit Haradinaj dhe të them se ai, edhe në këto momente, e luan rolin e heroit dhe të gjithëve na bashkon rreth një qëllimi, sepse duke e mbrojtur Ramushin të ndaluar në Francë, ne po e mbrojmë Kosovën së bashku me të. Pra, në këtë moment të gjithë jemi bashkë dhe të tillë do të mbetemi edhe pas çlirimit të tij.

Faleminderit!



KRYETARI: Faleminderit, zonja Brovina! Fjalën e ka zoti Ibishi. Le të bëhet gati zonja Blerta Deliu-Kodra.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

E nderuar familje Haradinaj,

Të nderuar qytetarë dhe përfaqësues të mediave,

Kuvendi i Republikës së Kosovës deri më tash ka miratuar 3 rezoluta, me rekomandime. E para kishte të bëjë me mbrojtjen e vlerave të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Rezoluta e dytë ishte me kërkesë për heqjen e fletarrestimeve të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe e fundit nga viti i kaluar përmbante masat kundër tendencave për inkrimimin dhe padrejtësitë ndaj vlerave të luftës dhe luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që vinte nga debati pas arrestimit të zyrtarit të lartë të Policisë së Kosovës.

Tani kur po debatojmë lidhur me arrestimin dhe paraburgimin e kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe ish-komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të Zonës Operative të Dukagjinit, zotit Ramush Haradinaj, me qëllim të miratimit të një rezolutive me rekomandime, po më duket sikur po përsëriten gjërat, si nga përmbajtja me rekomandime të rezolutave të mëhershme, por edhe të vetë rasteve të arrestimeve të vazhdueshme nga fletarrestimet serbe nga Interpoli.

Çka është ndërmarrë deri tash nga kompetencat e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Ministrisë së Drejtësisë dhe agjencive kompetente lidhur me rekomandimet dhe rezolutat e miratuara në këtë Kuvend.

Që moti është pritur se autoritetet komente të Kosovës, në bashkëpunim me vendet mike, duke u bazuar në juridiksionin universal të parimit territorial, këto fletarrestime të hiqen si të pabaza dhe jokompetente për autoritetet e Serbisë për krimet e pretenduara të qytetarëve të Kosovës të kryera në Kosovë, pasi që Serbia asnjëherë s'e ka pasur dhe përfundimisht e ka humbur sovranitetin ndaj Kosovës nga qershori i vitit 1999.

Lidhur me riaktivizimin e fletarrestimeve të Serbisë, të drejtuara Interpolit, është dashur të jenë të informuara institucionet e Qeverisë së Kosovës, duke ndërmarrë masat e duhura të informimit të personaliteteve, sikur është zoti Haradinaj, me qëllim të parandalimit të arrestimeve arbitrare të tij dhe të kosovarëve të tjerë, sikur që ndodhi më parë arrestimi i drejtorit të Policisë Rajonale të Mitrovicës.

Të gjitha këto probleme që po na i sjellin autoritetet serbe në formë simbioze duken sikur piromanët e sëmurë, të cilët ndezin zjarrin që andej brenda dhe jashtë Kosovës, e vetë autoritetet

e Kosovës mundohen të ballafaqohen me rolin e zjarrfikësit, ndërsa bashkësia ndërkombëtare sfidohet me pozitën e tutorit, pa mundësi të ndonjë ndërhyrjeje, duke na sugjeruar se ata janë të tillë dhe të gjithë ne duhet të mësohemi me ta, të bashkëjetojmë me ta me maturi e tolerancë.

E gjithë kjo na kujton thënien e kryenacionalistit serb të Bosnjë e Hercegovinës, do të thotë të kreaturës serbe të Republikës serbe, Dodikut, i cili thoshte se “dikush lodhet i fundit”.

Sot nuk po e përmend fare rolin shumë konstruktiv dhe frytdhënës të autoriteteve të Republikës së Shqipërisë drejtuar autoriteteve të Francës lidhur me lirin e zotit Haradinaj, që është shumë domethënës dhe frytdhënës, është për t’u vlerësuar edhe reagimi i disa deputetëve shqiptarë në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, personaliteteve dhe burështetasve nga Evropa dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Protestat e diasporës tonë në Francë e në vende të tjera të Evropës dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë mesazh i fuqishëm për shkeljen e drejtës ndërkombëtare, lirinë e lëvizjes së qytetarëve të Kosovës, me padi dhe akuza jokompetente e të pabaza të autoriteteve serbe deleguar Interpolit.

Këto fletarrestime jokompetente të pabazuara e të shpifura të Republikës së Serbisë i janë drejtuar Interpolit që nga viti 2005, me disa përsëritje në baza kohore, e deri te kjo e fundit e shpallur para pak ditësh ndaj 20 pjesëtarëve të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndër të tjera edhe për zotin Haradinaj.

Arrestimi i liderit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotit Haradinaj, nuk duhet t’i prekë marrëdhëniet e mira ndërmjet Kosovës e Francës, por ndërmjet Kosovës e Serbisë dhe nevojën e reagimit në Interpol me qëllim të pezullimit të tyre, por edhe të parandalimit të shpalljeve të fletarrestimeve të reja.

Shpresojmë se me këtë angazhim të gjithmbarshëm, zoti Ramush Haradinaj do të lirohet shpejt dhe pa kusht. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Zonja Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën! Le të përgatitet doktori Nehat Baftiu.

**BLERTA DELIU-KODRA:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,  
I nderuar zëvendëskryeministër Kuçi,  
E nderuar familje Haradinaj,  
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është e vërtetë se u thanë shumë gjëra dhe, ndonëse e kam përgatitur një fjalim më të gjatë, do të fokusohem ndoshta në dy-tri pika, meqë kolegët e mi deputetë prekën pothuajse të gjitha shqetësimet që do të duhej të adresoheshin sot në këtë seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit.

Megjithatë, mendoj se lëshimi i fletarrestimit ndërkombëtar nga Serbia kundër Ramush Haradinajt dhe udhëheqësve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk është diçka e cila na ka gjetur të habitur, përkundrazi një gjë e tillë do të mund të pritej nga një shtet që aspak nuk e ka ndërruar qasjen ndaj Kosovës dhe që është mobilizuar në të gjitha frontet për të destabilizuar Kosovën, por edhe gjithë rajonin.

Ajo që është shqetësuese në këtë rast ka të bëjë me faktin se fletarrestimet e motivuara politikisht të Serbisë merren në konsideratë nga institucionet e drejtësisë të shteteve demokratike të Bashkimit Evropian.

Arrestimi i serishëm i zotit Haradinaj në Francë, në bazë të fletarrestimit të lëshuar nga një shtet i cili ka kryer gjenocid në Kosovë, ka krijuar një revoltë të përgjithshme ndër shqiptarë kudo që janë, dhe mendoj se është një revoltë plotësisht legjitime dhe që fatmirësisht deri tani është shprehur kryesisht nëpërmjet formave tejet të arsyeshme të shqiptarëve kudo që janë ata.

Pra, duhet të përshëndesim formën paqësore e demokratike të cilët e kanë dëshmuar shqiptarët në të gjitha manifestimet e pakënaqësive për këtë padrejtësi, sepse kam bindjen e plotë se shqiptarët e kanë kuptuar fare mirë që Serbia është e interesuar për të eskaluar situatën edhe me këtë rast.

Ne si Kuvend, bashkë me institucionet e tjera shtetërore të Kosovës duhet të koordinojmë strategjinë e sensibilizimit të institucioneve ndërkombëtare për rrezikun që i kanoset paqes, stabilitetit, sigurisë në rajon nga politika destabilizuese e Serbisë. Po ashtu mendoj se duhet të merren masa e hapa konkretë, hapa politikë dhe diplomatikë jo vetëm për lirimin e menjëhershëm të zotit Haradinaj, po të bëhet me dije dhe t'u bëhet e qartë edhe shteteve të botës se fletarrestimet e lëshuara nga Serbia për qytetarët e Kosovës janë politike, të cilat kanë për qëllim vetëm e vetëm të destabilizojnë Kosovën, gjithë rajonin dhe Evropën Juglindore. Këtë kemi pasur rast të shohim sidomos gjatë muajve të fundit, ku është vërejtur një fushatë e rëndë e Serbisë karshi qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe që është intensifikuar së fundi edhe me rastin e zotit Haradinaj.

Dhe, krejt para mbylljes së fjalës time, mendoj se, meqë jemi në fund të seancës, dhe kemi mbetur fare pak deputetë në këtë sallë, mendoj se është mirë të krijohet edhe një komision ad-hoc në Kuvend për t'u përcjellë ngjarjet e tilla dhe të koordinohen me Ministrinë e Punëve të Jashtme e me Ministrinë e Drejtësisë për ndihmë dhe përkrahje të mëtutjeshme, nëse është e nevojshme që familja Haradinaj, por edhe raste të tjera që kanë fletarrestime të tilla të sigurojnë një mbështetje prej institucioneve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nehat Baftiu fjala për ju. Le të bëhet gati Nait Hasani.

NEHAT BAFTIU: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Kadri Veseli,  
I nderuar kryeministër,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar deputetë,  
Qytetarë të nderuar,  
E nderuar familje Haradinaj,  
Kosova si shtet duhet t'i kryejë punët e veta. Institucionet përkatëse duhet t'i bëjnë kërkesë zyrtare shtetit të Francës dhe jo deklarime politike për shfaqësim para opinionit.

Ne si shtet duhet në të gjithë organizmat ndërkombëtarë të përfaqësojmë veten. Nuk duhet lejuar asnjë përfaqësim dhe ingerencë të Serbisë për Kosovën, kur janë në pyetje qytetarët, institucionet, pasuritë nëntokësore e mbitokësore, tokën dhe ajri i saj.

Kosova ka qenë trashëgimtare e ish-Jugosllavisë për territorin e saj, në përfitime dhe në obligime.

Konkretisht për zotin Ramush Haradinaj duhet bërë kërkesë zyrtare në Qeverinë e Francës Ministria e Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme, UNMIK-u dhe EULEX-i. Kërkesë konkrete, sepse njeriu mbetet në burg për procedura. Ministria e Punëve të Jashtme duhet të sillt me dinjitet me homologët e vet, sepse Kosova është shtet sovran dhe e pavarur, ka marrëdhënie diplomatike me shtetin e Francës, ka ambasadë dhe do të duhej të ishte e njoftuar për arrestimin e tij.

Kosova është përgjegjëse për qytetarët brenda dhe jashtë vendit. Zoti Ramush Haradinaj ka pasaportë diplomatike të vlefshme, e lëshuar nga kjo Ministri. Pasaporta diplomatike i siguron imunitet bartësit të saj dhe nuk mund t'i merret nga askush tjetër, pra të sekuestrohet nga autoritetet e Francës, sipas Konventës së Vjenës të vitit 1961.

Ministria e Punëve të Brendshme duhet t'i bëjë kërkesë shtetit të Francës, sepse zoti Ramush Haradinaj është shtetas i Kosovës, se disponon me letërnjoftim të vlefshëm, të lëshuar nga kjo Ministri dhe për ndalimin e tij duhet njoftuar autoritetet kosovare për vërtetimin e identitetit dhe validitetit të dokumentit, se në Kosovë është misioni i EULEX-it, misioni evropian për rend dhe ligj, se asnjë qytetar, shtetas i Kosovës, nuk mund të vihet në lista të Interpolit pa kërkesë të shtetit të Kosovës të bërë nëpërmes EULEX-it. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Nait Hasani! Le të bëhet gati zonja Xhevahire Izma. Janë pastaj me radhë edhe dy deputetë.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë,

Kërkesa e kësaj seance për kryetarin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është ndoshta një kërkesë e drejtuar jo bash drejt, sepse ne këtu jemi të mbledhur pikërisht për një listë të Serbisë të çuar në Interpol për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kjo i bie se ne jemi këtu për një komandant të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që ka luftuar kundër Serbisë për çlirimin e Kosovës dhe është pjesë e kësaj liste të Interpolit me kërkesën e shtetit serb që nga 1998 dhe 1999 kur i ka lëshuar listat në Interpol, atëherë edhe kur është larguar nga Kosova si humbëse.

Për ne këto janë lista që i ka lëshuar një shtet dhe që ende pretendon dhe vazhdon me politikën e saj në Kosovë, ndërsa për ne është me interes që ta mbrojmë shtetin tonë.

Për ta mbrojtur shtetin tonë Qeveria jonë është dashur dhe duhet të angazhohet, të kërkojë dhe krijojë mundësi për mbrojtjen e qytetarëve të saj.

Në raportin e prillit, kur është kërkuar për normalizim të marrëdhënieve politike me Serbinë, atëherë është dashur të jetë edhe kjo pikë e listës së Interpolit, që e ka vendosur Serbia për arrestimin e ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Çdo shtet që është pjesë e Interpolit është i obliguar të respektojë marrëveshjet ndërkombëtare dhe, nëse është nevoja, edhe të arrestimit.

Në këtë rast, edhe Shqipëria ka mundur të arrestojë dhe mund të arrestojë, edhe pse ajo ka bërë lëshime në raport me ne. Megjithatë, për ne është me rëndësi që kjo listë e Interpolit dhe ky arrestim të trajtohet si arrestim politik, arrestim që ka ndikim politik, arrestim që Kosova dhe kryeministri ynë, ministrja për Dialog, ta trajtojnë si prioritet listën e Interpolit në bisedimet që i kanë dhe zhvillojnë në Bruksel.

Këto bisedime herë kanë ecur përpara, herë kanë ngecur dhe herë kanë degjeneruar, por megjithatë duhet të kemi një guxim nga kryeministri dhe ministrja, po edhe të kryetarit të Kuvendit që e përfaqëson një parti politike më të madhe në vend, të flasin hapur dhe të kërkojnë herë-herë edhe ndërprerjen e bisedimeve, pikërisht për realizimin e atyre marrëveshjeve.

Nga shumë u përmend asociacioni, muri, arrestimi, fletarrestimi, arrestimi i atij tjetrit, arrestimi i këtij tjetrit dhe të gjitha janë pjesë politike, të cilat Serbia vazhdimisht i bën.

Kosova nuk mund të ecë përpara në këtë formë. Këtë ma kujton ndoshta Kosova që vazhdimisht bën lëshime. Në kohën e Perandorisë osmane, ata që e kanë historinë dhe kanë lexuar, kur thoshin se duhet lëshuar pe, vinin shtetet, shkonin te Perandoria otomane, në atë kohë që për ta

ruajtur perandorinë duhet lëshuar pe, duhet të ngushtohet, duhet ta lëshojnë Sarajevën, tani ta lëshojnë Podgoricën, ta lëshojnë Ulqinin, Tivarin, e tjerë, e tjerë, për ta ruajtur stabilitetin në Ballkan.

Prandaj, deri kur ne do ta ruajmë stabilitetin në Ballkan si shqiptarë, vetëm neve na bie hise kjo? Për të ruajtur stabilitetin në Ballkan duhet të kemi një kryeministër të fuqishëm, duhet të kemi një parlament të përgjegjshëm, duhet të kemi edhe një qeveri po ashtu të përgjegjshme dhe të ndërgjegjshme për mbrojtjen e interesave të shtetit.

Dritëro Agolli ka shkruar, diku 50 vjet më parë, një poezi për mundjen e Lekë Dukagjinit, prandaj kryeministri ynë në kuptimin e sotëm nuk do ta mundte atëherë Lekë Dukagjinin, por do ta ketë Kushtetutën, në mbrojtje të Kushtetutës. Ose duhet ta mbrojë këtë Kushtetutë, ose duhet të tregojë se nuk është i gatshëm ta mbrojë dhe ta lërë këtë vend. Prandaj, kryeministri duhet ta tregojë fuqinë e vet politike, sepse është institucioni kryesor që bën politikën e shtetit. Nëse kryeministri nuk është i gatshëm, nëse partia që e ka prezantuar nuk është e gatshme t'i mbrojë këto politika të shtetit, le të tregojë, mund të shkojmë edhe në zgjedhje, mund të bëjmë zgjedhje të reja dhe të dalim e të shohim kush është ai që mund ta bëjë dhe t'i themi udhëheqjen e Qeverisë apo bajrakun dhe të vendosë një politikë më të mirëfilltë, më stabile dhe më shtetërore për vendin. Shteti ynë nuk mund të ecë kështu, nëse ne këtë vit e filluam me seancë të jashtëzakonshme, e tani kur të fillojmë edhe me Gjykatën Speciale, tani kur të fillojmë edhe me ato krimet për korrupsionin që i folën ata të antikorrupsionit, tani kur do të dalim edhe në procese të tjera, deri ku do të shkojmë kështu. Qeveria po tregohet e papërgjegjshme, Qeveria përgjegjësinë duhet ta tregojë dhe duhet të marrë vendime.

Edhe ministrja për Dialog duhet të jetë më transparente, duhet të tregojë sa janë muret e gjata, ndoshta ne nuk mund t'i kuptojmë ato mure që i kanë ata në Bruksel apo në Serbi, po të paktën përpara edhe në Prizren i kanë thënë ato me shkallë, me kapigjika, ta dimë sa është ai kapigjik i madh, sa është i gjerë, sa metra, ta dimë të paktën a mund t'i kapërcejmë ndonjëherë ata kapigjika. Po për neve është me rëndësi që ky mur, ky rast, po na çon në situata të jashtëzakonshme, e për të ndërruar këtë qasje, këtë mund ta bëjë Qeveria, duhet ta bëjë Qeveria dhe duhet të marrë përgjegjësi Qeveria.

Mendoj që në këto pika që janë propozuar në kërkesën për debat nuk po kërkojmë për një kryetar të një partie, por po kërkojmë që ta kemi ndërprerjen e bisedimeve ose pezullimin e bisedimeve, për shkak se është arrestuar nga një fletarrestim i Interpolit lëshuar nga Serbia, kryetari jo, po komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, zoti Ramush Haradinaj. Prandaj edhe Qeveria duhet të ketë përgjegjësi pikërisht për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, sepse përndryshe kishim pasur një qeveri në ekzil, nuk e kishim pasur Qeverinë këtu. Prandaj, pikërisht lufta është ajo që na ka ofruar, lufta na ka bashkuar, lufta na ka sjellë në këtë sallë këtu në një mbledhje të

jashtëzakonshme, të diskutojmë për mbrojtjen e atyre vlerave të luftës sonë, këto vlera po kërkohet me anë të një rezolute.

Unë shpresoj që kjo rezolutë do të jetë sikur rezolutat e tjera që i kemi miratuar në këtë Kuvend. Ne kemi miratuar edhe rezolutat për krimet që i ka bërë Serbia disa herë, kemi diskutuar për krimet që i ka bërë Serbia në Burgun e Dubravës, ku janë të vrarë me emra e mbiemra mbi 120, janë të akuzuarit po ashtu me emra e mbiemra që nuk është marrë asnjë veprim, të gjitha këto janë trajtime të cilat rezoluta i kemi miratuar dhe nuk janë trajtuar apo nuk ka pasur efekte politike.

Uroj që kjo rezolutë të ketë një efekt politik dhe komandanti i Ushtrisë Çlirimtare, zoti Ramush Haradinaj, të lirohet, që të jetë pjesë e kësaj politike, e angazhimit politik, të jetë edhe ai pjesë e angazhimit të pastrimit të këtyre listave.

Mendoj, zoti kryetar i Kuvendit, je përfaqësues politik i partisë më të madhe, kështu derisa nuk shkojmë në zgjedhje jemi. Prandaj, po kërkoj që ta ushtrosh ndikimin tanë politik si kryetar i Partisë Demokratike, si kryetar i Kuvendit, dhe me të gjithë mekanizmat politikë të ndikosh që ky rast të trajtohet si politik e të zgjidhet sa më shpejt që të jetë e mundshme. Mundësisht para se ta lirojnë ata në Francë atje, sepse ne nuk kemi fuqi ose kapacitet t'i shpallim luftë askujt, po ne kemi kapacitet të mbrohemi dhe ta mbrojmë vendin tonë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, Nait! Zonja Xhevahire Izmaqu, fjala për ju, të bëhet gati zoti Nezir Çoçaj, e i fundit nga diskutuesit është Hajdar Beqa.

**XHEVAHIRE IZMAKU:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë,

E nderuar familje e zotit Haradinaj,

Më lejoni që edhe unë si deputete e këtij Kuvendi të shpreh mllefin dhe indinjatën time me rastin e arrestimit të zotit Haradinaj. Po ashtu më lejoni të kërkoj falje nëse do të përsëris fjalët e kolegëve, po sigurisht që ne jemi në një temë të njëjtë dhe mund të kemi edhe gjykime të njëjta mbi këtë rast.

Para se të nisja të shkruaja këtë fjalim, fillova të kërkoj në arkiv datën e seancës së fundit kur e kemi mbajtur një të tillë në Kuvend për liderin e AAK-së dhe te rubrika “Kërko” te emri i tij fatkeqësisht hasa në disa fjalime në kundërshtim që ishte dashur t'i bëj edhe unë si deputete brenda një periudhe të shkurtër për këtë njeri që nga paslufta trajtohet rëndë nga organet ndërkombëtare të drejtësisë, e shpeshherë, më mirë të themi, ndoshta të padrejtësisë.

Për të rikujtuar dhe për të përsëritur, ky njeri në momentin e shpalljes së aktakuzës nga Gjykata e Hagës pati dhënë dorëheqje nga pozita e kryeministrit dhe nuk i bëri dy fjalë që t'i bishtnojë drejtësisë, por u përball hap pas hapi me akuzat duke ruajtur krenarinë e të qenët luftëtar i vendit të vend deri në momentin e shpalljes së pafajësisë.

Po ashtu arrestimi tjetër në Lubjanë mbi akuzat e gjykatës serbe, një shteti, i cili po të kishte mundësinë besoj që pak nga ne do na linte gjallë këtu, por edhe ata që ishim sigurisht do të na shtinte në burg. E çka ndodh tani? Ne presim burgosjen e përsëritshme të këtij luftëtari përsëri mbi akuzat e njëjta të një shteti që me gjak u detyruam të lajmë ndarjen nga ai.

Po ta kthejmë pas kokën, ka vetëm dy dekada që e mbarë bota u detyrua të çohet në këmbë për të ndalë hovin e masakrave që ky shtet përdori kundër popullatës civile në këto troje.

Po të kishte një logjikë kjo drejtësi dhe kjo politikë, pra, nuk ishte dashur që brenda 10 vjetëve kreu forcat ushtarake të botës në këtë rajon të kthejnë vëmendjen në këtë pjesë të Ballkanit, e po nga ky terror që na ra hise, edhe Franca ndërhyri me forcat e veta në çlirimin e vendit tonë, kuptohet si pjesë e forcave të NATO-s.

Unë si banore e komunës së Vushtrrisë në jetën time kurrë s'do ta harroj datën 17 qershor. Për faktin se pas tre muajve kam kaluar këmbë lagjen time, duke dalë i lirë në rrugë për të mirëpritur forcat e KFOR-it, e ku ushtarët francezë ishin ata që na e dhanë lajmin e parë për liri dhe marrje frymë.

Ushtarët e kontingjentit francez ndanin me ne emocionet e dhimbjet për ato që kishim kaluar, por e dhanë ndihmën e madhe me të gjitha mjetet për të rimëkëmbur jetën tonë në atë pjesë, hapjen e spitalit ushtar francez, ku me mijëra banorë vushtrrias, po edhe nga gjithë ai rajon morën ndihmën e munguar për muaj me radhë, pasi ishim të rrethuar në mungesë edhe të barnave.

Sot, 17 vjet pas, kur Franca e njehë dhe e trajton si shtet vendin tim të pavarur, bënë paralelisht dy gjëra. Më njeh si një shtetase të një vendi të lirë e të pavarur dhe e njeh edhe të drejtën e ligjit të një shteti tjetër mbi një bashkëqytetar timin.

Cili është kuptimi këtu i njohjes së drejtësisë dhe i pavarësisë? Serbia do të vazhdojë të ngrejë me këtë mendësi politike akuza pa mbarim, nëse ju, të nderuara shtete mike, do të harroni se kush ishte Serbia në këtë fund shekull, sigurisht e kuptoj logjikisht se nga ana ligjore Franca është në rregull në këtë proces, por nga ana njerëzore dhe nga ana e të drejtave të njeriut në aspektin ndërkombëtar po arrestohet një person për një vepër për të cilën u gjykua dhe u shpall i pafajshëm ndërkombëtarisht.



Ju nuk duhet të përdorni fletarrestimet serbe tutje për raste të tilla dhe ne si deputetë po kërkojmë direkt që BE-ja të kërkojë urgjent nga Serbia dhe jo, për shembull, si deklarata që për mua ishte befasi sot e Mogerinit që të kërkojë që Kosova me bisedime të bëjë arritje të marrëveshjes në aspektin e tillë, kur dihet që është pamundur me Serbinë të arrihen këto marrëveshje pa pasur një prezencë edhe një monitorim, një kujdestari ndërkombëtare.

Ne si qytetarë të vendit, por edhe si deputetë të këtij Kuvendi sigurisht se besojmë në drejtësinë franceze, por assesi nuk besojmë në qëllimin e ulët të politikës serbe dhe nuk duam që nga ky rast të lëndohet kjo miqësi e krijuar dhe ky partneritet mes Kosovës dhe Francës.

Andaj, ne presim që sa më shpejt të kemi në vend zotin Haradinaj. Ne e presim që drejtpërdrejt politika franceze të ndikojë në këtë proces, sepse ky është arrestim politik, edhe pse kjo u thirr në akte të vënies në vend të një drejtësie që ky njeri e sprovoi me jetën e vet sa e sa herë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Çoçaj, fjala për ju. Ndërkohë u lajmërua edhe Sala Berisha-Shala, Hajdar, prapë i fundit, e përmyll.

NEZIR ÇOÇAJ: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

I nderuar zëvendëskryeministër Kuçi,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

E nderuar familje Haradinaj,

Ndalimi i ish-kryeministrit Haradinaj për ne si shtet dhe si shoqëri është i papranueshëm, sepse dihet mirëfilli roli dhe kontributi i tij dhe i familjes së tij për çlirim dhe shtetndërtim të Republikës së Kosovës.

Ky veprim nuk ndihmon as politikën që e kanë shtetet evropiane për dialogun dhe vazhdimin e tij për ndërtimin e raporteve të fqinjësisë së mirë mes shteteve. Kjo është e papranueshme, e paarsyeshme që këto shtete evropiane, të cilat kanë dhënë kontribut të madh në çlirimin dhe shtetndërtimin e Kosovës, të ndikojnë negativisht në situatën e krijuar së fundit.

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Aktivizimi dhe aktualizimi i këtyre ndalesave pikërisht në këtë kohë shihet më qartë se Serbisë i pengon avancimi i shtetësisë së Kosovës, i pengon dialogu, normalizimi i raporteve dhe marrëdhënieve në Ballkan, i pengon nënshkrimi nga Kosova i marrëveshjeve kontraktuale me BE-në, e të tjerë.

Po ashtu ditët e fundit deklaratat e zyrtarëve të lartë serbë që deri dje ishin bashkëpunëtorët më të ngushtë të “kasapit të Ballkanit” janë shumë shqetësuese dhe tendencioze.

Mirëpo, ajo çfarë ne duhet të ndërmarrim si shtet, i cili me shumë peripeci është ndërtuar, duhet të jemi të paluhatsëm që të vazhdojmë dhe ta konsolidojmë edhe më shumë, ashtu siç deshën shumë veprimtarë e patriotë, e pa dyshim ndër ta ishte edhe zoti Haradinaj. Zoti Haradinaj është përballur disa herë me drejtësinë vendore dhe ndërkombëtare, por çdo herë ka dalë i pafajshëm.

Kjo ndalesë nuk duhet të nënkuptojë që mund t'i bëjë presion që ky të heqë dorë nga idetë dhe pikëpamjet e tij personale dhe politike. Thjesht, me këto presioni nuk mund "të vetëdijesohet" askush, e aq më pak një luftëtar dhe komandant i UÇK-së i kalibrit të zotit Haradinaj.

Të nderuar kolegë deputetë,

Miqtë tanë ndërkombëtarë një herë dhe përfundimisht duhet ta thonë fjalën e tyre se Serbia, politikanët dhe strukturat e tjera të saj janë ata që duhet të ndiqen për krimet e kryera në Kosovë e më gjerë.

Fatkeqësisht, disa nga ndërkombëtarët e kanë përcjellë politikën e mbrapshtë të Serbisë tek ne dhe shtetasit tanë. Mendoj se ky është momenti i fundit që të qartësohet edhe politika evropiane, e jo të jetë në shërbim të politikës kontroverse serbe.

Në fund bëjë thirrje tek institucionet tona dhe mekanizma ndërkombëtarë që sa më shpejt të kthehet zoti Haradinaj, e të mos ketë raste të tilla të ndalesave me fletarrestime të Serbisë neomilosheviqiane. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Zonja Sala Berisha-Shala. Faleminderit, për mirëkuptim!

**SALA BERISHA-SHALA:** Faleminderit, kryetar!

Përsëritet, të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar familje Haradinaj,

Së pari kërkoj falje që ndoshta po i bien se u lajmërova me vonësë, mirëpo kartela ime kishte qenë e çaktivizuar dhe u detyrova ta shtyp edhe një herë butonin.

Sidoqoftë, do të përpiqem shumë shkurt ta them fjalën time dhe pjesën tjetër ta dorëzoj me shkrim, sepse të gjithë kolegët e mi deputetë, shumica prej tyre i thanë ato që edhe unë e kisha në plan t'i them.

Nuk ka asnjë inskenim dhe nuk ka asnjë rast që ne si qytetarë të Kosovë do të na lëkundë në luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse e dinë të gjithë se kjo luftë ishte një luftë çlirimtare dhe duke qenë si e tillë, ajo fitoi përkrahjen e gjerë të botës demokratike, e cila përkrahje ka kulmuar me ndërhyrjen e trupave të aleancës më të fuqishme në botë, siç është NATO-ja dhe si rezultat i kësaj mbështetjeje qytetarët e Kosovës e fituan lirinë e shumëpritur me breza të tërë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi para një situatë të tillë që me fletarrestime të padrejta ndaj qytetarëve tanë dhe sidomos çlirimtarëve tanë sfidohemi si shtet dhe sfidohemi edhe si ligjvënës dhe nuk është aspak shije e mirë që vitin 2016 e përfunduar me një seancë të jashtëzakonshme dhe 2017-ën e filluar po me një seancë të jashtëzakonshme. Uroj që të mos kemi seanca të tilla të jashtëzakonshme, po t'i kthehemi punës sonë normale si Kuvend.

Pa dyshim që këto fletarrestime dhe keqpërdorimi i Interpolit dhe Europolit nga Serbia, ndërtimi i murit dhe veprime të tjera të shumta të ngjashme nuk janë qëllimmira. Këto kanë një tendencë që të ngrenë tensione e dhunë, po ndoshta edhe qëllime të tjera.

Jemi dëshmitarë të asaj se zoti Haradinaj prej neve qytetarët e Kosovës është një çlirimtar, është një hero, i cili i ka sfiduar edhe betejat e luftës, po edhe betejat e paqes duke dalë i pastër nga gjyqet e njëpasnjëshme.

Të nderuar kolegë deputetë,

Jam munduar t'i përcjell me vëmendjet diskutimet e secilit dhe nuk më vjen mirë që shpesh ka pasur orientime që të keqpërdoret edhe kjo seancë, edhe kjo foltore, për inate personale dhe partiake.

Andaj, ky rast, më shumë se çdo rast tjetër, duhet të na shërbejë të gjithëve që t'i tejkalojmë inatet personale, dallimet partiake e të punojmë bashkërisht ta forcojmë shtetin, t'i forcojmë miqësitë me shtetet që e kanë njohur Kosovën dhe të vazhdojmë të llobojmë edhe për shtete të tjera që s'e ka njohur Kosovën.

Të mos harxhojmë energjinë kundër njëri-tjetrit, natyrisht që duhet të jemi kritikë ndaj punës sonë dhe institucioneve tona, duke kërkuar përgjegjshmëri në detyrat tona shtetërore.

Rasti Haradinaj dhe raste të tjera, ku preken vlerat, dinjiteti dhe interesat tona nacionale dhe shtetërore, më shumë duhet të na shërbejë që të jemi bashkë, se sa të jemi të përçarë dhe të ndarë.

Krejt në fund uroj që zoti Haradinaj t'i kthehet familjes, t'i kthehet Kosovës, t'i kthehet punës së tij, edhe partisë, edhe demokracisë, se partia e tij është një larushi, një ngjyrim politik që është në të mirën e demokracisë. Faleminderit!

*Diskutim i dorëzuar me shkrim*

NAIM FETAHU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Vazhdimi i ekzistimit të fletarrestimeve nga Serbia në Interpol për ish-ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është krejtësisht i papranueshëm. Arrestimi i zotit Haradinaj në Francë është lajm i keq për Kosovën.

Institucionet e vendit duhet angazhuar më shumë, që të hiqen të gjitha këto fletarrestime që janë bërë nga politika milosheviqiane kundër çlirimtarëve të Kosovës.

Është edhe më skandaloz fakti i ekzistimit të atyre fletarrestimeve ndaj atyre për të cilët është dhënë pafajësia nga Gjykata e Hagës. Ekzistimi i këtyre fletarrestimeve është kundër vlerave demokratike e liridashëse, sepse në mbrojtje të popullatës civile në Kosovë, përpos UÇK-s u rreshtua edhe NATO dhe gjithë faktori ndërkombëtar liridashës.

Franca është shtet ynë mik dhe si i tillë do të mbetet. Ne çojmë lartë kontributin e shtetit dhe popullit francez në çlirim dhe shtetndërtimin e Kosovës dhe ky rast nuk do të luhasë aspak këtë miqësi dhe konsideratë tonën. Por, njëkohësisht kërkojmë nga drejtësia dhe politika franceze që të ketë në konsideratë faktet, si ato gjyqësore të Gjykatës së Hagës, e po ashtu edhe faktet e njohura edhe për vetë Francën se ne luftuam për liri.

Zoti Haradinaj padrejtësisht po përballet me këto sfida e të cilat janë prodhim i kuzhinave famëkeqe të politikës së Milosheviqit andaj ai duhet sa më parë të lirohet dhe t'i bashkohet familjes, politikës dhe Kosovës në tërësi.

Besojmë fuqishëm që shumë shpejt Ramush Haradinaj do të lihet i lirë nga ky ndalim. Njëkohësisht, kjo duhet të jetë kampion për institucionet që të punohet edhe më shumë, edhe përkundër faktit se akoma nuk jemi pjesë e INTERPOL-it, që të hiqen këto fletarrestime. Në të njëjtën kohë, bisedimet me Serbinë me veprimet e tyre po i sfidojnë çdo ditë e më shumë vetë serbët. Duhet urgjentisht të jetë temë diskutimi kjo pikë në Bruksel ose me automatizëm të aplikohet masa e reciprocitetit, madje edhe për zyrtarët serbë, të cilët me deklaratat e tyre po nxisin konflikte dhe probleme të reja.

Fare në fund, uroj që Ramush Haradinaj sa më parë të jetë me ne dhe të ndalen këto padrejtësi ndaj çlirimtarëve të vendit.

**KRYETARI:** Faleminderit! Zoti Hajdar Beqa, faleminderit për mirëkuptim, fjala për ju!

**HAJDAR BEQA:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

I nderuar zëvendëskryeministër Kuçi,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Dhe e nderuar familje Haradinaj,

Ne sot jemi mbledhur këtu si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për një shqetësim jo vetëm të familjes Haradinaj, por për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe besoj për të gjitha institucionet e Kosovës.

U tha shumë nga të gjithë parafolësit, u thanë fjalë të mira, por konsideroj që rezoluta që nxirret sot nga ky Kuvend duhet të jetë obliguese, e zbatueshme për Qeverinë, e të mos mbetet si të kaluarat, apo të diskutojmë në seanca të jashtëzakonshme, po të marrim hapa preventivë, paraprakë, të mos mbesim pasi të ndodhin ngjarjet të marrim kësi vendimesh. Mendoj që duhet të dalim edhe ne në sulm, të mos mbesim çdo herë si shtet në mbrojtje.

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare është vërtetuar se ishte e drejtë dhe e pastër, ne jemi krenarë që kemi luftuar kundër regjimit të Milosheviqit dhe kemi luftuar për lirinë e vendit tonë.

Lufta jonë u vërtetua si luftë e drejtë në dy rrafshë nga bota demokratike, me ndërhyrjen e NATO-s dhe me lirimin e çlirimtarëve nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

Ne e konsiderojmë se është i papranueshëm ndalimi i ish-komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për zonën e Dukagjinit, zoti Haradinaj dhe kryetarit aktual të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, nga një shtet mik, siç është Franca, për shkak të një fletarrestimi të lëshuar jolegjitim nga Serbia në vitin 2004.

Kosova dhe institucionet e saj është dashur dhe duhet që nëpërmjet bisedimeve në Bruksel dhe shteteve mike të bëjë ç' është e mundur që Interpoli të mos i shpërndajë fletarrestimet e lëshuar nga Serbia. Në gjë e tillë mund të bëjë Interpoli dhe ka praktika, kjo vlen për raste kur mandat arrestet janë politike dhe ky rast i ndalimit të zotit Haradinaj konsideroj që është shumë politik.

Kemi raste kur vetë Interpoli dhe Franca ka refuzuar t'i zbatojë urdhrat e tilla, siç kemi rastin gjatë Konferencës Ndërkombëtare të Rambujesë, ku vetë lideri i UÇK-së, zoti Thaçi, ishte i dënuar me 10 vjet burgim nga Gjykata e Serbisë për veprime armiqësore ndaj regjimit të shtetit serb. Edhe pse kishte kërkuar shteti serb i asaj kohe të ndalohej zoti Thaçi, Franca dhe Interpoli nuk e bënë një gjë të tillë.

Ne duhet të kemi parasysh që Serbia është shumë e interesuar të krijojë situata që Kosova dhe Franca t'i zbehin marrëdhëniet e mira që i kanë mes vete.

Qeveria e Republikës së Kosovës është dashur dhe duhet që nëpërmjet dialogut në Bruksel t'i kushtëzojë bisedimet me Serbinë me pastrimin e listave, lista këto që Serbia i aktivizon sa herë t'i duhen për interesa politike të veta.

Siç dihet, këto fletarrestime për një kohë ishin të pezulluara, kurse Serbia për interesa të veta apo për të përfituar politikisht i ka aktivizuar në korrik të vitit 2016.

Serbia dhe regjimi i Milosheviqit kanë bërë krime në Kosovë, kanë vrarë gra, fëmijë e pleq, kanë masakruar dhe kanë dhunuar, kanë shpërngulur nga shtëpitë e tyre mbi një milion banorë të Kosovës, kanë djegur shtëpitë, kanë vjedhur pasurinë e shqiptarëve dhe kanë bërë gjithçka të keqe që kanë mundur ta bëjnë ndaj qytetarëve të Kosovës.

Edhe institucionet e drejtësisë në Kosovë duhet të ngrenë aktakuza për të gjithë ata që kanë marrë pjesë në krimin ndaj popullatës në Kosovë dhe atyre që kanë qenë pjesë e aparatit shtetëror të Milosheviqit, siç është rasti me Nikoliqin dhe Daçiqin.

Institucionet e Kosovës duhet të përdorin të gjitha mekanizmat shtetërorë që të ofrojnë garanci për lirim të shpejtë të zotit Haradinaj. U tha këtu nga kryeministri dhe ministrat gjegjës për hapat që i kanë marrë, po konsideroj që duhet të jetë niveli më i lartë i komunikimit mes dy shteteve, sepse një gjë e tillë është e papranueshme edhe për qytetarët, edhe për institucionet, të mbetet ish-komandanti apo lideri i një subjektit parlamentar në burg me një fletarrestim joligjor.

Po ashtu këtë çështje duhet ta shtrojmë urgjentisht nëse do të vazhdojnë bisedimet në Bruksel dhe të kërkojmë anulimin e menjëhershëm të të gjitha atyre vendimeve politike dhe të paligjshme të fletarrestimeve të lëshuar nga gjykatat në Serbi, sepse Serbia nuk ka juridiksion mbi Kosovën dhe qytetarët e saj. Në të kundërtën, nuk kanë bisedimet asnjë vlerë për të vazhduar, sepse këto bisedime konsideroj se duhet të përfundojnë në të mirën e Kosovës, jo të ndodhë e kundërta.

Deri më tani në shumicën e rasteve ne kemi bërë shumë kompromise për ndërtimin e raporteve të mira, kurse jemi i vetmi vend që na mohohet e drejta elementare, e drejta e lëvizjes së lirë. Jemi i vetmi vend në rajon që ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës aplikohet regjimi i vizave.

Krejt në fund uroj që zoti Haradinaj të jetë pranë familjes, pranë Kosovës dhe institucioneve të saj sa më shpejt dhe Qeveria e Republikës së Kosovës nëpërmjet mekanizmave të bëjë ndikimin e vet të duhur.

Uroj që rastet të tilla të mos përsëriten dhe shpresoj shumë se qasja e Qeverisë ndaj këtij fenomeni të ndryshojë rrënjësisht dhe shpresoj që Kosova të anëtarësohet në Interpol në një të ardhme të afërt. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, ndërkohë e ka kërkuar fjalën. Jemi te pjesa përfundimtare e seancës. Kisha kërkuar nga Administrata të dihet gjendja e kolegëve deputetë.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe ashtu disa minuta njerëzit duhet t'i lexojnë propozimet për rekomandime, sepse vetëm sa arriti fleta, sido që të jetë, unë dua t'i them disa fjalë, aq më tepër që kam pasur durimin t'i dëgjoj bash të gjithë dhe nga pak të mbaj shënime.

U tha disa herë këtu që edhe me bisedime, edhe me veprime Qeveria po e sjell Serbinë në Kosovë. Më lejoni të them që Serbia Kosovën në tërësi s'e ka lëshuar kurrë dhe këtë e dini edhe ju, si unë dhe e dinë të gjitha Qeveritë që e kanë udhëhequr Kosovën deri tash.

U tha dhe dëgjova përfaqësues të lartë të Kosovës të diskutojnë këtu dhe të japin vlerësime çka duhet të bëjë Qeveria, kjo që është tash. Krejt në rregull është, çdo kohë deputetët duhet të japin idetë e veta, po unë do të thosha, me që sot po flitet duke diferencuar qytetarët për luftëtarët dhe komandantët, do të jap evidenca. Nganjëherë të vërtetat duhet të përsëriten, se harrohen.

Prej gjashtë kryeministrave që i ka pasur Kosova pas luftës, katër kanë qenë komandantë, dy s'kanë qenë komandantë, po them të deklaruar, sepse unë nuk jam ai që shkruan biografi, po në bazë të biografive që i kanë paraqitur vetë, katër me dy.

Në Kuvendin e Republikës së Kosovës kryetari i Kuvendit, a 'spiker' i thonë të tjerët, ne i themi kryetar, sepse e konsiderojmë funksionar të lartë të shtetit, ka të tjerë që s'e konsiderojnë, si do që të jetë, i kemi dy me dy.

Kryetar i shtetit i zgjedhur prej se zgjidhet kryetari në legjislacionet e pasluftës, i deklaruar komandant, është një prej treve, edhe një nuk e di a është deklaruar komandant, po thotë që është edhe ai i luftës. Pra, kryeministra janë Bajram Rexhepi, Ramush Haradinaj, Bajram Kosumi, Agim Çeku, Hashim Thaçi, Isa Mustafa.

Kryetar Kuvendi janë Nexhat Daci, Kolë Berisha, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli. Kryetarë të Kosovës: Ibrahim Rugova, Fatmir Sejdiu, shkurt Behxhet Pacolli, Atifete Jahjaga me konsensus total, edhe i fundit Hashim Thaçi. Pse po i përmend emrat, është mirë të përmenden, është mirë, sepse të vërtetat, të dhënat, nuk lënë të gabosh kurrë.

Kjo është përbërja e udhëheqësve të tri institucioneve për gjithë këtë kohë. Ky është një proces, është gabim, sepse kjo gjendje, edhe kjo për çka po bisedojmë sot është rezultante e gjithë këtyre njerëzve e gjithë këtyre viteve dhe ju këtu mund ta shihni më mirë që të gjithë këta njerëz, në momente të caktuara, kanë marrë vendime që sot duken të drejta ose jo të drejta, por mua më shtini dëgjimi i kujdesshëm i të gjithëve të veproj kështu për shkak se është interesant qysh seleksionojnë, edhe përmendin sende strikt, duke i pasur parasysh njerëzit në kohë dhe analizojnë momente kur gjoja se s'i kanë pasur njerëzit e vet, e ata janë njerëzit që kanë udhëhequr Kosovën.

Të gjithë e kanë një filiacion biografik, politik, e të tjera, por në momentin kur marrin funksione të larta përfaqësuese, ata janë përfaqësues të Kosovës dhe përgjegjës të saj. E tash, unë po ia përmend emrin zotit Albin Kurtit që e pati një diskutim interesant që më pëlqeu, sepse donte të bëjë evidenca, edhe ai u nis nga votimet. Po, e pranoj atë mënyrë diskutimi, veçse nëse merret parimi, edhe për Kurtin dhe të gjithë që janë këtu, sidomos ata që janë deputetë më shumë në legjislaturë. Ju kisha lutur, bëjeni analizën e plotë dhe mos seleksiononi, po e zëmë, marrëveshjen e famshme me Serbinë para tre vjetëve, se datën fort s'e mbaj mend, por gjendet data. Është e qartë qysh është votuar, çka është folur këtu, të gjitha janë të regjistruara. Unë e përmenda edhe këtë për shkak, jo për të thënë diçka të veçantë, se fundi i fundit, shumica këtu e krijon atë që unë asokohe i thosha të mos votoni me fuqi kushtetuese, por dikush kuptonte, dikush s'kuptonte, punë për ta.

Por, tash nuk mund t'i mohojmë sendet që i kemi bërë nëpër legjislaturë. Ai që i ka bërë, qysh i ka bërë, kjo ishte kaq, jo Albin, për të bërë replikë, por me të vërtetë për të hyrë në logjikën e kësaj që po flas unë, domethënë kjo është rezultante e një kohe, e marrëdhënieve të ngritjeve-rënieve, por unë nuk kisha pasur guxim t'i personalizoj me dikë, qoftë për mirë, qoftë për keq.

Dhe, zoti kryetar, më lejo, jam për nga natyra e bonsensit edhe e detyrës që e kam unë jam kryetar i Grupit të Miqësisë Kosovë - Francë dhe më lejoni që edhe këtë rast, me gjithë lakesat që u bënë, unë nuk jam i zoti të flas për politikën strategjike të asnjë vendi, e aq më tepër edhe të Francës. Por më lejoni që si njeri i këtij grupi të miqësisë ta them në Kuvend, i Kuvendit, jo i Kosovës, po i Kuvendit, se këto janë grupe të Kuvendit, përtej nuk shkojnë, prapë vetëm t'i them dy evidenca: që Republika e Francës ka qenë protagonist e aksionit ndërkombëtar për shpëtimin e popullit të Kosovës dhe për lirinë e Kosovës në vitin 1999, që Republika e Francës e ka njohur Republikën e Kosovës në vitin 2008 dhe që Republika e Francës e ka ndihmuar shumë në një konsorcium të parlamenteve evropiane Kuvendin e Kosovës në vitet e para, besa disa vjet, të organizimit të tij demokratik.

Dhe, në funksion të këtij artikulli, unë them që presim, patjetër presim që Republika e Francës do t'i përshpejtojë procedurat që e bëjnë të mundur lirimin e Ramush Haradinajt. Sa për seanca të jashtëzakonshme s'kemi pse e dramatizojmë, jemi në deputetët, duke i falënderuar një demokracië parlamentare, që është e brishtë, por ekziston te ne që i kemi thirrur të dyja këto seanca të jashtëzakonshme, kurrkush s'na i ka thirrur. Ne duhet të themi "bravo" se i kemi thirrur dhe i kemi bërë dhe kjo është ajo që quhet në demokraci 'fuqi e Parlamentit', e tash çka prodhojnë kjo është punë tjetër, por s'kemi pse ankohe mi për seanca të jashtëzakonshme që i kemi thirrur ne vetë, Parlamenti.

Dhe, në fund unë do të thosha ne si njerëz jemi të njohur, na thonë të tjerët, edhe ne i themi vetes që jemi mikpritës dhe kjo është një virtyt, me siguri, do të thosha është mirë nëse njerëzit fillojnë



të na thonë mirënjohës, që është një virtyt shumë i mirë. Frikohem që nga rasti në rast nuk jemi mirënjohës ndaj vetes, plus edhe ndaj të tjerëve që na kanë bërë punë të dobishme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti nënkryetar! Tani jemi në përfundim të diskutuesve, zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Hajredin Kuçi, do ta ketë fjalën, si përfaqësues i Qeverisë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Natyrisht se thirrja e kësaj seance besoj me një konsensus nacional nga të gjitha partitë politike tregon edhe peshën e diskutimit që ka kjo temë, mbi bazën e asaj që unë do ta quaja konsensus nacional. Jam i bindur që edhe thirrësit e kësaj seance, në koordinim të plotë me të gjitha subjektet politike, por edhe me Qeverinë e Kosovës, kanë pasur dhe kanë për qëllim që ta ndihmojnë çështjen, në këtë rast të zotit Ramush Haradinaj, po do të thosha edhe çështjen në tërësi të fletarrestimeve që kanë të bëjnë me pjesëtarët e UÇK-së.

Më lejoni të them që angazhimet që u përmendën edhe më herët, duhet t'i kemi parasysh ndoshta edhe qasjen politike dhe juridike që duhet të kemi. Në fillim dua ta them që kjo çështje paraqet çështje të sovranitetit të Kosovës apo të perceptimit të dikujt për sovranitetin e Kosovës dhe për pozitën e Kosovës në mekanizma ndërkombëtarë, në këtë rast në Interpol. Kur them për sovranitetin atakohen ata njerëz që kanë ndikuar që Kosova të ketë sovranitet, ajo logjikë që Kosovën e ka sjellëte sovraniteti, ajo luftë që ka ndikuar për sovranitetin dhe ata individë në veçanti që mund të jenë gardianë të sovranitetit edhe sot, sikur që është zoti Haradinaj.

Kur e kemi parasysh këtë ne e mbrojmë atë jo vetëm për atë që ka bërë në të kaluarën, që të gjithë në një mënyrë ose tjetër jemi mirënjohës për punën, aktivitetin, angazhimin e tij, por edhe për ata që paraqet sot edhe si kryetar i një partie politike me rëndësi në vendin tonë. Më lejoni të them që ne vëmë këtu sot në diskutimet tona edhe çështjet e identitetit tonë kombëtar, çështjet e historisë sonë nacionale dhe, mbi të gjitha, duhet të them, çështjet e perceptimit tonë për luftën e drejtë që e ka bërë, edhe zoti Haradinaj, edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës, edhe shqiptarët e vendit tonë. Po ashtu, duhet të themi që këtu sot me rastin e zotit Haradinaj dhe rastet e tjera që mund të ndodhin ka prekur në ADN-në që unë do ta quaja kombëtare.

Parlamenti i Kosovës, Qeveria e Kosovës nuk prek dhe nuk flet në Francë dhe as me Francën, as nga Kuvendi i Kosovës, për individë të rëndomtë as për veprime të rëndomta. Kjo çështje për Kosovën është kryekëput politike, unë jam i bindur që kështu duhet ta kemi secili, edhe ndonjë shkarje të vogël që mund ta kemi njëri me tjetrin, ta shfrytëzojmë rastin, kjo është çështje puro politike. Pse po e them këtë? E para, aktakuza është çështje politike. Në perceptimin apo dioptrinë e Serbisë secili ushtar i UÇK-së është, po e quaj, potencialisht i akuzuar.

Unë do të thosha kur t'i kryejnë ata, pastaj edhe të tjerët që s'kanë qenë në luftë, dhe kur t'i kryejnë të gjallët, edhe ata që do të lindin tash e tutje. Pra, kemi të bëjmë me perceptim politik për Serbinë, për Kosovën që e ka Serbia. E dyta, po ashtu kemi të bëjmë, duhet ta pranojmë një fakt, që edhe perceptimi i mekanizmave ndërkombëtarë, sikur Interpoli, ende ka problem me një barazi të qasjes sonë. Zoti Çeku shkoi, po unë besoj që ai rastin e Kroacisë e di mirë, po Kroacia ka qenë në Interpol bashkë me Serbinë, me mijëra njerëz e kanë akuzuar njëri-tjetrin, derisa kanë dalë një ditë dhe kanë thënë: "A të ndalemi pak, ta ndalim njëri-tjetrin".

Dhe, ne nuk e kemi ende këtë fuqi, këtë potencial ta bëjmë në Interpol, por me siguri që kemi fuqi, kemi potencial që brenda Kosovës të bëjmë veprime të tilla që duhet t'i bëjnë organet e drejtësisë. Kur e them në aspekt politik, edhe Franca që është partner yni, jemi mirënjohës dhe besoj që askush prej neve s'ka dilemë, duhet ta ketë parasysh një qasje. Vendimi mund të jetë i cilitdo gjyqtar apo prokuror, por ka ndikim direkt politik në raportet e Kosovës me Francën. Nuk ka të bëjë këtu një vendim i rëndomtë i dikujt që të themi po e shqyrtojmë një rast dhe unë besoj në këtë prizëm duhet t'i japim mesazhin partneritetit tonë, miqësisë tonë që e kemi me Francën që nuk lejohet një çështje kaq e madhe në duart e një qytetari, këtë rast, një gjyqtari, të veprojë në atë mënyrë e di që mund ta them konservative.

Ne duhet të jemi të kujdesshëm, pra t'i themi edhe sot, edhe me rezolutën e këtij Kuvendi, edhe me Qeveri dhe të gjitha veprimet tona që kjo nuk është çështje puro e dikujt që i shet disa letra dhe vepron me disa letra të tjera. Ato letra, në radhë të parë, nuk kanë legjitimitet, letrat që i dërgon Serbia nuk kanë legjitimitet as demokratik, as juridik, as mënyrë legale, nga 12 qershori '99 e tutje sovranitetin, gjyqësinë. Ne kemi pasur edhe UNMIK, sot e kemi edhe EULEX-in, nëse do dikush garanci, kemi gjyqësinë e Kosovës dhe nuk kemi të bëjmë këtu me veprime që dikush i ik drejtësisë.

Ne i japim garanci të plota Qeverisë së Francës se veprimet e tilla mund t'i bëjmë ne, por jo Serbia për qytetarët tonë dhe unë besoj që në këtë drejtim Qeveria, po edhe cilido prej nesh, do të jetë dhe është i gatshëm të jetë korrekt.

Një çështje tjetër, që u përmend shumë që ndikon në raportet e bisedimeve me Serbinë. Unë i ftoj deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe kam mbështetjen time edhe si zëvendëskryeministër, çdo veprim që i ndihmon zotit Haradinaj për lirimin e tij mund ta bëjmë dhe këtu duhet të jemi të kujdesshëm, duhet të kemi po ashtu, parasysh disa që mund të ndodhë të thonë më shumë, më pak. Shikoni, në bisedimet e Serbisë, e përmendi ndoshta profesor Hamiti pak, edhe unë po e them në bisedimet me Serbinë u hap kjo çështje, ka pasur njerëz që kanë hapur këtë çështje dhe që janë bashkë në akuzimet e Serbisë, nuk kanë qenë ata shumë të interesuar veç që t'i lirojnë të tjerët sa kanë qenë të interesuar që ta lirojnë edhe veten. Por, ky proces që kërkon një negociim po e quaj me BE-në dhe partnerët tanë ndërkombëtarë pason me veprime që mund t'i bëjmë.

Unë jam ithtar i kësaj që të krijohet një unitet politik, po e them, edhe sa i përket dialogut. Ta bëjmë një unitet dhe t'i vëmë tri çështje: e para, ta bëjmë një afat kohor të dialogut, është mirë që të gjithë jemi për dialog. Më vjen mirë që dhe Lëvizja “Vetëvendosje”, ndoshta për modalitetin është ndryshe, por mirë që është për dialog.

E dyta, unë ashtu së paku e dëgjova, ndoshta e kam gabim, më vjen mirë, edhe unë jam për dialog, po e them sa herë që kam mundësi të bëj dialog, bëj dialog, kur s'kam mundësi, duhet edhe ndryshe.

Mendoj që përveç aspektit kohor, duhet t'i përcaktojmë aktorët kush merr pjesë në atë dialog dhe, e treta, temat. Unë kam thënë disa vjet më herët, e di që s'ka qenë shumë familjare, unë besoj se dhjetë vjet, pesëdhjetë vjet, me një traktat të paqes duhet të përfundojë ky dialog dhe ky traktat i paqes nënkupton edhe njohjen reciproke, edhe kërkim falje nga Serbia dhe reparacionet e luftës e çështjen e të pagjeturve dhe të gjitha të tjerat, edhe fletarrestimet që janë për njerëzit e UÇK-së.

Dhe, krejt në fund më lejoni të them që sot është një moment i unitetit dhe unë besoj që secili që e ka bërë, në atë mënyrën e vet, është munduar të japë unitet për një çështje, jo vetëm pajtohem me zotin Nait Hasani, që nuk kemi të bëjmë vetëm me një kryetar të një partie, por kemi të bëjmë me një individ që personifikohet me identitetin e një lufte dhe cilido që do të ishte në këtë pozitë, unë jam i bindur që Kuvendit dhe Qeveria dhe, po ashtu krejt në fund po e them Qeveria e Kosovës është e gatshme të gjitha veprimet që e ruajnë sovranitetin, i ruajnë qytetarët tonë, e ruajnë miqësinë e partneritetin ndërkombëtar, që i kundërshtojnë këto t'i kryejë. Na ndihmojnë pak edhe njerëzit me kuptim juridik, avokatët, edhe njerëzit e tjerë nëse ka nevojë për veprime shitesë.

Unë jam i bindur që çdo argument është në anën e drejtësisë, në anën e asaj që zoti Haradinaj të kthehet, t'i bashkëngjitet edhe skenës politike, të vazhdojë aty ku e ka lënë dhe, po më vjen keq ta them këtë fjali, por duhet ta them që kurrizi i tij që disa herë po e provon, që është për keqardhje kjo, por megjithatë ai ka kurrizin pak më të fortë se disa të tjerë dhe i ka tejkualuar me sukses, unë besoj do ta tejkalojë edhe këtë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër! Unë do ta ftoja zotin Pal Lekaj ndërkohë ta marrë fjalën, por janë dy rezoluta... Urdhëro, merre njëherë fjalën, pastaj vazhdojmë seancën.

**PAL LEKAJ:** Faleminderit, kryetar!

Ju falënderoj të gjithë deputetëve që dhatë kontributin tuaj me këtë debat për një njeri që është themel i shtetit të Kosovës dhe një familje që është historia më e re e Kosovës.

Ajo që mund të them, unë kam dëshirë që nga ky debat, meqë me vëmendje çdonjërin prej jush e kam dëgjuar dhe pothuajse diku 80% ka dominuar fjalori 'ndërprerje të bisedimeve me Serbinë' dhe unë mendoj se në këtë rezolutë patjetër duhet të miratohet, sepse e kam marrë një opinion nga të gjithë ju, deputetë të nderuar dhe nuk ka kuptim diçka tjetër nëse të gjitha këto të këqija vijnë nga Serbia, atëherë çka mund të dialogojmë deri ajo të kthjellet dhe të mendojë ndryshe që ekziston shteti i Kosovës, jo që jemi provincë e Serbisë.

Prandaj, në këtë prizëm unë mendoj që Qeveria e Kosovës duhet ta thotë vetën dhe ne si Parlament duhet ta obligojmë Qeverinë e Kosovës për ndërprerjen e këtyre bisedimeve. Unë kërkoj, meqë janë dy propozime, do të thotë kërkoj një konsultë 15-minutëshe me shefat e grupeve parlamentare dhe unë mendoj që do ta unifikojmë rezolutën. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Atëherë, të nderuar kolegë deputetë, Unë besoj se është në interes të vendit, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe të këtij Kuvendi të nxirret një rezolutë e përbashkët, edhe kolegu Pal Lekaj e propozoi një pauzë, që në rend të parë ka të bëjë me lirimin e Ramush Haradinajt dhe kthimin sa më shpejt të tij në Kosovë, për t'i bartë përgjegjësitë e veta të cilat i ka.

Është mirë ta keni parasysh, zoti Pal Lekaj, ruajtjen e raporteve të mira me Republikën e Francës, kini parasysh. Djegia e flamurit nuk i ndihmon, veç do ta inkurajojë Republikën e Serbisë që të bëjë raste të tilla të na vërë përballë aleatëve, jo tash drejtpërdrejt më me Serbinë, kini parasysh. Vetëm është si një inkurajim të shkohet drejt harmonizimit të rezolutës, ajo çka është më kryesore.

Ky Kuvend është e treta herë që mban brenda një periudhe as njëvjeçare seanca të jashtëzakonshme për raste të tilla, të drejtorit të Policisë regjional të Mitrovicës, zotin Haradinaj, ka qenë dy herë për zotin Ramush Haradinaj. Do të thotë, është mirë të mos vihem në sprovë çdo herë që të na testojë dikush edhe të na nxjerrë aq të pafuqishëm se s'po mund të bëjmë asgjë.

15 minuta pauzë, kryetarët e grupeve parlamentare, ju kisha lutur, le të harmonizojnë tekstin e një projektrezolute, e cila na nxjerr të gjithëve seriozë nga kjo situatë. Faleminderit!

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*  
*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,  
Nëse ka mundësi, për hir të kuorumit t'i zëmë vendet.

Të nderuar kolegë deputetë,  
Jemi 72 deputetë në sallë, mund t'i vazhdojmë punimet e seancës.  
Unë e kisha ftuar propozuesin e kësaj seance të jashtëzakonshme parlamentare, zotin Pal Lekaj, që ta marrë fjalën dhe të na njoftojë me situatën, të cilën e kemi aktualisht. Pastaj, shefat e grupeve parlamentare deklarohen.

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar,  
Ne ishim në konsultime me shefat e grupeve parlamentare dhe me iniciuesin e rezolutës së dytë, Ilirin, dhe me keqardhje e them që nuk u dakordua për dy pika që janë në rezolutë të propozuara nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Jemi munduar të jemi unikë, sepse për asnjë moment, si Aleancë, nuk e kemi keqpërdorur ndalimin e zotit Haradinaj, nuk i kemi dhënë kahe partiake, por jemi munduar në mënyrën më të mirë të mundshme të trajtohet si qytetar, në radhë të parë i Kosovës, pastaj për gjithë peshën që e ka zoti Haradinaj. Edhe me keqardhje e them që kur është puna për të vepruar dhe për t'u treguar që ne jemi zot shtëpie këtu, dhe jo askush tjetër, ne prapë nuk dakordohemi. Prandaj, më lejoni, meqë nuk kemi dakordancë, të propozoj dhe të nxirret në votim rezoluta e propozuar nga ne si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës e mbështetur nga "Nisma" dhe "Vetëvendosja" dhe kërkoj nga të gjithë deputetët që ta përkrahin këtë rezolutë.

Kuvendi i Kosovës në bazë të nenit 65, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 52, pika 2 e Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, pas debatit të zhvilluar për ndalimin e kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në seancën plenare të mbajtur më 10 janar 2017 propozon për miratim këtë rezolutë për ndalimin e kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, në Francë.

1. Lirimi i pakusht i kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, të ndodhë sa më shpejt dhe të konsiderohet detyrë primare shtetërore.
2. Qeveria e Kosovës të kërkojë me ngulm përfshirjen direkte të Bashkimit Evropian nëpërmjet përfaqësueses të lartë për Politikë të Jashtme, zonjës Federika Mogherini, që të përshpejtohet lirimi nga shteti francez i ish- kryeministrit të Kosovës, zotit Ramush Haradinaj,

3. Qeveria e Kosovës obligohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që t'i informojë të gjitha instancat ndërkombëtare, se e refuzon juridiksionin universal të Serbisë për krimet e pretenduara në tërë territorin e ish-Jugosllavisë dhe konform kësaj të kërkojë lirimin e ish-kryeministrit të Kosovës dhe kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj.
4. Të ndërpriten bisedimet me Serbinë deri në anulimin e të gjitha fletarrestimeve të lëshuara nga Serbia kundër ish-udhëheqësve dhe ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Interpol.
5. Kërkohet dorëheqja ose shkarkimi i të gjithë përgjegjësve kryesorë të negociatorëve me Serbinë, për shkak se janë të vetmit që kanë mundur të jenë të informuar se cilët persona kanë urdhër arrestime nga Serbia në Interpol, meqë Kosova nuk është anëtare e Interpolit, nga ku do të mund të merreshin informata zyrtare për emrat që kanë fletarrestime të tilla.

Prandaj, zoti kryetar, kërkoj që ta hidhni në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ilir Deda, propozues i projekt-rezolutës së dytë. S'ka pasur harmonizim të qëndrimeve nga kryetarët e grupeve parlamentare, do të procedojmë në formën e rregullt.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Kolegë të nderuar,

Zonja Osmani dhe unë sot, pas diskutimit me deputetë, diskutimeve tuaja, të cilat e përfaqësonin një frymë apo dukej se ekzistonte një frymë, vendosëm që ta ndihmojmë këtë diskutim të partive politike, që ne të dalim unikë. Të dalim unikë, sepse treni për Kosovën po ecën dhe ne po mbetemi jashtë!

E tash, fatkeqësisht, ajo që duhet të jetë parim udhëheqës i partive politike shqiptare në Kosovë është që me çdo rast duhet të ketë kompromis njëri me tjetrin. Qysh presim ne të bëjmë kompromise me shtetet tjera e në mes vete s'bëjmë kompromis? Për fat të keq, nuk pati gatishmëri që të arrihet dakordanca për një qëndrim të përbashkët dhe si iniciues, bashkiniciues i një projekt-rezolute në konsultim me zonjën Osmani dhe në mungesë të konsensusit e tërheqim rezolutën e propozuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Deda! Do të thotë, kemi tërheqje të rezolutës së dytë, kemi vetëm në propozim një projekt-rezolutë e lexuar nga kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotit Pal Lekaj.

Do të kërkoja nga kryetarët e grupeve parlamentare tani që të shprehen rreth qëndrimit për projekt-rezolutën e propozuar nga zoti Pal Lekaj. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Elmi Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritje i nderuar zëvendësministër dhe i nderuar ministër!

Deputetë të nderuar,

Ne që nga ora njëmbëdhjetë jemi duke e trajtuar një çështje, që realisht ka ndikuar dhe ka tronditur, faktikisht, Kosovën dhe më gjerë. Dhe, kjo seancë është thirrur në një kohë kur nuk ka qenë lehtë të mbledhen të gjithë deputetët dhe vërtetë, diskutimet kanë qenë të tilla çfarë kanë qenë, po fokusi kryesor ka qenë dashur të fokusohet në rastin e zotit Ramush Haradinaj.

Secili nga deputetët e ka theksuar në radhë të parë çështjen dhe momentumin në çfarë ndodhet tash zoti Haradinaj dhe përkundër asaj që ka pasur edhe devijim nga çështja bazë, mendoj se të gjithë jemi dakorduar që të kërkojmë urgjentisht lirin e zotit Haradinaj, të angazhohen të gjitha institucionet e këtij shteti dhe të gjithë miqtë tanë ndërkombëtarë.

Në frymën e kësaj ne u tërhoqëm e biseduam dhe u munduam që ta bëjmë një rezolutë të përbashkët, duke pasur parasysh që edhe dy deputetët, zoti Dedaj dhe zonja Osmani, e kishin një rezolutë që do të mund të kombinohej. Ne propozuam dhe ishim dakord si grupe parlamentare edhe Grupi Parlamentar i PDK-së dhe Grupi Parlamentar i LDK-së, që tri pikat e para nuk janë të kontestuara dhe janë shumë të domosdoshme të votohen.

Çështja e bisedimeve me Serbinë dhe çështje që kanë të bëjnë me ndjekjen dhe përndjekjen, mos të kalojmë nga një ndjekje në një ndjekje tjetër, “kush fajtori që s’i ka sqaruar e pastruar listat...”. T’i lëmë ato çështje të cilat vërtet, ne mund t’i debatojmë krejt veçantë, edhe dialogun me Serbinë, edhe marrëveshjet e arritura, edhe realizimin ose mosrealizimin e atyre marrëveshjeve.

Unë propozova që dy pika ishin shumë me rëndësi dhe shumë me peshë nga deputetët, nga zoti Dedaj dhe zonja Osmani, propozova që të jenë pjesë e rezolutës së përbashkët dhe ato nuk u dakorduam. Dua të them që pika 3 e rezolutës, e cila u tërhoq, e kam për detyrim që së paku të ju njoftoj, ishte pikë e cila ishte e formuluar jashtëzakonisht mirë dhe ishte pikë që inkorporonte atë çfarë ne mendonim që është shumë e domosdoshme dhe pika 5, pikërisht fliste për atë që do të duhej të ketë një konsensus nacional, obligohej Qeveria që të krijojë një konsensus kombëtar sa u përket bisedimeve me Serbinë. Mirëpo, këto u refuzuan dhe... Abdyl, e prezanton tash qëndrimin, nëse dëshiron ta kërkojë fjalën, urdhëro, por unë po them çfarë ka ndodhur, ne kërkuam këtë: që të kombinohej dhe ta bëjmë një rezolutë të përbashkët.

Grupi Parlamentar i Aleancës dhe opozita e refuzuan tërësisht këtë. Pika 5 ka të bëjë pikërisht me çështjen e bisedimeve me Serbinë dhe në njëfarë mënyre riformatimin e tyre, megjithëse nuk thuhet, por nëse thuhet se duhet të kemi konsensus nacional atëherë është ai.

Tash, nga kjo pozitë çfarë jemi, ne jemi të gatshëm që tri pikët e para, ashtu siç janë në rezolutën e mbetur tash për votim t'i votojmë, ndërsa për dialogun me Serbinë, ai ka filluar në bazë të një rezolute të OKB-së. Është i involvuar edhe Bashkimi Evropian dhe nuk e di se sa i ndihmojmë ne! Unë e kam mendimin e qartë, që mund vetëm ta dëmtojmë zotin Haradinaj dhe ne jemi këtu të mbledhur në këtë kohë, kur jemi si Parlament në pushim për ta ndihmuar atë. Dhe, ky është qëndrimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë po shkoj rutinë tek kryetarët e grupeve parlamentare. Urdhëro, zoti Morina, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike pati qëndrimin e vet, që bashkërisht me Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike u pajtuam për të tri pikat e para të kësaj rezolute të iniciuar nga shefi i Grupit Parlamentar të Aleancës dhe po ashtu, nuk u pajtuam, për fat të keq, për dy pikat e fundit, siç e tha edhe zoti Reçica, kur është në pyetje çështja e dialogut me Serbinë dhe njëkohësisht kërkohet dorëheqja dhe shkarkimi i të gjithë përgjegjësve kryesorë të negociatave me Serbinë, gjë që mendojmë se kjo është më tepër çështje politike, se sa që do t'i bënte nder, ndoshta edhe vetë zotit Ramush Haradinaj.

Andaj, sot edhe deputetët që kanë diskutuar temë kryesore dhe mendoj se debati është thirrur që të lirohet sa më shpejt zoti Haradinaj dhe të lihen anash çështjet politike, sepse mendoj se kjo çështje mund ta përshpejtojë lirinë, fokusi i veçantë për lirinë e zotit Haradinaj mund ta fokusojë dhe përshpejtojë lirinë e tij.

Prandaj, zoti kryetar, unë kërkoj në këtë rast që kjo rezolutë, po qe se lejon edhe Rregullorja, të votohet me pika të veçanta, duke filluar prej pikës 1 dhe kështu me radhë, deri te pika e pestë. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike do ta votojë pikën 1, pikën 2 dhe pikën 3, kurse në pikën 4 dhe 5 nuk do të marrë pjesë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lëvizja “Vetëvendosje” Grupi Parlamentar, urdhëroni zoti Çaushi.

DRITON ÇAUSHI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Deputetë të pranishëm,



Sot jemi mbledhur, që nga mëngjesi, për të trajtuar një çështje tepër urgjente dhe fillimisht më duhet të konstatoj dy gjëra, që tregojnë shumë për seriozitetin e institucioneve të Republikës së Kosovës për ta trajtuar këtë çështje. Pra, në radhë të parë fakti që në pjesën më të madhe të kësaj seance nuk kemi gati asnjë përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe kryeministrin.

E dyta, është tepër e rëndësishme, unë nuk besoj se ka një parlament në botën demokratike, ku duket një shpërputhje e tillë sikurse këtu në këtë sallë, në mes të qëndrimeve deklarative që mbajnë deputetët e koalicionit qeverisës dhe qëndrimeve të tyre, kur vjen radha të votimi dhe konkretisht të qëndrimi në lidhje me këtë rezolutë.

Rasti i arrestimit të zotit Haradinaj nuk mund në asnjë mënyrë të shkëputet nga situata e përgjithshme dhe nga raporti i Republikës së Kosovës në raport me Republikën e Serbisë, pra nuk mund të ndahet rasti Haradinaj nga kolonizimi që po vazhdon në veri, nga muri në veri të Mitrovicës, nga provokimet vazhdueshme të Listës serbe, të cilët qëllim jetësorë kanë luftimin e Republikës së Kosovës dhe të gjitha provokimet tjera.

Andaj, edhe qasja dhe qëndrimi i këtij Kuvendi duhet të jetë parimor dhe jo duke u ndarë në rastin e veçantë. Për këtë arsye edhe ne mendojmë dhe qëndrimi ynë është se nuk mund të ketë një rezolutë efektive dhe parimore në këtë rast, nëse ajo nuk do të përfshijë një masë të reciprocitetit, e cila do të detyronte një veprim të institucioneve ndërkombëtare dhe të Republikës së Serbisë në këtë rast.

E thashë e po e përsëris, shpresoj që qytetarët e Republikës i kanë dëgjuar fjalimet e deputetëve të koalicionit. Ato ishin plotë reciprocitet dhe ndërprerje të negociatave, mirëpo tani po e shohim që gjithçka është më pak e rëndësishme për këtë koalicion qeverisës, sesa negociatat me Serbinë. Për këtë arsye, me disa vërejtje, ne e mbështetim propozim-rezolutën e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, natyrisht duke kërkuar dhe duke mos pranuar asnjëherë ndarjen e saj në pika të veçanta. Dhe, te pika e katërt, aty ku kërkohet ndërprerja e bisedimeve me Serbinë kërkojmë gjithashtu të zbatohet parimi i reciprocitetit, si vlerë themelore në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Pra, ne e mbështesim këtë, megjithëse mendojmë se është jo e plotë dhe se vetëm një kërkesë për reciprocitet, pra një ndërprerje e këtij dialogu me kërkesë reciprocitetin do të ishte kuptimplotë në rastin dhe në situatën, në të cilën ndodhemi. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Zonja Valdete Bajrami nga “Nisma” dhe zoti Zafir Berisha.

**VALDETE BAJRAMI:** Faleminderit, kryetar!

Fatkeqësisht, në takimin e shefave të grupeve parlamentare nuk e gjetëm një gjuhë të përbashkët, përkundër faktit që sot tërë ditën këtu është kërkuar që të kemi unitet dhe është kërkuar pikërisht

nga shumica e deputetëve, pikërisht që pika e katërt të jetë në rezolutë në njëfarë mënyre me i pa të gjitha fjalimet të cilat i kanë pasur deputetët të kërkohet kjo pikë.

Sa i përket pikës së tretë të rezolutës së zotit Dedaj dhe zonjës Osmani, rezoluta e AAK-së veç e ka të inkorporuar një pjesë të saj, mirëpo unë kërkuj këtu nga deputetët që sot u deklaruan, që të jenë edhe në votim ashtu siç e patën qëndrimin e tyre dhe të tregohen njëherë e përgjithmonë, që qëndrimi i tyre shkon me votën ashtu siç ishte në realitet, se e dimë që ky Kuvend prej momentit që është themeluar kjo legjislaturë, krejt diçka tjetër është deklaruar dhe në fund është votuar diçka tjetër.

Prandaj, kolegë deputetë, kërkuj nga ju që sot të jeni të pavarur në votimin e juaj dhe, ju kërkuj që ta votoni rezolutën që zoti Lekaj dhe AAK-ja e ka propozuar të tërën, jo të ndarë, por të tërën. Faleminderit!

KRYETARI: I kemi dy kolegë deputetë. A insistoni ta merrni fjalën. Zonja Tërmkollli le ta marrë fjalën shkurt, pastaj zoti Berisha. Zoti Pal Lekaj, unë do të mundohem ta bëj një përpjekje të fundit dhe shkojmë në votim.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Shumë shkurtimisht. Në fakt, gjatë tërë ditës sot në diskutimet që i paraqitën shumica e deputetëve pati njëfarë lloj konsensusi verbal, mund të themi.

Është për keqardhje që nuk kemi konsensus në vendime edhe kjo nuk është e mirë. Pothuajse, nuk pati deputet që nuk foli për një platformë të re të bisedimeve, duke e lidhur edhe me rastin Haradinaj, por duke e lidhur edhe me krejt proceset që po ndodhin në Kosovë dhe të kulmuar me rastin Haradinaj, të fundit dua të them, sepse ka edhe të tjera kulme.

Pozita po gabon, edhe opozita po gabon. Pozita nuk po pranon një ridizajnim, më falni veç pak, jo s'po pranoi, ridizajnim të bisedimeve... jo, s'jeni duke pranuar. Pozita nuk po e pranon këtë. Opozita po kërkon ndërprerje të bisedimeve. Nuk mund të lejojmë ndërprerje të bisedimeve, por ridizajnim të bisedimeve, absolutisht është nevojë urgjente. E tha zoti Reçica jo, se kemi obligime ndërkombëtare, rezoluta e OKB-së na... E vërtetë, na obligon. Ne s'po themi se jemi kundër bisedimeve, se na obligon, por nuk na ndalon na t'i ridizajnojmë bisedimet, nuk na ndalon absolutisht me e bë një ridimensionim të bisedimeve, me e bë një riformatim të bisedimeve, kurrkush nuk na e ndalon. Po e ndaloni veten, se nuk keni takat, nuk e di pse.

Është turp, nëse sot dilet këtu pa një rezolutë unike. Është e turpshme edhe për pozitën edhe për opozitën. Ju lutem, urdhëroni, uluni e bisedoni e të dalim me një rezolutë unike.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Berisha, fjala për ju.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar, për mundësinë kështu me shkelje të lehta të rregullores, që ma dhatë fjalën! Unë dola për të dhënë një kontribut drejt unifikimit, bazuar edhe në deklaratat e deputetëve dhe të zyrtarëve të Qeverisë.

Edhe kryeministri edhe ministrat paraprakë e në fund edhe zoti Kuçi në emër të Qeverisë, tha se ndalimi i zotit Haradinaj është veprim politik. Të gjithë jemi pajtuar. Dhe, meqë është kështu, atëherë edhe Aleanca bashkë me partitë opozitare po kërkojnë nga ky Kuvend të bëhet veprim politik. Ky Kuvend nuk është për të ndërtuar shtëpi, ky Kuvend është për të marrë vendime politike dhe njëri nga vendimet politike, që do t'i kthejë kuptimin këtij Kuvendi, është pika 4 e rezolutës.

Dhe, në rast se ne bëjmë rezolutë llastiku, që tërhiqet si të kenë qejf të tjerët, atëherë faktikisht rikthem në fjalimin tim të paradites, se ne takohemi, bëjmë 'muhalife' dhe sa për të thënë që kemi bërë diçka.

Në anën tjetër, unë do t'i lako, jo për replikë, dy emra në kontekstin pozitiv, po shumica keni folur në këtë frymë, zoti Nait Hasani dhe zoti Shurdhaj. Ishit ju deputetë, se e pashë që Elmi Reçica po ju bënte presion për ta ndryshuar qëndrimin nga ajo që e keni thënë publikisht, që pajtoheshit që edhe nga fjalimet tuaja doli pika 4 e rezolutës, po edhe shumë deputetë të tjerë, kështu që unë kisha kërkuar që ne të tregojmë 'un', identitet shtetëror në raport me Serbinë fashiste.

Ne mund t'i heqim këto pika, mirëpo ne nuk kemi bërë asgjë. Prandaj, ky Parlament ka për obligim moral, njerëzor, ligjor e kushtetues që të marrë vendime politike në raport me Serbinë, sepse s'bëhet kiameti nëse i ndërpresim bisedimet. Natyrisht se mund t'i fillojmë bisedimet, por në formë dhe në formacione krejt të tjera dhe me platforma të qarta politike, për të cilën folën shumë kolegë deputetë.

Në fund të fundit, Kosova ka nevojë dhe është moment i fundit për të treguar identitet dhe të marrë vendime të qarta me Serbinë si shtet agresor ndaj Kosovës. Kështu që në rast se hiqen këto dy pika, pika 4 dhe 5 e rezolutës, atëherë faktikisht do ta kemi gjendjen si më parë me shumë rezoluta të tjera, për të cilat kemi biseduar dhe askush nuk ka marrë përsipër t'i zbatojë, edhe kjo do të jetë vetëm fjalë goje dhe asgjë tjetër.

Mendoj se të gjithë kryesisht kanë pasur fjalime shumë kuptimplote në raport me situatën që jemi dhe të mos i ndryshojnë qëndrimet për shkak të presioneve që po u vinë aktualisht nga udhëheqësit e grupeve, sepse megjithatë jeni deputetë të qytetarëve, pavarësisht të cilës parti. Faleminderit!

KRYETARI: Zotëri Reçica e ka kërkuar fjalën, meqë e përmendi Zafiri, pothuajse jemi në përfundim.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Desha një sqarim për zotin Berisha, opinionit dhe deputetëve të tjerë. Deputetët, me të cilët bisedova, nuk mund të bien pre e asnjë presioni, as timit e as të kurrkujt, e kanë votën e vet dhe sigurisht se votojnë në bazë të ndërgjegjes së tyre. Mirëpo, vetëm jua sqarova se çka dhe si u zhvillua takimi me shefat e grupeve parlamentare atje dhe u tregova çfarë kemi propozuar ne dhe, bile, jo vetëm ata, por edhe të tjerët ishin të mendimit që me 3 pikat e para dhe 2 pikat e tjera të propozuara nga zoti Dedaj dhe zonja Osmani, pse s'e bëtë një rezolutë dhe ta nxjerrim si të tillë e ta votojmë. Mirëpo, meqë iniciativa ka qenë e Grupit Parlamentar të Aleancës, nuk ndërmorëm një hap të tillë. Do të thotë, ishte çështja për një sqarim dhe unë besoj se u sqarua. Në asnjë moment nuk ka pasur formë presioni dhe as që mund t'ju bëj presion, por edhe ata s' pranojnë presionin. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Shukri Buja e ka fjalën, të lutem, Shukri, mos përmend emra!

SHUKRI BUJA: Nuk është në natyrën e as kulturën time të përmend emra të tjerë.

Së pari, po them se konceptualisht edhe diskutimet ishin në atë formë. Dy rezolutat e propozuara janë gabim që në start, sepse përmendet Ramush Haradinaj si kryetar i Aleancës dhe si ish-kryeministër.

Ramush Haradinaj është arrestuar atje si çlirimtar dhe si komandant i Zonës Operative të Dukagjinit. Prandaj, rezoluta duhet të jetë me emërtim se për çfarë është arrestuar zoti Haradinaj.

Përveç kësaj, për të arritur një konsensus, besoj se opozita mund të pajtohet, prandaj ne për të mos e dëmtuar zotin Haradinaj në këtë rast, do të duhej që këtë çështje me formulime politike, të cilat mund të adresohen mjaft mirë dhe ta formulojmë pikën 4 dhe të themi se Qeveria e Kosovës të obligohet të paralajmërojë Brukselin e Beogradin se ne do të rishqyrtojmë çështjen e bisedimeve në rast se Serbia vazhdon me obstrukcione ndaj qytetarëve të Kosovës dhe nuk tërheq fletarrestimet për qytetarët e Republikës së Kosovës, për t'u plotësuar me pikën 5 që Qeveria e Republikës së Kosovës obligohet t'i raportojë Kuvendit në muajin tjetër për arritjet nga këto obligime që i merr nga Parlamenti i Kosovës.

Dhe pika që e plotëson kërkesën e opozitës, por që duhet të shtyhet kjo çështje për të mos u dëmtuar zoti Haradinaj, do të duhej të jetë "Parlamenti i Kosovës, pas raportit nga Qeveria e Kosovës për progresin e arritur në këto obligime që i merr nga Parlamenti i Kosovës, të marrë vendime për çështjen e vazhdimit të dialogut me Serbinë". Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ne kemi 9 orë e gjysmë që jemi bashkë. Nderi nuk e do të dilet nga kjo seancë pa një rezolutë dhe krejt qëllimi i këtij diskutimi ka qenë lirimi i Ramush Haradinajt si bashkëluftëtar, e në të njëjtën kohë edhe si udhëheqës politik i këtij vendi.

Mirë do të ishte ta kishim një unifikim, e të mos ndahemi. Pal, pika 5, ne bashkëbiseduam dhe tash po bashkëbisedoj me ju publikisht. Ju si prezantues i kësaj projektrezolutive dhe përfaqësues tanimë i krejt opozitës. Drejtpërsëdrejti po kam frikë se nuk do ta votojnë, për arsye se ti automatikisht e di se është rrëzim i Qeverisë. Kërkesa për dorëheqje është rrëzim i Qeverisë dhe faktikisht po e fut një pjesë të Ramush Haradinaj, fatin e tij, me një pjesë të politikës që po kërkon nga kryeministri dorëheqje. Kjo është pjesë e koalicionit dhe po mundohem të jem shumë neutral dhe pastaj automatikisht nuk votohet. Po na mbetet, pra, rezoluta pa u votuar, sepse kemi të bëjmë me qëndrim politik drejtpërdrejt, i cili veç po e tejkalon konotacionin e një rezolutive, që ka të bëjë me çështjen e lirimit.

Edhe një aspekt, Pal, të cilin unë u mundova ta theksoj. Askund, në tërë rezolutën nuk theksohet që të kërkohet mirëkuptim i organeve të drejtësisë franceze që të lirohet Ramush Haradinaj. Pra, në kuadër të mirëmbajtjes së raporteve të mira me Republikën e Francës, një zotim që e kemi në vazhdimësi, t'u kërkohet organeve të drejtësisë pa interferuar në pjesën politike, pasi që Kosovën e ka njohur si shtet të pavarur dhe sovran edhe Republika e Francës, pra këto nuk i ka kurrkund rezoluta.

Unë kisha kërkuar, nëse ju pajtoheni, edhe nja 10 minuta për kryetarët e grupeve parlamentare... jo atëherë mbahet me bazë politike. I kemi kaluar 9 orë e gjysmë dhe nuk është mirë t'i humbasim për një punë dhjetëminutëshe. Kryetarët e grupeve parlamentare dilni në atë pjesë për pesë minuta.

Pal, a ka mundësi? Sepse, mua po më vjen keq që nuk po dalim seriozë para qytetarëve. Po dalim me qëndrim politik të ndarë. Ne kemi pritur që 9 orë e gjysmë dhe presim edhe gjysmë ore. Pra, konsultohuni gradualisht bashkë, Pal, për 10 a 15 minuta.

Urdhëro, zoti Pal Lekaj e ka fjalën.

PAL LEKAJ: Kryetar,

Për Ramushin kjo që i ka ndodhur është diçka e vogël, por për Kosovën është me rëndësi jetike që ne si Kuvend të marrim vendime politike. Ramushi çdoherë ka dalë jashtë kornizave partiake dhe çdoherë ka qenë në shërbim të të mirës së Kosovës dhe unë, për hir të një uniteti po pajtohem që pika 5 të largohet, por edhe të shtohet ajo që e thatë, pra të kërkohet na organet e drejtësisë së Francës.

Përndryshe, për asgjë diçka tjetër nuk do të bëjmë kompromis lidhur me këtë çështje. Dhe nëse ne e votojmë...

*(Ndërhyrje)*

Jo, jo, dialogu nuk u përmend! Më fal, se nuk u përmend. Jo, nëse ju mendoni prapë të bëni kompromise, atëherë s'ka kuptim, po e shqyejmë këtë rezolutë krejt.

Pra, prapë po e citoj, i vetmi kompromis është pika 5 të hiqet dhe kurrigjë tjetër.

KRYETARI: Ju kisha lutur, a mundeni për 10 minuta kryetarët e grupeve parlamentare edhe një herë të takoheni. Pra, vetëm 10 minuta i keni pauzë, në fund të futemi në seancë, përgjegjësia është publike. Pra, le të takohen kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë seancën dhe për të qenë më konsumues të kohës po shkojmë me dy projektrezolutat, meqë s'kemi harmonizim, do t'i kemi dy projektrezoluta dhe të dyja do të vihen në votim.

Pra, e kemi projektrezolutën nga Grupi Parlamentar PDK-LDK dhe projektrezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i Aleancës...

*(Ndërhyrje)*

Më falni, vetëm proceduralisht po i përmend. Pra, janë dy projektrezoluta, një është nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe të dyja janë për ndalimin e kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotit Ramush Haradinaj në Francë.

Atëherë unë kisha kërkuar të shkojmë me leximin e tyre. Opozita po kërkon të lexohet së pari e tyre.

Atëherë, zoti Pal Lekaj a po e lexon, apo s'ka nevojë? Unë dua vetëm proceduralisht ta theksoj. Atëherë, urdhëro, Pal Lekaj, si propozues, nëse ke diçka të thuash para votimit.

Do të votohet e para projektrezoluta e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

PAL LEKAJ: Kryetar, së pari ne e bëmë një kompromis me kërkesën tuaj dhe të falënderoj që propozove që pika 5 të largohet si kompromis dhe për të unifikuar qëndrimin tonë. Por, po del diçka tjetër nga ajo që është diskutuar gjatë tërë kohës dhe, më besoni, po më çudit fakti se deputetët po e ndryshojnë mendimin me votë.

Pse po e them këtë? Sepse, prapë po vazhdojmë me politikën nënshtruese që i ofron Beogradi dhe asnjëherë nuk po mund të tregojmë që vërtet ky vend ka zot shtëpie dhe dimë të marrim vendime të mëdha politike për të mirën e vendit. Por, me këtë që po e bëni dhe me rezolutën që e lexova, komplet është një plagjiaturë, dhe 3 pikat që janë inkorporuar dhe janë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe nga “Vetëvendosja” e “Nisma”. Unë nuk di çka keni ndryshuar, përpos të raporteve të mira. Ne raporte të mira kemi me Francën. Të jeni të bindur, e përmendi edhe kryetari djegien e flamurit, por të jeni të bindur se ajo nuk bëhet nga ata që ia duan të mirën Kosovës.

Për këtë jemi distancuar si parti dhe prapë po e them, ne kemi raporte të mira me Francën, por ne nuk mund të jemi argatë të kurrkuajt. Jemi duke e mbrojtur një të drejtë universale dhe nuk e di pse hezitoni të ndërpriten bisedimet me Serbinë, por le të mbetet tek ju.

Ne, përpos atij kompromisi që e bëmë për pikën 5, më nuk lëvizim. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, shkojmë në votim të drejtpërdrejtë të projektrezolutës të propozuar nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, të cilën e keni para vete.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Rezultatit sigurisht po e vëreni. Janë 36 vota, 28 për, 3 kundër dhe 5 abstenime.

Tash e votojmë projektrezolutën tjetër, nga Grupi Parlamentar PDK-LDK. Votojmë tash!

47 vota, 38 për, 6 kundër dhe 3 abstenime.

Atëherë konstatoj se nuk kemi vota të mjaftueshme për asnjërën nga projektrezolutat dhe me keqardhje nuk do të kemi as rezolutë.

Me këtë përfundon seanca e jashtëzakonshme dhe shihemi pas datës 16 janar, kur fillojmë me seanca të rregullta plenare, për të cilat ju lajmërojmë. Faleminderit dhe mirupafshim!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*